

Dhjetor 2022
Numri: 177
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.progresibotime.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro

NDERSHMËRIA TREGTIA MË FITIMPRURËSE



revistaetika




progresibotime

Fjala më e bukur është Libri i Allahut. Rruga më e mirë është sunneti profetik. Streha më e sigurt është devotshmëria. Të folurit më me virtyt është përmendja e Allahut.

Tregimet më të bukura gjenden në Kuran. Rrugët më të ndritura janë rrugët udhëzuese të profetëve.

Dija më e mirë dhe më e dobishme, është ajo që kthehet në kulturë. Justifikimi më i keq është ai që bëhet në momentin e vdekjes. Pendimi më i keq, është ai në ditën e kiametit. Pasuria më e mirë, është ajo e zemrës.



Besimtarët janë në trupa të ndryshëm, ata janë të detyruar ta konsiderojnë njëri-tjetrin si organet e një trupi që jetojnë me një zemër të vetme. Ashtu siç i gjithë trupi e ndjen dhimbjen e një organi, edhe perceptimi i vuajtjeve të vëllezërve të fesë, është një sprovë ndërgjegjeje për të gjithë besimtarët.

Allahu i Lartëmadhëruar i ka krijuar njerëzit nevojtarë ndaj njeri-tjetrit. Shoqëria, ashtu si ka klasën e pasur dhe të fortë, ka e do të ketë gjithmonë edhe klasën e të dobtëve, të njerëzve me probleme shëndetësore dhe të nevojtarëve. Ne duhet të pyesim veten: "Pse i krijoi Allahu i Lartëmadhëruar nevojtarët?" Përgjigjja dihet: "Nevojtarët janë amanet i Allahut (xh.sh.), që ua ka lënë jonevojtarëve." Këtë përgjegjësi e ka dhënë Vetë Allahu.



Dhjetor 2022

VITI: XVI

NUMRI: 177

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

ËËBSITE

ëëë.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 2B; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur

se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Kush janë ata që meritojnë paqen e pafundme me lavde dhe falënderime të pafundme, duke arritur selamet, shpërblimet dhe stinët e pafundme të xhenetit?

Ata:

Janë njerëzit, të cilëve gjethet e jetës nuk u janë bërë perde në sytë e tyre.

Njerëzit që i shohin qartë të vërtetat e pafundme para se t'u bien gjethet e fundit.

Njerëzit që jo vetëm i shohin, por këto të vërteta të larta, urdhrat dhe ndalesat hyjnore, i bëjnë parim të jetës së tyre, duke i vënë në jetë ato.

Ata që nuk ndahen nga e drejta pavarësisht çdo gjëje.

Ata që shfaqin gjithmonë moral dhe përpjekje në devotshmërinë ndaj Allahut.

Ata që vendosin kurorën e edukatës.

Ata që u hapin krahët e mëshirës dhe dashurisë të varfërve dhe të vuajturve.

Ata që nuk heshtin para thirrjeve "na mëshironi!", të cilat shtohen përditë, por u dalin për zot atyre.

Ata që mbajnë premtimet.

Ata që janë të pastër dhe të sinqertë në shpirt.

Ata që janë pajisur me drejtësi.

Ata që nuk mashtrojnë.

Ata që hanë hallall.

Ata që bëhen shkak për udhëzim.

Ata që ndërtojnë vëllazërinë dhe paqen.

Ata që ecin dhe vrapojnë në rrugën e drejtë.

Ata që garojnë në të mira.

Ata që gjallërojnë brezat.

Ata që braktisin të keqen dhe drejtohen nga e mira.

Bamirësit.

Të devotshmit.

Ata që japin jetë.

Ata që janë besnikë ndaj Allahut.

Ja pra:

Këta janë ata fatlumë që arrijnë lumturinë e pafundme kur bie edhe gjethja e fundit e jetës së tyre!


Për ata:

Stina e ardhshme, është vetëm stina e mirësisë, bujarisë, mëshirës dhe falënderimit.

Sepse:


"Ata janë ata që i përmbahen besëlidhjes me Allahun dhe nuk e prishin premtimin; dhe ata që mbajnë lidhjet (familjare) që ka urdhëruar Allahu të mbahen, që kanë frikë Zotin e tyre e i frikësohen llogarisë së rëndë; dhe ata që durojnë për të fituar dashurinë e Zotit të tyre, që falin namazin, që ndajnë fshehurazi dhe haptazi nga ajo që ua kemi dhënë Ne dhe, që të keqen, e kthejnë me të mirë. Këtyre u takon shpërblimi në Shtëpinë e fundit: Xheneti i Adnit, në të cilin do të hyjnë ata dhe besimtarët e ndershëm prej prindërve të tyre, grave dhe pasardhësve të tyre. Dhe engjëjt do të hyjnë tek ata nga çdo derë (e Xhenetit) (e do t'u thonë): "Shpëtimi qoftë mbi ju, për durimin që keni treguar (në jetën e kësaj bote)! Sa vendbanim i bukur që është ky!" (Ra'd, 20-24.)

Përmbajtja



10

Thesari i sinqeritetit
Prof. dr. Sulejman Dërin



Si ta kuptojmë duanë?
Dr. Naif Ozkul

18



12

32



Imam Shafiu (r.a.)
Osman Nuri Topbash

5 Ndershmëria, tregtia më fitimprurëse
Mehmet Lutfi Arslan

8 Një pazar i ri krijohet
çdo ditë në tregun botëror
Dr. Adem Ergyl

12 Njerëzit që janë siguri për jetën
Ali Riza Temel

17 T'u sugjerosh të tjerëve atë
që nuk e bën vetë, është fitne
M. Sami Ramazanollu

22 Si sinqerti dhe besniku
Abdullah Sert

24 Hz. Jusufi (a.s.) dhe Hz. Musai (a.s.)
Et'hem Xhebexhiollu

26 Tregtari Besnik
Dr. Ahmet H. Jëlldërem

28 Të marrësh në llogari
M. Sami Ramazanollu



26

- Ziliqari është armik 29
ndaj mirësisë së Allahut
Sadik Dana
- Bindja ndaj Profetit (a.s.) 30
nën dritën e ajeteve të Kuranit
Doç. dr. Kerim Bulladë
- Kjo botë është e përkohshme 44
Irfan Ozturk
- Sistemi nervor 46
Doç. dr. Fërat Erdoan
- Cila stinë vjen kur 48
bie gjethja e fundit?
M. Ali Eshmeli

42

Pa ardhur ende ajo ditë
Sami Geksyn



Kur e do diçka me gjithë
zemër ajo bëhet realitet
Rukije Gënyly

56

NDERSHMËRIA

TREGTIA MË FITIMPRURËSE

— Mehmet Lutfi Arslan —

Ekspedita e Tebukut ishte një sprovë e jetës dhe pasurisë, të cilën Kurani Fisnik e përshkruan si «saatu'l-usra» (koha e vështirësisë). Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve selem, bëri thirrje për mobilizim për këtë ekspeditë dhe i ftoi të gjithë të kontribuonin me aq sa të kishin mundësi. Njerëzit u dyndën në xhaminë e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Disa prej tyre dëshironin të jepnin gjithçka që kishin, disa prej tyre shprehnin justifikime dhe disa të tjerë prej tyre thjesht shikonin (bënin sehir) se çfarë po ndodhte. Kushtet e ekspeditës ishin të rënda, rruga ishte e gjatë, moti ishte i nxehtë dhe armiku ishte i fortë. Në këto kushte, kishte dhjetëra skena që zbulonin aspektet e ndërlikuara dhe enigmatike të psikologjisë njerëzore. Prej tyre, ato të Ulbe ibn Zejdit dhe Ka'b ibn Malikut ishin veçanërisht shembullore dhe ishin shembuj madhështorë që tregonin se kapitali ynë më i madh si qenie njerëzore është ndershmëria.

Për shkak të kushteve të vështira të Ekspeditës së Tebukut, Profeti (a.s.), pranoi vetëm ata që kishin një kafshë transporti në ushtri. Ulbe ibn Zejdi ishte një nga ata që nuk mundi të gjente një kafshë trans-

porti. Ulbe shkoi te i Dërguari i Allahut (a.s.), së bashku me gjashtë nga sahabët, të cilët po qanin ngaqë nuk mund t'i bashkoheshin ekspeditës e që për këtë arsye Kurani i quajti «bekkain-ata që qajnë», dhe i kërkuan kafshë transporti. Pamundësia e Profetit për t'i ndihmuar këta sahabë të nderuar përshkruhet siç vijon në ajetin fisnik: «(Nuk ka gjynah) **as për ata të cilët, kur vijnë te ti për të kërkuar kafshë transporti e ti u thua: "Unë nuk mund t'ju siguroj kafshë transporti.", kthehen me sytë e tyre që u rrjedhin lot, ngaqë nuk mundën të gjenin gjë për të dhënë** (në rrugë të Allahut).» (Teube, 92)

Edhe pse Ka'b ibn Maliku kishte përgatitur një kafshë transporti, ai nuk u nis dot bashkë me ushtrinë dhe pastaj mbeti prapa me mendimin se do t'i arrinte më vonë. Megjithatë, Ka'bi nuk mundi të nisej për shkak të mendimit se po nisem sot, po nisem nesër. Në fund, mbeti në Medine vetëm me hipokritët dhe ata që nuk kishin mundësi financiare. Kur u paraqit para të Dërguarit të Allahut pas ekspeditës, ai nuk kishte asgjë tjetër veç ndershmërisë



së tij. Ai i shprehu ndjenjat e tij ashtu siç ishin: “Pasha Allahun, nuk kisha asnjë justifikim për të mos shkuar në luftë. Kurrë nuk kam qenë më i fortë dhe i pasur sesa kur mbeta pa ardhur në luftë.” I Dërguari i Allahut (a.s.), i tha atij, Hilal ibn Umejjes dhe Murare ibn Rebias, dy veteranëve të Bedrit, që të prisnin derisa të vinte gjykimi i Allahut për ta. Pas një kohe, këtyre sahabëve iu ndalua të jetonin me gratë e tyre dhe të flisnin me të tjerët. Pikërisht në këtë proces të vështirë, Gassan Meliki e ftoi Ka’bin, i cili ishte një poet i njohur, në vendlindjen e tij me arsyetimin se i ishte bërë padrejtësi. Ka’bi nuk u trondit nga kjo ofertë që ia trazonte shpirtin dhe vazhdoi të priste gjykimin e Allahut (xh.xh.). Më në fund, vargjet që u shpallën pas një izolimi pesëdhjetë e tre ditor njoftuan se ai dhe dy shokët e tij ishin falur. (Shik. Teube, 117-119.)

Kurse Ulbe pasi u largua me lot në sy nga audienca e të Dërguarit të Allahut (a.s.), mori një vendim për vete. Në një kohë kur të gjithë po bënin diçka, edhe ai duhej të bënte diçka. Ai hapi duart dhe u lut: “O Zot, ti urdhërove xhihadin dhe i nxite njerëzit ta bëjnë këtë. Kurse mua nuk më dhe mundësi të shkoj në xhihad. Por edhe unë dua të jap diçka për ty. O Zot, e kam falur çdo lloj padrejtësie që i bëhet pasurisë, jetës, nderit dhe namusit tim, kushdo që të mi ketë shkelur këto të drejta, ia bëj hallall dhe i dhuroj si lëmoshë në rrugën Tënde.” Duke e ngjallur (kaluar me ibadet) natën e tij me një lutje të tillë, Ulbe shkoi në xhami me zemër të qetë për faljen e namazit të sabahut. Pas namazit, ai dëgjoji Profetin (a.s.), duke i thënë xhematit: «Kush është ai që i ka falur të drejtat e tij si lëmoshë mbrëmë?» Në fillim nuk mendoi se ishte adresuesi i kësaj pyetjeje. Pyetja u parashtrua përsëri: «Kush është ai që i ka falur të drejtat e tij si lëmoshë mbrëmë?» Pastaj mendoi, mos vallë ishte ai që po synohej? U habit dhe hezitoi të ngrihej. Kur pyetja u përsërit për të tretën herë, u ngrit me hezitim dhe e tregoi lutjen që kishte bërë natën. I Dërguari i Allahut (a.s.), me fytyrën e tij rrezatuese, i dha atij këtë lajm të mirë: “Allahu e pranoi lëmoshën tënde.”

Ai që jep nga pasuria e tij, sakrifikon komoditetin që ia siguron pasuria. Ai që jep nga jeta e tij, sakrifikon ëmbëlsinë që ia siguron jeta. Ai që jep nga koha, sakrifikon rehatinë e vetes dhe egos së tij. Mirë, por çfarë sakrifikoi Ulbe (r.a.), i cili dha nga nderi i tij dhe i fali padrejtësitë që mund t’ia kishte bërë dikush? Ai hoqi dorë (sakrifikoi) privilegjin e dhënë nga Allahu në këmbim të padrejtësive që i ishin bërë. Zhgënjimi, padrejtësia dhe zullumi që ishin formuar te Ulbe ngaqë i ishte shkelur e drejta,



kishte rënë viktimë në ngjarje të ndryshme, ishte lënduar dhe ndoshta ishte luajtur me nderin dhe namusin e tij, do t’i mblidhte patjetër një ditë si shpërblim te Zotit, (por ai hoqi dorë prej këtyre). Të hiqte dorë nga këto, do të thoshte të hiqte dorë nga kapitali i tij, i cili ndoshta do t’i bënte shumë dobi ditën e llogarisë. Duke u shprehur se nuk i kërkonte më të drejtat e tij që me siguri do t’i mblidhte nesër në ditën e gjykimit, në fakt po u bënte një nder të madh të gjithë njerëzve që e kishin zemëruar. Çfarë bamirësie më të mirë mund të ketë se kjo?

Nga njëra anë Ka’bi, i cili e nënvlerësoi ekspeditën duke qëndruar në hije dhe gjelbërim, nga ana tjetër Ulbe, i cili e fali çdo padrejtësi që i ishte bërë kundrejt dinjitetit dhe të drejtave të tij për të kontribuar kështu sado pak qoftë për ekspeditën... Emëruesi që i bashkon këto dy qëndrime të ndryshme në një skenë prove si Tebuku, e cila do të jetë shembull deri në ditën e kiametit, është ndershmëria. Ndershmëria është vija kryesore e personalitetit islam. Myslimani mund të jetë frikacak dhe koprrac, por ai nuk mund të jetë një gënjeshtar. Ndershmëria është dera e mirësisë, kurse gënjeshtria është dera e mëkatit. Për këtë arsye, besimtari duhet të jetë i ndershëm në çdo situatë dhe rrethanë. Kjo është këshilla profetike: “Ju këshilloj të jeni të sinqertë, sepse sinqeriteti të çon në mirësi dhe mirësia të çon në xhenet. Një njeri që e ka të vërtetën si parim, shkruhet si i sinqertë te Allahu. Ju ndaloj të gënjeni, sepse gënjeshtria të çon në mëkat dhe mëkati të çon në xhehenem. Nëse njeriu gënjen vazhdimisht, ai shkruhet si «kedhhab-gënjeshtar» te Allahu.» (Buhari, Edeb, 69; Muslim, Birr, 103-105.)

Ndershmëria e Ka’bit (r.a.), duke e ditur se ai nuk kishte justifikime, ishte se ai pranoi që gjykimi të jepej nga Allahu i Gjithëdijshëm. Ai kishte gabuar, kështu që e pa se do të kishte një çmim dhe u përgatit ta paguante çmimin. Në një mjedis pesëdhjetë e tre ditësh vetmie dhe izolimi, ndërsa e paguan-te çmimin, mbijetoi me kapitalin e tij të vetëm, ndershmërinë. Ndërsa familja dhe miqtë e tij ishin larguar, ai nuk ndryshoi qëndrim kur ndershmëria e tij u sprovua nga thirrja e një emiri, i cili ishte mik

i tij, në formën: “Të është bërë padrejtësi, dera jonë është e hapur për ty.” Allahu që di dhe sheh çdo gjë, e shihte dhe e dëgjonte edhe atë. Falë ndershmërisë së tij, përfitoi nga tregtia që bëri me të.

Ndershmëria e Ulbes (r.a.), ishte dëshmi se dhënia vetëm për hir të Allahut (xh.xh.), do të pranohej nga vetë Zoti. Bamirësia (sadakaja) vjen nga rrënjja e sidkut dhe është dokumenti i ndershmërisë së dhënësit. Nëse nuk ka sidk (sinqeritet), nuk ka sadaka, sepse bamirësia realizohet kur e brendshmja e njeriut është e njëjtë me të jashtmen e tij. Në këtë pikë, askush nuk mund të mashtrrojë askënd, sepse vetë Allahu e merr bamirësinë. Ai i cili e di se Allahu e merr dhe e pranon bamirësinë, detyrimisht duhet të jetë i ndershëm. Ai që ka thënë: “Kini frikë nga gjykimi i asaj gjykate, që gjyqtari i saj është vetë dëshmitar.”, ka shprehur pikërisht këtë kuptim. Ndershmëria është në fakt të jesh i vetëdijshëm se me kë po e bën shitblerjen.

Feja është e ndërtuar mbi një shitblerje. Allahu i Madhëruar ka blerë jetën dhe pasurinë (e besimtarëve) dhe në këmbim ka premtuar xhenetin dhe kënaqësinë e Tij. Në fakt, Ai i ka dhënë përsëri edhe jetën, edhe pasurinë, por liria që Ai ka dhënë është një mirësi e tillë. Ai ia atribuon robit atë që ia ka dhënë dhe dëshiron që ai të bëjë zgjedhjen vetë. Ku qëndron vështirësia këtu? Ajo që kërkohet është paraprakisht, ajo që premtohet i përket të padukshmes. Rreziku është në besimin ndaj të padukshmes. Njeriu, i cili dëshiron atë që është e menjëhershme para tij (axhil), ia kthen shpinën asaj që nuk i ka ardhur ende koha (exhl), kështu që është në humbje. Por ata që janë të kënaqur me atë që u është premtuar duke bërë allishverish me Allahun (xh.xh.), duhet të jenë të lumtur, sepse Allahu është më besniku dhe më i miri nga ata që e mbajnë fjalën. Ata që kanë bërë allishverish me Të, nuk kanë pasur asnjë humbje.

Sinqeritet apo ndershmëri do të thotë të përmbushësh rregullat e allishverishit dhe të mbash fjalën. Fjala është premtimi që i bëjmë Allahut (xh.xh.). Ai është Zoti ynë, ne jetojmë për të qenë robër të Tij. Fjala është premtimi që u kemi bërë njerëzve dhe krijesave. Besimtar është ai njeri prej dorës dhe gjuhës së të cilit të gjithë janë të sigurt. Së fundi, fjala është premtimi që i kemi bërë vetes. Andaj nuk duhet të ketë dallim midis gjuhës, zemrës, gjendjes dhe modelit tonë. Në këtë kontekst, ndershmëria është dorëzimi i së drejtës. Nëse ekzistenca e Zotit është e vërteta, ndershmëria është dëshmia dhe vërtetimi i kësaj të vërtete. Dhe kjo është qetësia shpirtërore: “Lëre atë që të jep dyshim, përqafo atë që

nuk të bën të dyshosh, sepse e vërteta është qetësi e zemrës, ndërsa gënjeshtra është dyshim.” (Tirmidhi, Kijamet, 61.)

Sinqeriteti dhe ndershmëria janë tregtia më fitimprurëse, sepse me këtë tregti bëhesh dëshmitar i Zotit. Ai, i cili vepron me ndershmëri, nuk është hipokrit dhe vepron sikur Allahu e sheh, bëhet dëshmitar i Zotit (xh.xh.). Allahu Teala nuk e lë dëshmitarin e Tij në dorën e askujt dhe nuk lejon që ai të humbasë. Njeriu i ndershëm është gjithmonë i suksesshëm ngase vepron nën kujdesin e Zotit, thotë të vërtetën dhe e ruan ndershmërinë: “O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun dhe thoni fjalë të vërteta, në mënyrë që Allahu t’ju rregullojë punët tuaja dhe t’ju falë mëkatet tuaja. Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, me siguri ka arritur një sukses të madh.” (Ahzab, 70-71)

Sinqeriteti dhe ndershmëria janë thelbi i fesë. I Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam, njërit prej sahabëve, i cili e pyeti: «Ma përshkruaj Islamin në atë mënyrë që të mos ndjej më nevojë të pyes dikë tjetër për të.», i tha: «Thuaj besoj në Allahun dhe pastaj ji i drejtë.» Ndershmëria është një punë vendosmërie dhe vullneti që lidhet me istikametin (orientimin e drejtë). Të jesh i sinqertë është e vështirë, por akoma më e vështirë është të mos jesh i sinqertë. Kushti më i rëndësishëm për të qëndruar i ndershëm (i sinqertë) është mbajtja e gjuhës. Pejgamberi ynë i Nderuar të njëjtit sahab që i sugjeroi sinqeritetin, i tregoi gjuhën sikur po i jepte formulën për të qëndruar i ndershëm kur ai i parashtrij pyetjen: «O i Dërguar i Allahut, për çfarë shqetësohesh më shumë për mua?» Ai që dëshiron t’i mbrojnë fitimet e tij nga tregtia me ndershmërinë, duhet të jetë i kujdesshëm se çfarë thotë dhe çfarë flet.



Një pazar i ri krijohet çdo ditë në tregun botëror

— Dr. Adem Ergyl —

Ajo që duhet bërë është të sillemi si një tregtar i ndershëm në këtë treg të kësaj bote. Emri i kësaj është singëritet ndaj Zotit (xh.xh.) dhe drejtësi e ndershmëri ndaj krijesave të Zotit në emër të Tij. Me fjalë të tjera, të jetosh në istikamet (rrugën e drejtë). Istikamet do të thotë të qëndrosh brenda kufijve të përcaktuar nga Allahu, pa bërë dredhi dhe duke i dhënë hakun gjithçkaje.

Jeta jonë e kësaj bote, e cila është një nga vendet e rëndësishme të akomodimit në udhëtimin drejt jetës së përjetshme, është një vend tregu. Në këtë treg shiten dhe blihen shumë gjëra. Ajo që shisni dhe çfarë merrni në këmbim është jashtëzakonisht e rëndësishme. Kujt dhe çfarë i shet shitësi? Çfarë merr në këmbim të tyre? Ka allishverishe të tilla që njerëzit shesin edhe veten në këtë treg. Por jo çdo shitje është fitimprurëse. I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, ka thënë:

“Të gjithë (shkojnë në treg) në mëngjes dhe i nxjerrin shpirtat e tyre në shitje. Disa e lirojnë atë (shpirtin) dhe e rikthejnë në lirinë e tij të vërtetë, disa e shkatërrojnë dhe e shpërdorojnë.” (Muslim, Taharet 1.

Veçanërisht shik. Tirmidhi, Daavat 86.)

Kurani Fisnik flet për tregti të ndryshme që bëhen në pazarin e kësaj bote. Për shembull, ai tërheq vëmendjen për faktin se ata që e shesin udhëzimin dhe blejnë devijimin janë njerëz që pësojnë humbje në tregtinë e tyre.¹ Në të njëjtën mënyrë, thekson humbjen dhe falimentimin e madh të atyre që e shesin botën e tyre të përhershme për hir të disa përfitime të pakta materiale.² Si kundër kësaj, tregon për fitim të lartë dhe tregti fitimprurëse dhe madje na inkurajon të jemi ambiciozë për një fitim të tillë:

“O ju që keni besuar! A dëshironi t’ju drejtoj për një tregti, e cila ju shpëton nga një dënim i dhembshëm?! Besoni në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij dhe luftoni në rrugën e Allahut me pasurinë dhe trupin tuaj. Kjo, nëse do ta dini, është më mirë për ju. Ai do t’jua falë gabimet tuaja dhe do t’ju shpjerë në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe në banesa të mrekullueshme në xhenetin e Adnit. Kjo është fitorja më e madhe.” (Saf, 10-12)

“Pa dyshim, ata që lexojnë Librin e Allahut, falin namazin dhe japin fshehtazi apo haptazi nga ajo që u kemi dhënë Ne, mund të shpresojnë në një fitim që nuk do të humbasë. Allahu do t’ua plotësojë atyre shpërblimin dhe do t’ua shtojë nga dhuntitë e Tij. Me të vërtetë, Ai është Falës dhe Falënderues.” (Fatir, 29 - 30)

Fakti se kujt dhe për çfarë qëllimi ia shet jetën, pasurinë, mirësitë dhe mundësitë e panumërta që Allahu të ka dhënë, do të nxjerrin në pah fitimin ose humbjen tënde. Zoti (xh.xh.), i Cili dëshiron që robërit e Tij të mos humbin dhe të arrijnë fitime të larta, i këshillon njerëzit që të mos e shesin veten

1. Shik. Bekare, 16.

2. Shik. Bekare, 41, 174; Al Imran, 77.

lirë. Ai na tregon për flijimin e mallrave dhe të jetës ndaj Tij duke premtuar të paktën dhjetë me një. Natyrisht, Ai nuk ka nevojë për pasurinë apo jetën tonë. Por Ai dëshiron që ne të fitojmë shumë. Siç shprehet Mevlana: “Nëse jep bukë për hir të Zotit, edhe ty do të të japin bukë, por nëse jep jetë, do të të jepen shumë jetë të tjera.”

Në Besëlidhjen e Akabesë të Dërguarit të Allahut (a.s.), iu bë kjo pyetje: «Çfarë ka në këmbim për të mbrojtur fenë e Allahut dhe të dashurit të Tij dhe për të bërë xhihad me pasurinë dhe jetën për këtë qëllim?» I Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, u përgjigj: «Xheneti!» Kur Abdullah ibn Revaha e dëgjoi këtë përgjigje, tha: «Sa tregti fitimprurëse që kemi bërë.» Edhe Allahu i Madhëruar e miratoi dhe e lavdëroi një tregti të tillë në Kuranin Fisnik.³

Po, edhe zgjedhja e klientit në tregun e kësaj bote kërkon mençuri dhe largpamësi. Zoti (xh.xh.), i Cili është poseduesi i gjithçkaje, pothuajse bëhet përsëri klient për ne dhe dëshiron që të fitojmë më shumë. Atëherë, a ka gëzim më të madh se të jesh një shitës, klienti i të cilit është Zoti (xh.xh.)?! Kushdo që e shet veten për diçka tjetër përveç xhenetit dhe pëlqimit hyjnor është mashtruar. Çfarë humbje e madhe është të heqësh dorë nga të gjitha mundësitë, nga jeta, madje edhe nga shpirti yt për hir të komplimenteve dhe lavdërimeve të të tjerëve përveç Zotit dhe për hir të dëshirave të tua vetjake?! Shkalla e humbje-fitimit të tregtisë së kësaj bote do të shfaqet në botën e përtejme. Çfarë pasurie e madhe është të fitosh atje dhe sa përpëlitse e dhimbshme është të humbasësh!

Ajo që duhet bërë është të sillemi si një tregtar i ndershëm në këtë treg të kësaj bote. Emri i kësaj është sinqeritet ndaj Zotit (xh.xh.) dhe drejtësi e ndershmëri ndaj krijesave të Zotit në emër të Tij. Me fjalë të tjera, të jetosh në istikamet (drejtimin e duhur). Istikamet do të thotë të qëndrosh brenda kufijve të përcaktuar nga Allahu, pa bërë dredhi dhe duke i dhënë hakun gjithçkaje. Po, të jesh i tillë dhe veçanërisht të qëndrosh kështu kërkon një përpjekje të mundimshme. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Qëndroni në rrugën e drejtë dhe shikoni se çfarë ndodh...” (Ibn Maxhe, Taharet, 4.)

I Dërguari i Allahut (a.s.), i cili është xhevamiu'l-kelim, që do të thotë se fliste me pak fjalë që kishin shumë kuptime, vallë, çfarë ka synuar me këtë hadith fisnik? Komentuesit tanë theksojnë kuptimet e mëposhtme:

3. Shik. Junus, 58.

• Përpiquni të jeni të drejtë në çdo çështje. Në të vërtetë, kurrë nuk mund ta arrini këtë plotësisht. Por mos hiqni dorë nga përpjekjet në këtë drejtim në masën e mundësisë suaj. Edhe nëse keni të meta, gabime, mëkate dhe rrëshqitje të këmbëve, prapë se prapë mbahuni fort pas pendimit dhe istigfarit (kërkimit të faljes nga Zoti)...

• Qëndroni në rrugë të drejtë. Ka aq shumë zona ndaj të cilave duhet të bëni kujdes në emër të istikametit (rrugës së drejtë), saqë është e pamundur t'i zbatoni të gjitha dhe të arrini istikametin në secilën prej tyre. Atëherë, strehohuni te mëshira e Zotit (xh.xh.) dhe jini gjithmonë në gjendje lutjeje e përgjërimit ndaj Tij dhe kërkoni ndihmën e Tij, në mënyrë që Ai t'ua mbajë të forta këmbët tuaja në rrugën e drejtë.

• Një kuptim tjetër është ky: Ju qëndroni në rrugë të drejtë dhe falë këtij qëndrimi nuk do t'i merrni dot me mend, t'i numëroni apo t'i kuptoni bekimet dhe mirësitë e kësaj bote dhe të botës së përtejme që do t'ju dhurohen.

Zoti i Madhëruar e shpall në Kuranin Fisnik se istikameti, apo shprehur me fjalë të tjera, qëndrimi i ndershëm dhe i duhur i robit ndaj Zotit dhe krijesave të Tij, do të jetë shkak për arritjen e shumë mirësive edhe në këtë botë, edhe kur ai të japë frymën e fundit, edhe në botën e përherëshme:

«Sikur të qëndronin (banorët e Mekës) në rrugën e vërtetë, Ne do t'u jepnim ujë të bollshëm, për t'i vënë ata me këtë në sprovë...» (Xhin, 16-17)⁴

Një tjetër nga frutat e panumërta të pemës së istikametit është të kujtuarit me një emër të bukur dhe lutje pas vdekjes, sepse istikameti e fut njeriun në karvanin e profetëve, të sinqertëve, dëshmorëve dhe njerëzve të devotshëm, të cilëve Allahu i Lartësuar u ka dhënë mirësi të mëdha. Ky grup njerëzish të lumtur do të kujtohet gjithmonë me përshëndetje dhe dashuri në tokë dhe në qiell deri në Ditën e Gjykimit.

4. Për begatinë e istikametit veçanërisht shik. Nahl, 97; Nuh, 10-12; Fussilet, 30.



Thesari i sinqeritetit

— Prof. dr. Sulejman Derin —

Sinqeriteti ka shumë shkallë në gjuhë, zemër, besim dhe vepra. Ata që e arrijnë sinqeritetin në disa prej këtyre quhen sadik, kurse ata që e arrijnë sinqeritetin në të gjitha quhen Siddik. Ndoshta për shkak se ka shumë pak siddikë, Zoti në Librin e Tij Fisnik ka urdhëruar që të qëndrojmë me sadikët, jo me siddikët. Ky urdhër është receta e arritjes së sidkut/sinqeritetit: Njeriu duke qëndruar bashkë me sadikët, mund të arrijë sidkun (sinqeritetin).

Sidk quhet të qenët e njeriut i sinqertë dhe i ndershëm në besimin, veprat, qëllimet, fjalët, veprimet dhe sjelljet, dhe që në zemrën e tij të mos ketë mashtrim apo dyshim. Siddikijeti (sinqeriteti) është një nga nivelet më të larta të rrugës shpirtërore. Sepse është jashtëzakonisht e vështirë për njeriun që të jetë i sinqertë me Zotin, njerëzit dhe të gjitha qeniet e tjera në çdo kohë. Zoti i Madhëruar i ka lavdëruar besimtarët e sinqertë të cilët kanë arritur sukses në lidhje me këtë çështje në ajetin e mëposhtëm: **“Midis besimtarëve ka të atillë, që e kanë mbajtur besëlidhjen me Allahun. Disa prej tyre kanë vdekur, kurse të tjerët presin për të rënë dëshmorë pa ndryshuar asgjë nga besnikëria e tyre.”** (Ahzab, 23)

Imam Kushejri e përshkruan aspektin shumëdimensional të sidkut siç vijon: «Sidk do të thotë që njeriu të mos ketë dredhi në sjelljet e tij, të mos ketë dyshim në besimin e tij dhe të mos ketë të meta apo mangësi në veprimet e tij.» Kjo lloj ndershmërie ka qenë veçori e njerëzve të jashtëzakonshëm vetëm si Ebu Bekri (r.a.). Fakti që Ebu Bekri (r.a.), është hallka e dytë në silsilen (zinxhirin) e Nakshibendizmit pas Profetit (a.s.), e ka bërë botëkuptimin e tij për siddikijetin/sinqeritetin edhe më të rëndësishëm në mesin e sufive. Në të njëjtën mënyrë, edhe Libri ynë i Shenjtë, Kurani Fisnik, e paraqet sinqeritetin si gradën e dytë menjëherë pas profecisë: **«Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhënë shumë dhunti: Me profetët, me të sinqertët, me dëshmorët dhe me të drejtët! Eh sa shokë të mrekullueshëm janë**



këta!» (Nisa, 69) Askush nuk mund të bëhet profet duke punuar, por njeriu mund të arrijë gradën e sinqeritetit duke u përpjekur dhe arritur mëshirën e Allahut (xh.xh.). Në këtë këndvështrim, sufizmi është metoda e arritjes së gradës së sidkut/sinqeritetit.

Sipas sufive, pengesa më e madhe përpara sinqeritetit është interesi vetjak i njeriut, dashuria për këtë botë dhe lakmia ndaj saj. Njeriu që ia kushton zemrën kësaj dynjaje nuk mund ta japë zekatin, nuk mund ta falë namazin, nuk mund të jetë i ndershëm në tregtinë e tij, nuk mund të mos mashtrtojë njerëzit, nuk ka frikë nga betimet e rreme, me pak fjalë, nuk mund ta përmbushë premtimin që ia ka dhënë Zotit (xh.xh.). Mevlana e sheh arsyen e mungesës së sinqeritetit dhe pandershmërisë tek njerëzit në dashurinë e tyre për botën dhe lakminë e tyre ndaj saj:

“Dije mirë se prirja e tepërt ndaj pasurisë së kësaj bote dhe tamahu të verbojnë. Këta ta marrin “jakinin-besimin e palëkundur” dhe të bëjnë të dyshosh. Për shkak të tamahut, e vërteta të duket e rreme. Për shkak të tamahut, të kaplojnë me qindra verbëri. Andaj shmangu nga tamahu ashtu si njerëzit e pastër që ecin në rrugën e së vërtetës dhe shpëto, në mënyrë që të shkelësh në pragun e shtëpisë së të vërtetës! Nëse mund të hysh brenda nga ajo derë, do të shpëtosh nga të këqijat dhe gjendjet e neveritshme të kësaj bote, atëherë do të të ndriçohet syri i zemrës, e sheh të vërtetën dhe shpëton nga errësira e mosbesimit.» (Vëll. 3:65-70.)

Të gjitha rrugët e sufizmit përpiqen të heqin nga zemra dashurinë ndaj kësaj bote. Kur të dalë nga zemra dashuria ndaj kësaj bote, bëhet më e lehtë arritja e gjendjes së sinqeritetit. Sipas Imam Rabbanit, ata që janë më në krye të sufizmit janë trashëgimtarët e sinqeritetit të Ebu Bekrit (r.a.), sepse, ashtu si Ebu Bekri (r.a.), edhe ata e kanë dëbuar dashurinë ndaj kësaj bote nga zemrat e tyre, ata janë liruar nga lakmia dhe bëjnë çdo përpjekje për ta përmbushur çdo premtim që ia kanë dhënë Zotit (xh.xh.). Paraja, pozita dhe asnjë interes material apo moral nuk mund t'i pengojë ata nga përkushtimi ndaj Zotit (xh.xh.). Imam Rabbani e përshkruan këtë rrugë të sinqeritetit të ndjekur nga sufijtë si më poshtë:

“Gdhendjet e dashurisë ndaj kësaj bote janë shkërmoqur në thellësitë shpirtërore të tyre, saqë edhe nëse e detyrojnë veten për një mijë vjet dhe përpiqen të mendojnë për këtë botë, përsëri nuk mund të mendojnë... Gjendjen e tyre e përshkruan ky ajet kuranor: **“Ata janë burra (trima) të tillë saqë as tregtia, as allishverishi nuk i pengojnë dot të kujtojnë Allahun.**» Përkatësia e tyre ndaj Ebu Bekr es-Siddikut është më e lartë se përkatësia ndaj të gjithë murshidëve.» (Vëll. 2, 243.)

Rezultatet e sinqeritetit dhe pasojat e gënjeshtërisë na janë shpjeguar me detaje në shumë hadithe. Sipas asaj që është transmetuar nga Ibn Mes'udi (r.a.), i Dërguari i Allahut (a.s.), në një hadith ka thënë: *«Sinqeriteti e shpie njeriun në virtyt, kurse virtyti e shpie në xhenet. Njeriu duke thënë të vërtetën regjistrohët si i sinqertë tek Allahu. Ndërsa gënjeshtria e shpie njeriun në gjynah. Ndërkohë gjynahu e shpie në zjarr. Njeriu duke gënjyer vazhdimisht, më në fund shënohet si gënjeshtar (shumë gënjeshtar) tek Allahu.»* (Buhari, Edeb, 69.)

Sipas Imam Gazaliut, sinqeriteti ka shumë shkallë në gjuhë, zemër, besim dhe vepra. Ata që e arrijnë sinqeritetin në disa prej këtyre quhen sadik, kurse ata që e arrijnë sinqeritetin në të gjitha quhen Siddik. Ndoshta për shkak se ka shumë pak siddikë, Zoti në Librin e Tij Fisnik ka urdhëruar që të qëndrojmë me sadikët, jo me siddikët. Ky urdhër është receta e arritjes së sidkut/sinqeritetit: Njeriu duke qëndruar bashkë me sadikët,

mund të arrijë sidkun (sinqeritetin).

Pa sinqeritet asnjë vepër nuk është e dobishme. Qoftë edhe një dijetar që konsiderohet se e njeh mirë Islamin, e shet fenë e tij me çmim të ulët kur t'i mungojë besnikëria dhe nuk heziton t'i sakrifikojë vlerat shpirtërore për përfitimet e tij personale. Në fakt, gjatë sundimit të Shahut Ekber, dijetarët dhe hoxhallarët që ishin besnikë ndaj fesë së tyre si Imam Rabbani u persekutuan dhe madje u burgosën. Si kundër kësaj, dijetarët, të cilët donin të kishin një pozicion pranë Shahut Ekber, bënë sehir ndaj shkatërrimit të Islamit dhe madje e ndihmuan Sulltanin në këtë çështje. Umeti po përjeton sot një krizë serioze sinqeriteti dhe shumë dijetarë, detyra kryesore e të cilëve është mbrojtja e Islamit, janë të zënë me fetva në mbrojtje të tradhtisë së mbretërve dhe udhëheqësve të vendeve të tyre. Historia sikur po përsëritet.

Për këtë arsye, Imam Gazaliu na këshillon që gjithmonë ta kontrollojmë korrektësinë e qëllimeve tona në çdo punë. Njeriu e fillon një punë të mirë me qëllim të mirë, por në mes të punës mund t'i ndryshojë qëllimi dhe mund ta humbasë sinqeritetin. Në një hadith të gjatë të transmetuar nga Ebu Hurejra (r.a.), Zoti vë në pikëpyetje sinqeritetin e tre njerëzve që kanë bërë vepra të mira dhe sakrificat të mëdha, dhe i gjykon ata në bazë të sinqeritetit të qëllimeve të tyre, jo në bazë të veprave të tyre:

“Njerëzit e parë që do të merren në llogari në Ditën e Gjykimit janë këta tre persona: Dëshmori, dijetari dhe pasaniku që e shpenzon pasurinë e tij në rrugën e Allahut sa për sy e faqe të botës. Allahu i Lartësuar e merr në llogari fillimisht dëshmorin, pastaj dijetarin dhe pastaj pasanikun që e shpenzon pasurinë e tij në bamirësi dhe të gjithë thonë se atë që e ka bërë e ka bërë për hir të Allahut. Allahu Teala nxjerr në pah mungesën e sinqeritetit në qëllimet e të gjithëve dhe u thotë secilit prej tyre: *«Gënjeve.»* Kështu zbulon qëllimet e vërteta të të gjithëve. Të gjithë njerëzit e këtyre tri klasave kanë vepruar në mënyrë që të tjerët të flasin për ta, dhe si rrjedhojë, të gjithë do të hidhen me fytyrë në xhehenem me urdhër të Allahut.” (shik. Muslim, Imaret 152.)

Siç shihet, këto tri grupe, të cilët kanë bërë veprat më të mira të urdhëruara nga Islami, do të hidhen në xhehenem vetëm për shkak se qëllimet e tyre ishin të prishura dhe nuk ishin të sinqertë me njerëzit dhe Zotin (xh.xh.). Lutja ime ndaj Zotit është që të na e mundësojë të arrijmë sinqeritetin në fjalët, veprat dhe botën tonë të brendshme. Të na mbrojë nga gënjeshtria dhe mashtrimi, të cilat janë prej mëkateve të mëdha. Amin!



Mbijetesa e Perandorisë Osmane për 600 vjet nuk u arrit me luftëra dhe me plaçka të luftërave, por me ndihmën dhe administratat e orientuara drejt shërbimit. Çdo lëvizje që nuk i prek njerëzit dhe nuk synon t'i mbajë ata gjallë, nuk është e përhershme. Qëndrueshmëria arrihet me drejtësi, jo me armë.

NJERËZIT QË JANË SIGURI PËR JETËN

— Ali Riza Temel —

«Shërbimi ndaj njerëzve është shërbim ndaj Zotit», thonë. Meqenëse Zoti (xh.xh.), i do të gjitha gjallesat, veçanërisht njerëzit, Ai e konsideron shërbimin që u bëhet njerëzve sikur t'i bëhej Atij. Dihet se Allahu i Madhëruar nuk ka nevojë për shërbim. Kjo është vetëm për t'i inkurajuar robërit e Tij që të shërbejnë dhe për t'i nxitur në vepra të mira.

Ka njerëz të jashtëzakonshëm që i shërbejnë popullit nga dashuria ndaj adhurimit dhe i përkushtohen bamirësisë. Këta janë robër të veçantë të Allahut (xh.sh.). Ata janë të zgjedhurit. Në fakt, lidhur me këto Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *“Allahu ka robër të tillë që i ka krijuar për të plotësuar nevojat e njerëzve. Në kohë nevoje, njerëzit strehohen te ata. Këta njerëz nesër do të jenë të sigurt nga dënimi i Allahut.”* (Mundhiri, Istinau'l-Maruf, H. Nr: 3.) Çfarë lumturie është të caktohesh posaçërisht nga Allahu për shërbim. Këta njerëz të jashtëzakonshëm, veçanërisht profetët, të cilët e kanë bërë këtë detyrë me dashuri, pa pritur asgjë në këmbim, për më tepër duke duruar fyerje dhe persekutime të ndryshme, janë krenaria e njerëzimit. Ata kujtohen gjithmonë me mëshirë dhe lutje.

Në shoqëri, njerëzit në përgjithësi klasifikohen si zotërinj (që marrin shërbime) dhe shërbëtorë (që shërbejnë). Zotëruesit shihen si dinjitozë, kurse shërbëtorët si shtresë e ulët. Ky është një nocion



jashtëzakonisht i gabuar. Në fakt, e kundërta është e vërtetë. Për shkak se zotërinjtë janë të paaftë për të bërë punën e tyre, ata kanë nevojë për shërbëtorët. Për këtë arsye, Muhamedi (a.s.), e ka shprehur shkurtimisht se kush janë zotërinjtë e vërtetë duke thënë: *«Zotëria i popullit është ai që i shërben popullit.»* Kurse me fjalët: *“Më i miri i njerëzve është më i dobishmi për njerëzit.”*, ai ka deklaruar se cilët janë njerëzit më të dobishëm dhe më të vlefshëm.

Fryma që i kthen njerëzit në engjëj të mirësisë është fryma e besimit në jetën e përvetshme dhe pavdekësinë, për t'u kujtuar gjithmonë me mirësi e mëshirë me veprat e dobishme të mbetura dhe lutjet që do të marrin. Ky shpirt është fryma e bamirësisë së vazhdueshme. Fakti se libri i veprave nuk mbyllet dhe vazhdon sikur të ishte gjallë me shërbimet dhe punët e mira që lë pasi vdes, është se dera e shpërblimit është gjithmonë e hapur.

Kushdo që u shërben të tjerëve pa kushte, në fakt i shërben vetes. Edhe pse nuk pret falënderime nga njerëzit, Allahu, i Cili nuk lë asgjë pa përgjigje, sigurisht që nuk do ta lërë atë pa shpërblyer. **«Sa i përket atyre që besuan dhe bënë vepra të mira, ne nuk ua humbim shpërblimin atyre që bëjnë vepra të mira.»** (Kehf, 30)

Qytetërimi ynë është qytetërimi i shërbimit. Parardhësit tanë në mënyrë të veçantë nuk i shfrytëzuan burimet e vendeve që pushtuan, përkundrazi, dhanë shembull me vakëfet që ndërtuan dhe institucionet që u shërbenin të gjithë njerëzve, madje edhe kafshëve, pa dallim feje, sekti apo race, dhe shfaqën qytetërim dhe njerëzim të vërtetë. Edhe sot, në shumë vende nga Hixhazi në Afrikë, nga Ballkani në Evropë, shumë prej këtyre veprave janë ende në këmbë, duke dëshmuar madhësinë e të parëve tanë.

Xhamitë dhe mesxhidet, shkollat dhe medresetë, institucionet për të ndihmuar të varfrit dhe nxënësit,



teqetë dhe zavijet, bibliotekat, bujtinat, spitalet, çezmat, burimet publike, banjat, makberet (varrezat), rrugët dhe urat etj., janë manifestimet më të gjalla të shpirtit të bamirësisë, mirësisë dhe dashurisë së tyre për shërbimin.

Për të dhënë një shembull të shkurtër të vitalitetit të shpirtit të shërbimit të të parëve tanë, mund të përmendim disa vepra të shekullit të 16-të. Dihet se në katërbëdhjetë kuzhinat e ndërtuara nga Mimar Sinani në atë kohë punonin gjithsej 2529 veta. Si shenjë e mirudhëheqjes së Sulltan Fatihut, 4250 dyqane, tri hane pune, katër banja, shtatë pallate, nëntë kopshte dhe 1130 shtëpi u dhuruan si vakëf në Stamboll dhe rrethin e Gallatës.

Ka shembuj shumë interesantë të llojeve të këtyre shërbimeve, të cilat janë simbole të mëshirës, ndërgjegjes dhe mirësisë së pafundme. Strehëza zogjsh në kupolat dhe çatitë e ndërtesave historike, spitale kafshësh, vakëfe të veçanta për lejkët me krahë të thyer, vakëfe të krijuara për të përgatitur prikë për vajzat jetime. Organizata të krijuara për shpërndarjen e ujit të ftohtë në verë, etj... Në tre muajt më të nxehtë të vitit, në Sulejmanije u krijua një vend bamirësie për të shpërndarë ujin e marrë nga bora e pastër tek ata që kalonin nëpër Stamboll, si dhe njësi shërbimi edhe për abdest me ujë të nxehtë në ditët e dimrit.

Mbijetesa e Perandorisë Osmane për 600 vjet nuk u sigurua nga luftërat dhe plaçkat e luftërave, por nga administratat e orientuara nga ndihmat dhe shërbimet. Çdo lëvizje që nuk i prek njerëzit dhe nuk synon t'i mbajë ata gjallë, nuk është e përhershme. Qëndrueshmëria arrihet me drejtësi, jo me armë.

Njerëzit e shërbimit jetojnë për të tjerët. Ata nuk ia japin zemrën kënaqësisë së të jetuarit, por dashurisë për t'u mundësuar të tjerëve të jetojnë. Kjo është për ta kënaqësia më e madhe dhe qëllimi më i shenjtë.

Fryma e shërbimit është mishërimi i dhembshurisë dhe vetëflijimit. Çdo vepër bamirësie dhe shërbimi është si një statujë e ngritur në sheshin e mëshirës dhe dashurisë. Ata që i nxjerrin në pah këto vepra, nuk kanë nevojë për një skulpturë personale. Ata jetojnë përmes veprave të tyre dhe kujtohen me dashuri, mëshirë dhe lutje.

Në një nga strofat e tij, gjysma e të cilës më kujtohet, poeti thotë: “Njeriu i shërbimit vjen njeri dhe shkon njeri.” T’u shërbesh njerëzve do të thotë të jesh njeri. Sipas kësaj, njerëzit e shërbimit janë njerëz, tradhtarët nuk janë njerëz.

Kënaqësitë nuk kanë të bëjnë vetëm me të ngrënë të dhe të pirët, të ecurit dhe të shëtiturit, të martuarit dhe të argëtuarit. Ka kënaqësi që nuk i njohin dhe nuk i shijojnë ata, kapitali i të cilëve përbëhet vetëm nga trupi. Kënaqësitë fizike ekzistojnë në momentin që shijohen dhe nuk kanë vazhdimësi. Kurse kënaqësitë shpirtërore dhe ato të ndërgjegjes freskohen ndërsa kujtohen dhe i mbajnë njerëzit gjallë. Nga ana tjetër, paskrupulloziteti të dërrmon sa herë që e kujton. Nuk ka qenie njerëzore që ndihet mirë nga e keqja që ka bërë.

Sa mirë ka thënë filozofi: “Nëse dëshiron të jesh i lumtur, bëj mirë.”

Dhembshuria është gjendja e tejkalimit të vetvetes dhe integritit me qeniet. Është të jesh në gjendje të ndjesh dhimbjen e një zogu me krahë të thyer, vuajtjet e të uriturve dhe të eturve. Më kujtohen gjithmonë fjalët e Tolstoit: “Kur njeriu ndjen dhimbje, ai është i gjallë. Nëse ai ndjen dhimbjen e tjetrit, është njeri.”

Njerëzit e shërbimit ruajnë dinjitetin e njerëzimit. Ata na kujtojnë humanizmin, dhembshurinë dhe dashurinë. Ata janë sigurimi i jetës. Pa ta jeta nuk ka kuptim.

Le ta dëgjojmë nga njeriu model, Pejgamberi (a.s.), se kush është njeri i vërtetë: “I thanë atij: O i Dërguari i Allahut! Kush është më i dashur nga njerëzit për ty? Resulullahu (a.s.), tha: Ai që është më e dobishmi për njerëzit. Por, cila vepër është më e vërtetshme? Është të gëzosh besimtarin. Si mund ta gëzojmë një besimtar? T’ia shuash urinë, t’i heqësh një hall, t’i paguash borxhin. Kush ecën me vëllain besimtar për t’i plotësuar atij një nevojë, është sikur ka agjëruar një muaj dhe ka bërë itikaf. Atë ditë kur të gjitha këmbët rrëshqasin dhe pengohen, Allahu nuk do të lejojë që t’i rrëshqasin këmbët njeriut që ecën me një njeri që i është bërë padrejtësi, për ta ndihmuar atë. Kush e mban zemërimin e tij, Allahu ia fsheh turpin, morali i keq i prish veprat e mira ashtu si uthulla prish mjaltin.”



PERIUDHA E MEDINËS

NGA BESIMI NË VEPËR

— Dr. Murat Kaja —

Kurani Fisnik donte që besimtarët të jenë të vetëdijshëm për respektin dhe përgjegjësinë ndaj Allahut, të kapeshin pas takvasë (devotshmërisë), t'i drejtoheshin Atij dhe t'i kërkonin falje. Duke qenë se namazi është shumë afër besimit, është urdhëruar me këmbëngulje që në ditën e parë. Kur Hz. Pejgamberi u shpërngul në Medine, filluan të vinin dispozita lidhur me adhurimet dhe trajtimet e tjera. Së pari, u urdhërua agjërimi, i cili do t'i mësonte njerëzit me durim dhe sakrificë. Pastaj ajetet i këshilluan sahabët që të ishin të ndjeshëm ndaj atyre që kanë nevojë për ndihmë.

Për myslimanët, periudha mekase ishte sezoni i forcimit të besimit. Kur shkuan në Medine, filluan të vinin dispozita lidhur me adhurimet dhe marrëdhëniet ndërnjerëzore. Me këto urdhra dhe ndalesa, Allahu donte që t'i përsoste besimtarët në besim e moral dhe t'u jepte atyre mirësi. Për ta shprehur këtë, në fund të ajetit që përshkruan abdestin dhe guslin, Ai thotë: «...**Allahu nuk dëshiron t'ju sjellë ndonjë vështirësi, por Ai dëshiron t'ju pastrojë dhe t'i plotësojë mirësitë e Tij ndaj jush, në mënyrë që ta falënderoni.**»¹ Me fjalë të tjera, njerëzit që e adhurojnë dhe i binden Allahut, jo vetëm që do të pastrohen materialisht dhe shpirtërisht, por do të arrijnë edhe shumë mirësi.² Përsëri, Allahu Teala na ka njoftuar se

Ai u jep mirësi robërve të Tij, të cilët e kujtojnë shumë Atë dhe e shprehin madhështinë e Tij me lutje në mëngjes dhe në mbrëmje, në mënyrë që «t'i nxjerrë ata nga errësira në dritë» me mëshirën e Tij. Ai na e ka bërë të ditur se edhe engjëjt e Tij luten për besimtarët dhe kërkojnë falje.³ Pasi shpalli dispozitat lidhur me martesën, ka thënë: **“Allahu dëshiron t'ju shpjegojë atë që ju nuk e dini, t'ju udhëzojë në rrugët e atyre që ishin para jush dhe t'jua falë mëkatet tuaja. Allahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë.”**⁴


Myslimanët gjithmonë e merrnin të Dërguarin e Allahut (wa.s.), si shembull në fjalët, veprimet dhe gjendjet e tyre. Sidomos në kohë të vështira si Beteja e Hendekut, ata imituan durimin

1. Shik. Maide, 5/6; Enfal, 11.

2. Shik. Taberi, Xhami'u'l-Bejan, VIII, 215-219.

3. Shik. Ahzab, 43; Hadid, 9.

4. Nisa, 26.



e tij, përpjekjen për mbrojtjen e atdheut, përpjekjet e tij në rrugën e Allahut dhe veçorinë e tij për të pritur fitoren nga Zoti (xh.xh.).⁵ Edhe i Dërguari i Allahut (a.s.), e mori moralin e tij nga Kurani.⁶ Myslimanët, të cilët i rritën nivelet e tyre shkencore, praktike dhe morale duke ndjekur këtë njohuri të re që erdhi gradualisht nga Allahu, u bënë shembull për shoqëritë e tjera në çdo aspekt dhe krijuan një shoqëri të matur e të balancuar.⁷

ZEKATI DHE INFAKU

Kurani Fisnik donte që besimtarët të jenë të vetëdijshëm për respektin dhe përgjegjësinë ndaj Allahut, të kapeshin pas takvasë (devotshmërisë), t'i drejtoheshin Atij dhe t'i kërkonin falje.⁸ Duke qenë se namazi është shumë afër besimit, është urdhëruar me këmbëngulje që në ditën e parë. Kur Hz. Pejgamberi u shpërngul në Medine, filluan të vinin dispozita lidhur me adhurimet dhe trajtimet e tjera. Së pari, u urdhërua agjërimi, i cili do t'i mësonte njerëzit me durim dhe sakrificë. Pastaj ajetet i këshilluan sahabët që të ishin të ndjeshëm ndaj atyre që kishin nevojë për ndihmë. Ua kujtoi atyre se poseduesi i vërtetë i çdo gjëje është Allahu. Ata që e harxhonin pasurinë për familjet e tyre, për të varfrit dhe për forcimin e Islamit pa pasur frikë nga varfëria dhe duke i besuar Allahut, u përgëzuan se Allahu do t'u jepte atyre edhe më shumë pasuri. Gjithashtu lajmërohej për epërsinë e atyre që e jepnin pasurinë dhe e sakrifikonin jetën e tyre në kohë të vështira për të përhapur fenë e Allahut (xh.xh.).⁹ Tashmë një myslimani nuk i kishte hije të grumbullonte pasuri pa dhënë zekatin, madje u njoftua se ata që do të vepronin kështu do të përballëshin me

një dënim të dhembshëm. I Dërguari i Allahut, alejhi's-salam, ka thënë:

“Nëse Allahu i jep pasuri dikujt dhe ai nuk e jep zekatin, kjo pasuri do t'i sillet në Ditën e Gjykimit në formën e një gjarpri shumë helmues. Ai ka dy pika të zeza në faqe (që tregojnë intensitetin e zemërimit dhe helmit të tij). Atë ditë, ky gjarpër i tërbuar, do ta mbështjellë në qafë të zotin e pasurisë (duke i mbuluar gojën) dhe do ta kafshojë fort në të dyja faqet duke i thënë: «Unë jam pasuria jote (që e doje aq shumë në dynja), unë jam thesari yt!» - dhe pastaj këndoi ajetin vijues:

“Ata që janë dorështrënguar në shpenzimin e të mirave që u ka dhënë Allahu, të mos mendojnë se kjo është e mirë për ta; përkundrazi, është e keqe për ta. Ajo me të cilën ishin dorështrënguar do t'u mbështillet në qafë në Ditën e Gjykimit. Trashëgimia e qiejve dhe e tokës i takon Allahut. Allahu di gjithçka që punoni ju.”¹⁰

Për këtë arsye, Allahu Teala i ka urdhëruar rreptësisht besimtarët që të shpenzojnë nga ajo që posedojnë për ata që kanë nevojë. Ai ka njoftuar se njeriu nuk mund ta arrijë mirësinë nëse nuk bën infak nga gjërat që i do.¹¹

5. Shik. Ahzab, 21; Ibn Kethir, Tefsir, XI, 133.

6. Shik. Kalem, 4; Muslim, Musafirin, 139.

7. Shik. Bekare, 143; Taberi, II, 626.

8. Shik. Nisa, 131; Tahrir, 8.

9. Shik. Hadid, 7, 10-11; Ibn Kethir, XIII, 409-415.

10. Shik. Al Imran, 180; Buhari, Zekat, 3. Teube, 34.

11. Shik. Bekare, 254, 261-268; Al Imran, 92; Enfal, 3.

MBAJTJA E FJALËS

Me shprehjen: “Pse i thoni ato gjëra që nuk i bëni?!” , Allahu (xh.sh.), i këshillon myslimanët që fjalët dhe veprimet e tyre të jenë në harmoni, pra, bota e brendshme dhe e jashtme e tyre të jetë njëlloj.¹² Një mysliman duhet të jetë besnik ndaj të gjitha marrëveshjeve dhe premtimeve, veçanërisht marrëveshjes së besimit me Allahun (xh. xh.).¹³ Premtimet duhet të mbahen.¹⁴ Kur flitet, duhet thënë vetëm e vërteta. Besimtari duhet të japë gjithmonë dëshmi të vërtetë, edhe nëse është kundër tij apo të afërmeve të tij, pavarësisht nëse njerëzit janë të pasur apo të varfër. Edhe në këtë situatë, të qenët i drejtë, përmbushja e amanetit dhe thënia e së vërtetës janë ndër cilësitë thelbësore të besimtarëve.¹⁵ Sepse ata jetojnë duke marrë parasysh botën tjetër, ku do të përballen me një llogari të vështirë, dhe me këtë vetëdije e formësojnë sjelljen e tyre në drejtim të pëlqimit të Allahut të Madhëruar.¹⁶ Ata e mbrojnë të drejtën e vëllazërisë dhe e ndihmojnë njëri-tjetrin në të gjitha çështjet.¹⁷ Po përjetohej një vëllazëri epike mes ensarëve dhe muhaxhirëve. Allahu dëshironte që edhe myslimanët të cilët vinin pas tyre ta merrnin si shembull këtë vëllazëri.¹⁸ Kur përmendej Allahu, myslimanëve u dridheshin zemrat. Ata duronin kundrejt fatkeqësive që u ndodhnin.¹⁹ Allahu i Madhëruar donte që ata të stoliseshin me cilësi të tilla morale.²⁰

Myslmanëve iu kërkua që gjithmonë t'i flisnin njëri-tjetrit me fjalë të mira dhe ta shpërndanin

përsëritet (selamin) mes tyre.²¹ Detyra më e madhe mbi supet e tyre ishte që të urdhëronin të mirën dhe ta ndalonin njëri-tjetrin nga e keqja.²²

VIJAT E KUQE

Allahu i Madhëruar solli edhe disa ndalesa për mirëqenien e robërve të Tij dhe për të rregulluar jetën e tyre. Myslimanët u urdhëruan që të mos e tradhetojnë Allahun, Profetin dhe amanetet e tyre (fenë), dhe të mos abuzojnë me fenë e tyre.²³ Vrasja e një jete të pafajshme, vjedhja, fitimi i padrejtë, ryshfeti, tregtia me kamatë dhe ngrënia e pasurisë së jetimit u ndaluan rreptësisht.²⁴ Ata u urdhëruan që të mos u afrohen gjërave haram si alkooli dhe bixhozi, të mos shikojnë haram dhe të qëndrojnë larg çdo lloji zinjaje e prostitucioni.²⁵ Dënime të rënda u vendosën për akte të tilla si banditizmi dhe ligësia që e prishnin paqen në tokë.²⁶ U ndaluan rreptësisht sjelljet e këqija si thashethemet, përgojimet, mbartja e fjalëve, llagapet, talljet dhe hetimet e sekreteve të të tjerëve, të cilat e prishin qetësinë e njerëzve dhe të shoqërisë.²⁷

Në ditët e para të hixhretit, myslimanët u lejuan të luftojnë kundër shtypësve të tyre dhe me kalimin e kohës ky u bë një urdhër absolut.²⁸ Me pak fjalë, myslimanët ishin vazhdimisht vigjilentë ndaj kërcënimeve të brendshme dhe të jashtme. Pavarësisht gjithçkaje, ata ndërjuan një shoqëri shembullore në besim, në vepra dhe në moral. Ata e morën si shembull të Dërguarin e Allahut (a.s.) dhe u bënë shembull për mbarë njerëzimin.

12. Shik. Nur, 47-53; Ahzab, 12-15; Saff, 2.

13. Shik. Maide, 1; Ibn Kethir, V, 8-9.

14. Shik. Bekare, 225; Al Imran, 77; Maide, 89; Ibn Kethir, V, 321.

15. Shik. Nisa, 135; Maide, 8; En'am, 152; Taberi, VII, 584-594.

16. Shik. Bekare, 200-202, 284; Maide, 4; Ra'd, 21; Nazi'at, 40.

17. Shik. Al Imran, 102-103, 107; Nisa, 115; Enfal, 46, 63, 72-75; Teube, 71; Taberi, XI, 556.

18. Shik. Enfal, 75; Teube, 100; Hashr, 10; Xhum'a, 3; Taberi, XI, 637-642.

19. Shik. Haxh, 35; Taberi, XVI, 552.

20. Shik. Al Imran, 133-138; Nisa, 36; Ra'd, 19-24; Insan, 7-11.

21. Shik. Nisa, 86.

22. Shik. Al Imran, 110, 114; A'raf, 157; Tevbe, 71, 112.

23. Shik. Enfal, 27; Teube, 34; Taberi, XI, 120-126, 424.

24. Shik. Bekare, 178-179, 188, 275-280; Al Imran, 130; Nisa, 2, 10, 92-94; Maide, 32, 38; Mumtehine, 12.

25. Shik. Bekare, 219; Nisa, 24-25, 43; Maide, 90-93; Isra, 32; Nur, 2-3, 30-31; Furkan, 68; Mumtehine, 12.

26. Shik. Maide, 33-34.

27. Shik. Huxhurat, 11-12.

28. Shik. Haxh, 39; Teube, 41.

T'U SUGJEROSH TË TJERËVE ATË QË NUK E BËN VETË, ËSHTË FITNE



— M. Sami Ramazanollu —

Hudhejferu'l-Jemani ishte personi që kishte më shumë njohuri për sekretet e të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe për shpjegimin e gjendjeve të hipokritëve dhe detajeve të fitneve që do të ndodhnin në të ardhmen. Ai thoshte: “I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, më tregoi se çfarë ka ndodhur dhe do të ndodhë deri në Ditën e Kiametit.”

Kur kishte ndonjë varrim në Medine, Omeri, (r.a.), kërkonte për Hudhejfen (r.a.). Nëse nuk e shihnte në mesin e xhematit, nuk e falte namazin, duke dyshuar se i vdekuri ishte hipokrit.

Fitne: Në fakt, është një sprovë dhe një provim, që në shqip do të thotë përçarje. Fitneja ka edhe kuptime të tjera të ndryshme.

- 1- Blasfemi, herezi.
- 2- Poshtërsi.
- 3- Fatkeqësi dhe ndëshkim. Prej këtyre nënkuptohet fitneja e dynjasë dhe fitneja e varrit.
- 4- Vrasje, luftë e brendshme (civile).
- 5- Ndryshimi i gjendjes njerëzore nga e mirë në të keqe.
- 6- Të pëlqesh diçka dhe zemra juaj të ndjejë prirje dhe dashuri për të.

Fitneja e fëmijëve dhe e grave janë të këtij lloji. Fitneja e njeriut me njerëzit e tij është që të flasë fjalë të papranueshme në prani të tyre dhe të bëjë punë që nuk janë hallall; kurse fitneja e tij në pasuri është që të marrë pasuri e cila nuk është hallall për t'u marrë dhe ta shpenzojë atë në vende që nuk janë hallall. Fitneja e tij të fëmijët është që të mos gjejë mundësi për shumë vepra të mira për shkak të dashurisë së tepërt ndaj tyre, ose të mos bëjë kujdes ndaj hallallit dhe haramit për të siguruar sa më shumë të ardhura për ta. Fitneja e tij me fqinj është që atij nuk i vjen mirë se ka një fqinj të pasur dhe është ziliqar ndaj tij.

Synimi nga fitneja që tërbohet si deti është fitneja

e madhe që filloi me rënien dëshmor të Osmanit, (r.a.) dhe bëri që umeti i Muhamedit (a.s.), të futej në luftë me njëri-tjetrin. Ajo nuk është shuar që nga ajo ditë. Siç kuptohet, sipas asaj që Hudhejfe (r.a.), ka mësuar nga informuesi i sinqertë, Resulullahu, alejhi's-salam, ekzistenca e Omerit (r.a.), ishte një pengesë e madhe kundrejt fitnes. Përderisa ai të ishte gjallë, fitnet e tmerrshme që po prisnin, nuk do të ndodhnin. Prandaj ka thënë: «Nuk ka asgjë për ty prej saj.»

Hz. Farruku (Omeri) ishte dera e jashtme e bashkimi dhe unifikimit. Përderisa ishte gjallë ai, nuk i mbeti vend fitnes për të sulmuar nga brenda. Pasi dera e jashtme u hap me rënien dëshmor të Omerit, tradhtarët që ishin në krye të fitnes, gjetën mundësinë për të sulmuar kalifin, Dhu'n-Nurajnin. Fakti që Omeri, (r.a.), bëri pyetje rreth fitnes që do të vinte pas tij, edhe pse e dinte se ai vetë ishte dera, tregon se ai e dinte se sa e madhe ishte fitneja dhe nëse i kishte harruar detajet e saj, t'i kujtonte. Ai kishte frikë se ndoshta do të shfaqej koka e saj në periudhën e tij!

Usame, (r.a.), ka thënë se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (a.s.), duke thënë:

«Ditën e Kiametit njeriu do të sillet dhe do të hidhet në xhehenem, ku zorrët do t'i dalin menjëherë nga barku. Dhe do të rrotullohet siç rrotullohet gomari i mullirit në mulli. Pas kësaj, banorët e xhehenemit do të mblidhen rreth tij dhe do t'i thonë:

“O filan, si është puna jote? A nuk je ti ai që na këshilloje për të mirën dhe na ndaloje nga e keqja?”

Ai do t'u përgjigjet:

“Po, ashtu kam qenë. Por unë ju urdhëroja të mirën, ndërsa vetë nuk e bëja. Përsëri, unë ju ndaloja nga mëkati, ndërsa vetë e bëja.” (Përkthimi Texhridi Sarih, 9 / 57.)



SI DUHET TA KUPTOJMË

DUANË?

— Dr. Naif Ozkul —

Duaja është esenca e devotshmërisë. Duaja është braktisje e egos dhe mendjemadhësisë, dhe përlujë në derën e Zotit. Ajo është pranim i dobësisë dhe përkohshmërisë nga ana e robit dhe kërkim i mëshirës dhe ndihmës hyjnore.

SI DUHET TA KUPTOJMË DUANË?

Sigurisht që ashtu siç na ka urdhëruar Zoti ynë dhe siç na ka mësuar i Dërguari i Tij (a.s.)...

Le të dalim në një udhëtim drejt kuptimit të thellë të duasë dhe edukatës së saj në shoqërinë e shëni-meve prej një ligjërate që kam dëgjuar në Medine-i Munevvere:

E FSHEHTA E DUASË DHE KADERIT

Profeti ynë i dashur (a.s.), thotë:

“...Duaja është e dobishme për të gjitha llojet e fatkeqësive; për ato që kanë ndodhur dhe për ato që nuk kanë ndodhur ende. Vetëm duaja mund ta kthejë kadanë (realizimin e caktimit të Zotit). Atëherë, ju duhet të bëni dua!” (Tirmidhi, Deauat, 112.)

Dijetarët kanë thënë:

“Duaja është armiku i fatkeqësisë (e largon atë)”

Duaja ka dobi dhe forcë ndikimi të jashtëzakonshme.

Rukja, është kërkimi i shërimit duke lexuar duatë përkatëse. Dobia e tyre është e vërtetuar nga hadithet e Profetit (a.s.).

Edhe ekzistenca e kaderit (caktimi nga Zoti i çdo gjëje që do t'i ndodhë robit), edhe dobia e duasë,

në dukje mund të shkaktojë pikëpyetje në mendje. Mirëpo, në të vërtetë, dobia e duasë dhe besimi në kader, nuk bien ndesh me njëra-tjetrën.

Lidhur me këtë;

Ebu Hizame (r.a.), tregon:

“(Një ditë) E pyetën të Dërguarin e Allahut (a.s.):

- O i Dërguar i Allahut! Çfarë mund të na thoni në lidhje me ilaçet që përdorim për t’u kuruar, për duatë që bëjmë me dëshirën për t’u shëruar dhe për sendet mbrojtëse (si mburoja, parzmore, etj.) që përdorim për t’u mbrojtur nga armiqtë; a e ndryshojnë dhe e kthejnë mbrapsht kaderin këto?

I Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

“Edhe këto që ke përmendur janë kader i Allahut.” (Ibn Maxhe, Tib, 1.)

Allahu i Madhëruar nuk ndikohet aspak nga faktori kohë. Në aspektin e bërjes apo jo të duasë, për ne ka dy mundësi. Allahu, i Cili e di se ne do të bëjmë dua dhe na e mundëson këtë, e largon mundësinë e fatkeqësisë me anë të duasë (që bëjmë) dhe na fal mirësi. Pra, duaja është me të vërtetë e dobishme; ajo është ndryshim i kaderit me kader.

Duaja është diçka madhështore.

Numan bin Beshir (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

الدُّعَاءُ هُوَ الْعِبَادَةُ

“Duaja është vetë adhurimi.” (Ebu Daud, Vitri, 23; Tirmidhi, Tefsiru’l-Kuran, 3, 41, Deauat, 1.)

Më pas këndoi këtë ajet fisnik:

وَقَالَ رَبُّكُمْ ادْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ إِنَّ الَّذِينَ يَسْتَكْبِرُونَ
عَنْ عِبَادَتِي سَيَدْخُلُونَ جَهَنَّمَ دَاخِرِينَ

“Zoti juaj ka thënë: «Lutmuni Mua, se do t’ju përgjigjem! Me të vërtetë, ata që tregohen mendjemëdhenj e nuk duan të Më adhurojnë, do të hyjnë në Xhehenem të poshtëruar!»” (Gafir, 60.)

Një hadith tjetër që shpreh dobinë e duasë, është edhe ky:

لَيْسَ شَيْءٌ أَكْرَمَ عَلَى اللَّهِ تَعَالَى مِنَ الدُّعَاءِ

“Tek Allahu nuk ka gjë më të pranuar dhe më të çmuar se duaja!” (Tirmidhi, Deauat, 1; Ibn Maxhe, Dua, 1.)

Allahu i do ata që i luten Madhërisë së Tij. Ndërsa

ata që nuk i luten dhe nuk kërkojnë gjë prej Tij, e zemërojnë Atë, sepse duaja është një vepër shumë e dashur për Allahun. E në fakt, duaja është dalje e robit para Zotit të vet dhe shtrirje e dorës ndaj Tij duke shfaqur me përlulje nevojat që ka.

Zoti ynë u përgjigjet duave tona me patjetër, sepse një nga emrat mes emrave më të bukur të Zotit tonë, është “el-Muxhib / Pranuesi”.

Në një hadith fisnik, lidhur me pranimin e duasë na jepen disa këshilla për të cilat duhet të bëjmë kujdes:

“Nëse një mysliman kërkon nga Allahu diçka që nuk është është gjynah, ose nuk dëshiron të presë lidhjen me të afërmit, Allahu Teala patjetër ia plotëson dëshirën atij, ose e largon nga e keqja aq sa do t’i jepte.”

Sahabët thanë: “Atëherë ne do të kërkojmë shumë gjëra nga Allahu!”

i Dërguari i Nderuar tha: “-Mirësia e Allahut është më e madhe se sa gjërat që kërkon ju.” (Tirmidhi, Deauat, 115/3573; Ahmed, III, 18)

Si fillim, në këtë hadith vërehen dy kritere të veçanta; duaja nuk duhet të përmbajë gjëra që janë gjynah dhe dëshirë për të shpëtur lidhjet farefisnore. Kjo, sepse njeriu i dobët e i pakujdesshëm, kaplohet nga dëshirat e egos dhe mund të kërkojë edhe gjëra që janë në dëm të tij.

Më pas, prej hadithit kuptojmë se;

Përgjigja e Allahut ndaj duasë sonë, nuk do të thotë që dëshira e robit të realizohet në moment. Ndonjëherë, Ai nuk e jep atë që kërkohet, por e shpëton robin nga një fatkeqësi më e madhe. Ose, i jep robin një shpërblim edhe më të madh në ahiret.

Për rrjedhojë, të thuash; “Unë lutem, por nuk më pranohet!”, është plotësisht e gabuar. Nëse nuk pranohet ajo që kërkon ti, në të vërtetë po të jepet diçka më e rëndësishme se ajo që dëshiron. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut (a.s), ka thënë:

“Lutuni Zotit të Madhëruar, duke besuar se duaja jua do të pranohet!

Dijeni se;

Allahu nuk e pranon lutjen e bërë me zemër indiferente/të shkujdesur!” (Tirmidhi, Deavat, 65.)

Do të thotë se;

Për pranimin e duasë, kërkohet sinqeritet dhe seriozitet. Duatë që bëhen pa vetëdije, thjesht si vjersha se të është mësuar goja, padyshim që nuk mund të marrin përgjigje nga Zoti!.. Prandaj, duhet që duatë të bëhen në harmoni me gjuhën dhe



zembrën. Lidhur me duanë, Allahu i Madhëruar na jep këto myzhde:

وَإِذَا سَأَلَكَ عِبَادِي عَنِّي فَإِنِّي قَرِيبٌ أُجِيبُ دَعْوَةَ الدَّاعِ إِذَا دَعَانِ فَلْيَسْتَجِيبُوا لِي وَلْيُؤْمِنُوا بِي لَعَلَّهُمْ يَرْشُدُونَ

“Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thuaju se) Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua. Prandaj, le t’i përgjigjen thirrjes Sime dhe le të më besojnë Mua, për të qenë në rrugë të drejtë.” (Bekare, 186.)

Lidhur me këtë ajet fisnik, hoxha ynë i nderuar Osman Nuri Topbash, shprehet:

“Allahu i Madhëruar na përgëzon me pranimin e duave të robërve të Vet nevojtarë. Pra, arti i zemrës, është aftësia për t’u ngritur në nivelin që t’i lutesh Allahut të Madhëruar.

Hasan el-Basri thotë:

«Unë nuk kam frikë se mos nuk ju pranohen dua-të, por se mos bini në atë gjendje sa të mos bëni fare dua!»

Kjo, sepse;

Zoti ynë ka një kusht për t’u përgjigjur:

«...(robërit e Mi) **le t’i përgjigjen thirrjes Sime...**»

Pra, të bëjnë një jetë nën dritën e Kuranit dhe Sunetit, të zbatojnë të gjitha urdhrat dhe porosinë e hapëta dhe të fshehta të Allahut dhe të qëndrojnë larg të gjitha haramëve dhe të urreyave të hapëta e të fshehta:

«... dhe le të më besojnë Mua, për të qenë në rrugë të drejtë...»

Pra, të jenë në rrugën e drejtë të udhëzimit dhe të bëhen robër të nderuar që do të meritojnë xhenetin. Po ashtu, duhet të shpëtojnë nga dëshirat e ulëta të egos dhe të pastrojnë zemrat; të largohen nga grada e “*esfeli safilin/më të ultëve*” dhe të arrijnë gradën e “*ala-ji illijjin/më të lartëve*”.

Duaja është përgjërimi ndaj Zotit tonë dhe kërkiti i ndihmës prej Tij. Në suren Fatiha, vërejmë se

Zoti ynë, në fillim përmend adhurimin tonë, pastaj kërkimin e ndihmës. Ne, robërit e dobët e nevojtarë, i përgjrohemi vazhdimisht Allahut. Mirëpo, nëse ne vetëm kërkojmë prej Tij dhe nuk i zbatojmë ato që kërkon Ai prej nesh, kjo nuk përputhet me edukatën e devotshmërisë.

Për këtë arsye;

Për pranimin e duave, është kusht të ushqehesh me hallall dhe të qëndrosh larg haramëve. Në një hadith fisnik thuhet:

“Allahu i Madhëruar, është i pastër dhe pranon vetëm të pastrit. Atë që ua ka urdhëruar profetëve, ua ka urdhëruar edhe besimtarëve. Allahu i ka urdhëruar profetët:

“**O të Dërguar! Hani prej gjërave të pastra dhe hallall dhe bëni punë të mira!**” (Mu’minun, 51.)

Po kështu, edhe besimtarët:

“**O ju që keni besuar! Nga furnizimi që ju kemi dhënë, hani atë që është e pastër!**” (Bekare, 172.)

Ka prej atyre që luftojnë për një kohë të gjatë në rrugën e Allahut. Pastaj, me trup të rraskapitur, kokë e këmbë të pluhurosura, ngrenë duart drejt qiellit dhe luten: «O Zot! O Zot!» Mirëpo ata kanë ngrënë e kanë pirë haram. Por, si mund të pranohet lutja e njerëzve të tillë?» (Muslim, Zekat, 65.)

Një prej rregullave të duasë, është edhe mos përdorimi i fjalëve të tilla si “nëse”. Lidhur me këtë, në një hadith fisnik thuhet:

“Kur ndonjëri prej jush të lutet, të mos thotë; «O Zot! Nëse dëshiron më fal; nëse dëshiron më mëshiro!»». Por ta shprehë prerazi atë që dëshiron, sepse asnjë lloj force që mund ta detyrojë Allahun.” (Buhari, Deauat, 21, Teuhid, 31; Muslim, dhikr, 9.)

Ndërsa në një transmetim tjetër të Muslimit, thuhet:

“...Por ta kërkojë në mënyrë të prerë dhe diçka të madhe, sepse për Allahun asgjë që jep nuk është e madhe.” (Muslim, Dhikr, 8.)

- **Një tjetër prej rregullave të duasë, është edhe mos nxitimi:**



I Dërguari i Allahut (a.s.), thotë:

“Përderisa dikush nga ju nuk ngutet të thotë: «Sa herë që i jam lutur Allahut, duaja nuk më është pranuar!», duaja e këtij personi do të pranohet.” (Buhari, Deauat, 22; Muslim, Dhikr, 90, 91.)

Ndërsa në një transmetim tjetër të Muslimit, thuhet:

“Robit i pranohet lutja përderisa të mos kërkojë diçka që është gjynah apo diçka që do të shkaktojë zemërim me të afërmin e tij apo përderisa të mos nxitojë.” E pyetën:

“O i Dërguari i Allahut! Çfarë do të thotë të nxitosh?”

I Dërguari i Allahut (a.s.), u përgjigj:

“Robi thotë: «U bënë shumë herë që lutem, por Zoti nuk ma pranon lutjen.» Pra, ai mërzhitet dhe e braktis lutjen për shkak se nuk i është pranuar lutja menjëherë. (Ja, pikërisht këtu ai ka nxituar.)” (Muslim, Dhikr, 92.)

- Duaja duhet të bëhet me përgjërime dhe shpresë, shumë dhe shpesh.

Shpesh, edhe dëshirat tona të kësaj bote i përmendim vend e pavend. Prandaj, edhe nëse i përgjrohemi mijëra herë Zotit tonë, përsëri është pak. Gjuha jonë duhet të jetë përherë e lagur me dua dhe përgjërime tona duhet të jenë të shpeshta dhe të sinqerta.

Shembulli ynë më i bukur në çështjen e duarsë, është Profeti ynë (a.s.). Ne duhet t’i mësojmë përmendësh duatë që na janë transmetuar prej tij dhe t’i përsërisim shpesh ato duke menduar edhe kuptimin e tyre.

Shembuj nga duatë e Profetit tonë (a.s.):

«O Zoti im! Kërkoj mbrojtje te Ti nga humbja e mirësive të tua, nga ikja e shëndetit dhe zëvendësimi i tij sëmundje, nga dënimi yt i papritur dhe nga çdo gjë që shkakton zemërimin tënd.» (Muslim, Dhikr, 96.)

“Unë di një thënie që nëse e thotë një rob i cili është në pikëllim dhe ankth të madh, Allahu patjetër do

t’i hapë një rrugëdalje. Kjo është fjala e vëllait tim Junusit (a.s.). Kur ai mbeti në errësirë (në barkun e peshkut), tha:

لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ سُبْحَانَكَ إِنِّي كُنْتُ مِنَ الظَّالِمِينَ

“La ilahe illa ente, subhaneke inni kuntu mine’ dhalimin.” (Tirmidhi, Deauat 81; Surja Enbija, 87.)

I Dërguari i Allahut nuk e linte asnjëherë këtë dua në mëngjes dhe mbrëmje:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْعَفْوَ وَالْعَافِيَةَ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ
اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْعَفْوَ وَالْعَافِيَةَ فِي دِينِي وَدُنْيَايَ
وَأَهْلِي، وَمَالِي، اللَّهُمَّ اسْتُرْ عَوْرَاتِي، وَآمِنْ
رَوْعَاتِي، اللَّهُمَّ احْفَظْنِي مِنْ بَيْنِ يَدَيْ، وَمِنْ خَلْفِي،
وَعَنْ يَمِينِي، وَعَنْ شِمَالِي، وَمِنْ فَوْقِي، وَأَعُوذُ
بِعَظَمَتِكَ أَنْ أُغْتَالَ مِنْ تَحْتِي

“O Allah! Të kërkoj të më falësh dhe të më ruash nga çdo e keqe në këtë botë dhe në botën tjetër. O Allah! Të lutem të më falësh dhe të më ruash nga të këqijat e të metat në fenë time, në jetën time të këtushme, në familjen time dhe në pasurinë time. O Allah! M’i mbulo të metat dhe më qetëso nga gjërat frikësuese. O Allah! Më ruaj nga para dhe nga prapa, nga e djathta dhe nga e majta, si dhe nga lart. Mbrohem me madhërinë Tënde, që të mos më përpijë toka nga poshtë.” (Ibn Maxhe, Dua, 14.)

Duatë tona duhet t’i zbukurojmë me këto ajete dhe hadithe.

E përfundoj këtë shkrim me një ajet fisnik që tregon se sa e rëndësishme është duaja për ne:

قُلْ مَا يَعْجَبُ بِكُمْ رَبِّي لَوْلَا دُعَاؤُكُمْ

“Thuaj: “Zoti im nuk do t’ju përfillte, sikur të mos ishte lutja juaj...” (Furkan, 77.)



I SINQERTI DHE BESNIKU

(sal-lallahu alejhi ve sel-lem)

— Abdullah Sert —

Pa dyshim që për të mësuar sinqeritetin duhet të qëndrojmë me të sinqertët. Përderisa ky qëndrim së bashku me ta të vazhdojë me besnikëri dhe sinqeritet, njeriu gradualisht do të arrijë nderime të mirëfillta përkrah tyre dhe do të përfitojë më shumë nga morali profetik.

Zinxhiri e profetëve fillon me njeriun e parë, Hz. Ademin dhe përfundon me të Dërguarin e Allahut (a.s.), i cili ishte mëshirë për botët, Hatemu'l-Enbija (vula e profetëve) dhe hallka e fundit e pejgamberëve. Dy veçoritë që dallohen nga tiparet e përbashkëta të të gjithë pejgamberëve nga hallka e parë deri tek hallka e fundit janë SIDKU (sinqeriteti) dhe EMANET (besnikëria).

I Dërguari i Allahut (a.s.), i cili i mblodhi cilësitë e bukura e të panumërta të të gjithë profetëve të mëparshëm në personalitetin e tij shembullor, i la shembujt më të paharruar umetit dhe njerëzimit në këto dy cilësi, të cilat i admiron natyrshëm i gjithë njerëzimi.

Sinqeritet do të thotë drejtësi, ndershmëri, rrugë e drejtë, të qenët i drejtë dhe përparim brenda rrethit të fesë e logjikës. Sinqeriteti, para së gjithash shihet në botën e brendshme të njeriut, përkatësisht në qëllimet, vullnetin dhe fjalët e tij dhe më pas në të gjitha sjelljet që i pasqyrojnë në botën e jashtme.

Gjatë përcjelljes së mesazhit, i Dërguari i Allahut (a.s.), i cili kaloi 40 vjet të jetës së tij në një shoqëri të injorancës, para së gjithash, regjistroi te kurejshët se ai nuk ishte i ndotur nga të gjitha llojet e gënjeshtreve, mashtrimeve, padrejtësive, poshtërimeve dhe

sjelljeve të pahijshme të të paditurve.

Profeti, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, ishte më i sinqerti i njerëzve. Edhe në situata të ndryshme ndaj të cilave ekspozohej, jepte përgjigje në mënyrën më të përshtatshme me të cilën ishte i kënaqur Allahu (xh.xh.). Edhe armiqtë e tij më të egër që jetonin në Mekë u detyruan ta pohonin këtë gjendje të tij të mirë shpirtërore.

Sinqeriteti, besnikëria dhe në fund të jesh një njeri besnik është një sprovë shumë e rëndësishme e jetës. Para së gjitha fillon me takimin e zemrës me një besim të padyshimtë dhe më pas arrin rezultatit e vërtetë duke qenë në gjendje të kalojë në mënyrën më të mirë sprovat e pasurisë dhe jetës.

“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata që besojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe pastaj nuk dyshojnë, por luftojnë në rrugën e Allahut me pasurinë dhe jetën e tyre. Këta janë besimtarë të sinqertë.» (Huxhurat, 15)

“Birr-Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj nga lindja dhe perëndimi, por mirësia është (cilësi) e atij që beson Allahun, Ditën e Fundit, engjëjt, Librin dhe profetët; e atij që me vullnet jep nga pasuria e vet për të afërmit, jetimët, të varfrit,

udhëtarët e mbetur rrugës, lypësit dhe për lirim të të robëruarve; e atij që fal namazin dhe e jep zekatin; dhe e atyre që i plotësojnë premtimet, kur marrin përsipër diçka; e atyre që durojnë në kohë skamjeje, sëmundjeje dhe lufte. Këta janë besimtarët e vërtetë dhe këta janë ata që e kanë frikë Allahun.» (Bekare, 177)



Para së gjithash, njeriu duhet të jetë i sinqer-të dhe i ndershëm kundrejt Krijuesit të tij Suprem, sepse Ai, xhel-le she'nuhu, "e di edhe të fshehtën, edhe atë që është më e fshehtë se e fshehta". (Shik. Taha, 7.) Pastaj, duhet të jenë në gjendje të ruajë istikametin në shpirt e në vepra dhe besnikërinë si tiparet më të rëndësishme të personalitetit në jetën familjare, e cila është komuniteti më i vogël, në jetën e biznesit dhe në të gjitha marrëdhëniet me fqinjët dhe shoqërinë.

Një fjalë tjetër që përmendet së bashku me sid-kun, e cila shprehet si sinqeritet dhe ndershmëri, është «besnikëria». Karakteristika kryesore e Profetit është; «sadiikul-va'd, el-emin» që do të thotë se çdo fjalë që ai e thotë është e vërtetë dhe se ai është një njeri (pejgamber) të cilit i besohet (në çdo aspekt).

Në periudhën e injorancës, të njohurit e politeis-tëve, të cilët jetonin në të njëjtin qytet dhe bënë në të njëjtën punë, nuk mund t'i besonin njëri-tjetrit, kështu që ia linin amanetet e tyre të Dërguarit të Allahut (a.s.). Edhe pse ata nuk e pranonin profeci-në e tij, ishin të «sigurt» për «besnikërinë e tij».

Pejgamberi (a.s.), i cili është «Muhamedu'l-Emini» i zinxhirit të profetëve, e ka urdhëruar umetin e tij që ta përvetësojë gjithmonë këtë ndershmëri, besnikëri dhe istikamet dhe shpesh herë na e ka kujtuar këtë çështje duke thënë:

«Edhe nëse nuk mund të kenë sukses plotësisht, prapë se prapë përpiquini të jeni të ndershëm.» (Ibn Maxhe, Taharet) Duke u shprehur në këtë mënyrë, theksoi se është e nevojshme që vazhdimisht të përpiqemi për të qenë të drejtë.

Sufjan ibn Abdullahu, (r.a.), transmeton:

Të Dërguarit të Allahut (a.s.), i thashë:

“O i Dërguari i Allahut!.. Më shpjego Islam in në atë mënyrë që të mos kem nevojë të pyes askënd tjetër për të.” Profeti (a.s.), më tha:

«(Së pari) thuaj besoj në Allahun dhe pastaj ji i drejtë.» (Usvetun Hasene, I, 353-354)

Sinqeriteti dhe besnikëria janë një çështje shumë

e rëndësishme, veçanërisht në jetën sociale. Një nga masat e ndjeshme të Islamit dhe masë e zotërisë sonë, Hz. Omerit është dëshmia rreth nesh në veprimet tregtare.

Një ditë, përgjatë periudhës së Medinës, i Dërguari i Allahut (a.s.), shkoi te një shitës në treg. E zhyti dorën në grumbullin e grurit që kishte përpara dhe e ndjeu se ishte i lagur, andaj e pyeti shitësin:

“Çfarë është kjo?» Burri iu përgjigj:

«O i Dërguari i Allahut, e lagu shiu.» Pejgamberi, alejhi's-selam, i tha:

«A nuk munde ta lësh këtë të lagurin në krye që ta shihnin të gjithë? Ai që na mashtron, nuk është prej nesh.»

Ndershmëria dhe sinqeriteti i tregtarëve myslimanë, që janë një mesazh real, janë bërë shkak që vendi i Indonezisë të pranojë Islam in. Rrëfimet rreth ndjeshmërisë ndaj hallallit dhe ndershmërisë, që kanë mbetur trashëgimi në histori, të Ebu Hanifes, i cili është imami i medhhebit tonë hanefi dhe i cili personalisht merrej me tregti, transmetohen brez pas brezi.

Për fat të keq shihet se në ditët e sotme ka një problem serioz besimi si në marrëdhëniet më të vogla, ashtu edhe në marrëdhëniet ndërmjet shoqërive myslimane. Abuzimet që përjetohen në ushqime dhe prodhime të tjera industriale, si dhe pasiguria në marrëdhëniet njerëzore tregojnë se sa shumë kanë nevojë ithtarët e Islamit dhe mbarë njerëzimi për atmosferën shpirtërore të Muhammedu'l-Eminit, i cili është Rahmeten li'l-alemin, domethënë mëshirë për botët.

Njeriu është një qenie që ndikohet nga mjediset pozitive dhe negative. Pa dyshim, siç janë influencuese gjendjet e këqija, ashtu janë influencuese edhe gjendjet e mira. Ndërsa Kurani Fisnik na informon për përmbajtjen e besnikërisë dhe sinqeritetit, i Dërguari i Allahut (a.s.), hedh dritë mbi besimtarët me sjelljet dhe paralajmërimet e tij shembullore. Ka edhe një pikë tjetër të rëndësishme në këtë çështje, e cila është të qëndrosh bashkë me të sinqertët, sepse thuhet: “Njeriu është me atë që e do.”

Pa dyshim, është e nevojshme të qëndrojmë me të sinqertët, në mënyrë që ta mësojmë sinqeritetin. Përderisa ky qëndrim së bashku me ta të vazhdojë me besnikëri dhe sinqeritet, njeriu gradualisht do të arrijë nderime të mirëfillta përkrah tyre dhe do të përfitojë më shumë nga morali profetik.

HZ. JUSUFI عليه السلام DHE HZ. MUSA عليه السلام

(Një krahasim etno-psikologjik)

— Et'hem Xhebexhiollu —

Në këtë kontekst, duam të lexojmë dhe kuptojmë profilin e personalitetit çifut të periudhës së dy profetëve të Egjiptit, Hz. Jusufit (a.s.) dhe Hz. Musait (a.s.) dhe të shohim, ose më mirë të kuptojmë, se si dhe në çfarë mase ajo strukturë personaliteti është trashëguar sot në mënyrë epigjenetike.

Në artikullin tonë do të përqipemi të tregojmë në 43 pika me një metodë krahasuese ngjashmëritë dhe dallimet mes Profetit Jusuf (a.s.) dhe Hz. Musait (a.s.), duke u nisur nga qendra e detyrës së tyre në Egjipt. Duke e bërë këtë, do të përqipemi të kuptojmë profilet e personalitetit të këtyre dy profetëve nga pikëpamja etno-psikologjike. Para së gjithash, duhet thënë që në fillim se prejardhja familjare e dy pejgamberëve takohet te Hz. Jakubi (a.s.). Hz. Musai (a.s.), është nga fisi Levi që rrjedh nga Levi, biri i Jakubit (a.s.).

Egjipti është djepi i qytetërimeve në traditën e lashtë. Në gjuhët klasike semite, fjala “Misir-Egjipt” vjen nga fjala “Masar” që do të thotë kështjellë, mur.

Duke u bazuar në hadithin fisnik: “Besimtari është pasqyra e besimtarit.”, mendojmë se është e mundur të lexohet struktura e përgjithshme e personalitetit të shoqërisë nga e cila ai ka ardhur përmes një profeti. Ja pra, në këtë kontekst, duam të lexojmë dhe kuptojmë profilin e personalitetit çifut të periudhës së dy profetëve të Egjiptit, Hz. Jusufit (a.s.) dhe Hz. Musait (a.s.) dhe të shohim, ose më mirë të kuptojmë, se si dhe në çfarë mase ajo strukturë personaliteti është trashëguar sot në mënyrë epigjenetike.

Siç dihet, trashëgimia gjenetike kalon brez pas brezi, si materialisht ashtu edhe shpirtërisht. Edhe strukturat e kombeve si feja, besimi dhe kultura u barten brezave të ardhshëm sipas këtij ligji natyror. Kjo quhet “epigjenetikë” në psikologji. Si shembull



për këtë mund të japim djemtë e Jakubit (a.s.). Dhjetë vëllezërit që guxuan ta vrisnin Jusufin (a.s.), patën lindur para se Jakubi (a.s.), të bëhej profet, kurse Hz. Jusufi dhe Beniamini lindën pasi u bë profet. Të gjithë e dinë se profili i personalitetit midis këtyre dhjetë vëllezërve dhe dy vëllezërve është krejt i ndryshëm. Gjithashtu, nënat e të dy grupeve ishin të ndryshme.

Ndërsa po përgatisnim artikullin tonë, me një përpjekje modeste, madje pa asnjë lloj pretendimi, u përpoqëm të kuptonim se si këta dy profetë, të cilët u përpoqëm t'i krahasonim në mënyrë të pashmangshme, ndikuan në strukturën e karakterit hebre dhe koptik (egjiptian) në përgjithësi, si një trashëgimi epigjenetike. Menduam se do të ishte e mundur të shiheshin disa efekte psiko-gjenetike dhe trashëgimore që u transmetuan nga epoka në epokë, nga brezi në brez në Egjipt dhe veçanërisht te hebrenjtë. Megjithatë, në artikullin tonë, më shumë sesa kjo çështje, jemi përpjekur të bëjmë krahasime në boshtin e ngjashmërisë dhe dallimit midis dy profetëve. Tani, le t'i krahasojmë këta dy profetë në një mënyrë shumëplanëshe.

* Siç dihet, Hz. Jusufi (a.s.), ka ardhur para Hz. Musait (a.s.). Hz. Jusufi (a.s.), ka jetuar gjatë periudhës së Hyksos III në vitet 1730-1550 para erës sonë. Kurse Hz. Musai (a.s.), ka lindur rreth vitit 1250 para erës sonë. Mes tyre ka një diferencë kohore rreth dy shekuj. Në suren Gafir thuhet se një nga njerëzit e Faraonit (el-Mu'min) mori si referencë Jusufin (a.s.), në mbrojtjen ndaj Hz. Musait, siç thuhet edhe në ajet “ma ziltum fi shekkin”.

Pavarësisht rezultatit pozitiv apo negativ të mbrojtjes, në këtë fjalim, kauza e tevhidit të Profetit Musa (a.s.), mbështetet mbi Hz. Jusufin (a.s.), i cili më parë ishte profet në Egjipt. Sepse mendja dhe mençuria kopte egjiptiane në periudhën e Musait (a.s.), epigjenetikisht posedonte ndjeshmërinë e Jusufit (a.s.). Dhe i afërmi i Faraonit, Mu'min Raxhul/Besimtari burrë, e mbrojti çështjen e profecisë dhe tevhidit të Musait (a.s.), duke u bazuar në këtë ndjeshmëri. Ai u përpoq që të drejtën ta arsyetonte me të drejtën dhe Hz. Musain (a.s.), ta shpjegonte nëpërmjet Hz. Jusufit (a.s.).

* Të dy u detyruan të largohen nga atdheu sikundër dëshirës së tyre. Njëri prej tyre u kap rob dhe u detyrua të largohej nga Kenani. Domethënë nuk u largua vullnetarisht nga Kenani. Kurse tjetri u detyrua të largohej nga Egjipti si i arratisur. Psikologjia e robërisë dhe e braktisjes ishte padyshim kaderi psiko-historik i të dy profetëve.

* Jusufi (a.s.), u la në një pus me ujë. Jeta e tij ndryshoi kur e nxorën nga uji/pusi. Kurse Musait (a.s.), i ndryshoi jeta kur nxori ujë nga pusi për t'ua dhënë deleve në Medjen. Ai u vendos në Medjen si shërbëtor i Shuajbit (a.s.). Me fjalë të tjera, jeta e të dyve mori një formë të re përmes pusit të ujit.

* Jeta e Jusufit (a.s.), fitoi një kuptim tjetër me Jakubin (a.s.). Edhe Hz. Musai (a.s.), fitoi një kuptim tjetër me Hz. Harunin (a.s.). Kështu, ndërsa të dy ishin profetë të vetëm subjektivisht, historitë e tyre gjetën famë si profetë me fat të dyfishtë. Hz. Jusufi (a.s.), nuk mund të shpjegohet pa Hz. Jakubin (a.s.). Po kështu, edhe Hz. Musai (a.s.), nuk mund të shpjegohet pa Hz. Harunin (a.s.). Me pak fjalë, të dy ishin “yje të dyfishtë”...

* Të dy profetët kanë një menaxhim të avancuar shtetëror, administrativ dhe burokratik në nivel elitar. Nëse është e nevojshme për ta shprehur me gjuhën e sotme, të dy profetët ishin udhëheqës elitare. Nisur nga ky këndvështrim, mund të themi se të dy kishin një mendje të evoluar për shtetin dhe shoqërinë. Ata patën marrë trajnime për udhëheqje dhe me këto trajnime kryen misionin e tyre profetik.

Faktikisht, jo vetëm Hz. Jusufi (a.s.) dhe Hz. Musai (a.s.), por pothuajse çdo profet erdhi në një shoqëri i pajisur me aftësinë për të menaxhuar shoqërinë, domethënë për të udhëhequr, në përputhje me këtë iniciativë.

* Jusufi (a.s.), u ekspozua ndaj armiqësisë së vëllezërve të tij dhe u hodh në pus. Më pas u çua rob në Egjipt dhe u shit si skllav. Më pas, duke u përballur me mobingun “heyte lek” të Zulejhasë, u fut padrejtësisht në burg dhe qëndroi aty për 12 vjet, duke jetuar në internim për shumë vite i ndarë nga i ati. Shkurtimisht, nuk kishte vuajtje që nuk hoqi.

Edhe Musai (a.s.), u rrit në oborr me vëllazërinë e armikut të tij. Sapo lindi Musai (a.s.), u përball me incidentin “ata po vrasin djemtë e hebrenjve”, vrau koptiun pa dashje, u arratis në Medjen, qëndroi atje rreth 10 vjet, u kthye në Egjipt, nxori çifutët që andej dhe brodhi nëpër shkretëtirë për 40 vjet me njerëzit e tij, populli i tij dhe viçi, guetia e peshkut, ngritja e malit, kërkesa e tij për të parë Allahun (xh.xh.), torturimet që përjetoi, shumë vështirësi që kaloi... Pra, ishte një pejgamber që vuajti pa masë. Si përmbledhje, të dy profetëve nuk mbeti gjë pa u ndodhur. Si nga aspekti fizik ashtu edhe nga aspekti metafizik u përballën me shumë vështirësi. Siç thuhet në hadithin fisnik: “Esheddu'n-nasi belaaen el-enbijau”, ata të dy kishin një emërues të përbashkët: vuajtje/telashe.

Tregtari Besnik

Sevapi dhe shpërblimi i një njeriu që është i besueshëm, që i sheh interesat e tjetrit si të tijat dhe që thelbi i të cilit është i njëjtë me fjalët, është i njëjtë me shpërblimin që u jepet profetëve, njerëzve të sinqertë dhe dëshmorëve. Njerëzit që bëjnë të njëjtën punë dëshirojnë të marrin shpërblim të barabartë. Ata që fitojnë të njëjtin shpërblim duhet të kenë punë të barabarta. Prandaj, puna e një tregtari besnik duhet të lidhet edhe me predikimin e fesë, që është detyrë e profetëve. Për këtë arsye, tregtia nuk është arti për të fituar para, por është misioni (arti) për të fituar zemra.



— Dr. Ahmet H. Jëlldërëm —

Fjala sadaka (lëmshë) rrjedh nga rrënja sidk, që do të thotë ndershmëri dhe sinqeritet dhe tregon se njeriu ka besim të plotë në botën e përtejme. Në fakt, në një hadith fisnik, Hz. Pejgamberi ka thënë: «*Sadakaja është argument.*» (Muslim, Taharet 1; Tirmidhi, Daavat 86.) Sepse lëmshja është investim për botën e përtejme dhe ai që do të investojë për botën e përtejme duhet të ketë besim të plotë në ahiret (botën e përtejme). Ja pra, sadakaja është një dëshmi se besimi i njeriut në botën tjetër është i plotë.

Tregtari besnik gjithashtu është ai person që me tregtinë e tij përpiket të fitojë botën tjetër. Faktikisht, njeriu besimtar përpiket të fitojë botën e përtejme në çdo gjë që i ka dhënë Allahu (xh.xh.). Ajeti fisnik e urdhëron qartë këtë çështje: **“Përpiqu të fitosh**

botën tjetër me ato që të ka dhënë Allahu. Mos e harro edhe pjesën tënde nga kjo botë...” (Kasas, 77) Për besimtarin tregtia është investim në botën e përtejme. Po ka edhe një të vërtetë se, për sa i përket vazhdimësisë së investimit, mund të merret diçka e vogël e kësaj bote prej tij.

Koncepti i quajtur “fair trade”, i cili kohët e fundit është përhapur gjerësisht në botë dhe i përkthyer në gjuhën tonë si “tregti e drejtë”, po përhapet si një vlerë e re etike. Ky koncept parashikon një tregti të bazuar në parimin që të gjithë punonjësit në zinxhir, nga prodhuesi deri te përdoruesi përfundimtar, të marrin një shpërblim për përpjekjet e tyre. Kështu, njerëzit mund t’i përdorin gjërat që blejnë me lehtësi, duke menduar se konsumi i tyre nuk përfshin shfrytëzim. Edhe pse kjo duket të jetë një lëvizje



universale e ndërjegjes, ajo ka ende një fushë shumë të re dhe të kufizuar aplikimi.

Gjëja kryesore është që njerëzit ta shohin atë që posedojnë si një amanet dhe të bëjnë atë që është e nevojshme. Çështja e dytë themelore është mbrojtja e interesave të njerëzve me të cilët bën biznes duke i menduar ata si veten. Në fakt, Profeti (a.s.), vendos një masë të qartë për këtë çështje dhe e sheh mbrojtjen e interesave të vëllait si një shenjë besimi:

“Askush prej jush nuk do të jetë besimtar derisa të dojë për vëllain e tij atë që do për veten e tij.” (Buhari, Iman, 6; Muslim, Iman, 71.) Rregulli më themelor në marrëdhëniet njerëzore është ta shohësh tjetrin si veten. Kështu, i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, e ka shprehur këtë shumë qartë në hadithin e mësipërm.

Myslimani është i detyruar t'i përmbushë kërkesat e besimit të tij në çdo fushë. Ai duhet të jetë besimtar në biznesin dhe në punën e tij, ashtu siç është besimtar në xhami dhe në shtëpi. Ndërsa falet siç e kërkon besimi i tij, është i detyruar të bëjë tregti besnike/të ndershme siç e kërkon besimi i tij. Në fakt, historia e mëposhtme tregohet nga Imam Azami (Ebu Hanife), i cili ishte i vetëdijshëm për këtë marrëdhënie të ngushtë midis besimit dhe besnikërisë: Imami preokupohej me tregtinë që i kishte mbetur trashëgimi nga babai i tij. Pra, preokupohej me tregtinë e pëlhurave si i ati. Në atë kohë, prodhimi i pëlhurave bëhej me dorë në shtëpi. Një zonjë i sjell një pëlhurë Imam Ebu Hanifes për ta shitur. Kur Imami e pyeti për çmimin, ajo i tha që t'i jepte 100 dërhëmë. Imami i tha se vlera e pëlhurës është më e lartë. Pazari mes tyre shkoi kështu:

- Atëherë më jepni dyqind dërhëmë. Imami:
- Kushton më shumë se dyqind dërhëmë. Gruaja:
- Atëherë më jepni treqind dërhëmë. Imami:
- Kushton më shumë se treqind dërhëmë. Gruaja:
- Atëherë më jepni katërqind dërhëmë. Imami:
- Kushton më shumë se katërqind dërhëmë. Atëherë gruaja i tha:
- A po talleni me mua? Imami i tha: Aspak! Nëse dëshironi, mund të thërrasim një ekspert. Atëherë, në ato ditë, në pazare ishte një institucion ekspertësh që i zgjidhte problemet menjëherë. Ata u konsultuan dhe eksperti e vlerësoi pëlhurën për 500 dërhëmë. Imami e mori pëlhurën duke i dhënë pesëqind dërhëmë.

Ai që fshihet pas këtij qëndrimi të imamit ndaj klientes është besimi i tij, i cili zbulon aftësinë e tij të madhe për t'u thelluar në jurisprudencën islame:

“Tregtar besnik është me profetët, të sinqertët dhe

dëshmorët.” (Tirmidhiu, Buju, 4.) Me fjalë të tjera, shpërblimi i një njeriu që është i besueshëm, i cili i sheh interesat e tjetrit si të tijat, bota e brendshme e të cilit është e njëjtë me atë të jashtmen, është e njëjtë me shpërblimin që u jepet profetëve, njerëzve të sinqertë dhe dëshmorëve.

Njerëzit që bëjnë të njëjtën punë duan shpërblim të barabartë. Ata që marrin të njëjtin shpërblim duhet të kenë punë të barabarta. Prandaj, puna e një tregtari besnik duhet të lidhet edhe me predikimin e fesë, që është detyrë e profetëve. Për këtë arsye, tregtia nuk është arti për të fituar para, por është përpjekje për të fituar zemra.

Një njeri që nuk mund ta kthejë tregtinë e tij në një investim për botën tjetër është si një bagëti, e cila konsiderohet se ka mbledhur kashtën që nuk mund ta konsumojë përgjatë gjithë jetës. Edhe pse ai nuk do të jetë në gjendje të marrë përfitimin e kursimeve të tij, atij do t'i kërkohet llogaria deri në detajet më të vogla për të.

Tregtia është çështje mëshirë. Është një mundësi për të arritur mëshirën. Në fakt, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Allahu e mëshiroftë njeriun që është tolerant kur shet, kur blen dhe kur kërkon borxhin.” (Buhari, Buju, 16.)

Tregtarët duhet ta shohin çdo klient që vjen në derën e tyre si mundësi mëshire. Çdo mysli man duhet ta përvetësojë këtë parim në marrëdhëniet e tij njerëzore. Ne nuk duhet t'i perceptojmë fitimet si një rritje numerike, por si fitim i një konsistence humane. Prandaj, një blerje dhe një kontratë me të cilën të dyja palët janë të kënaqura përfaqësojnë një vlerë reale. Përndryshe, është e qartë se pasuria e atij që qan nuk i bën dobi atij që qesh.

Mëshira, e cila është fitimi më i madh, është fitimi i atyre që tregojnë mirësi me njëri-tjetrin, përpiqen të mos shqetësojnë palën tjetër dhe tregojnë mirëkuptim gjatë blerjes, shitjes, shlyerjes së një borxhi ose kërkimit të tij. Mëshira është falja e Allahut, falja dhe pranimi i robit të Tij si rob i afërt.

Nuk duhet harruar se sa më i lartë të jetë fitimi në një punë, aq më i madh është rreziku. Nisur nga ky aspekt, Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve selem, i ka paralajmëruar tregtarët si më poshtë:

“O bashkësi e tregtarëve! Me siguri, tregtarët do të ringjallen në Ditën e Gjykimit si mëkatarë. Me përjashtim të atyre që i frikësohen Allahut, e mbajnë fjalën dhe flasin të vërtetën.” (Tirmidhi, Buju, 4.)

Tregtia është një përpjekje që të bën të fitosh xhenetin ose xhehenemin. Lum për ata që mund të hyjnë në xhenet nga porta e tregtisë dhe të jenë bashkë me profetët, të sinqertët dhe dëshmorët!

TË MARRËSH NË LLOGARI

— M. Sami Ramazanollu —

Aishja, (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Kushdo që të merret në llogari, do të ndëshkohet.”

I thashë:

“A nuk thotë Allahu Teala: **“Ai do të llogaritet me një llogari të lehtë?..”** (Inshikak, 8) I Dërguari i Allahut (a.s.), më tha:

“Kjo që thua ti është arz, përndryshe, kushdo që do të merret në llogari deri në detaje, do të shkatërrohet.”

Në ajetin fisnik thuhet: **“... Ja, ai do të merret në një llogari të lehtë.”** Vallahu e’alem.

Me fjalën arz synohet vendosja e veprave në peshore, ose shfaqja e tyre ndaj të zotëve që i kanë bërë. Llogaritja në ditën e shfaqjes së veprave, do të kalojë shumë lehtë për as’habu’l-jemin, domethënë, për fatlumët. Kjo është e vërtetuar me Kuran dhe Sunet. Kur as’habu’l-jemin do të merren në llogari, do të falen dhe do të arrijnë mirësi të mëdha. Ndërsa llogaria për të cilën nuk do të ketë falje, do të

jetë shumë e rëndë. (Përkthimi i Tedrixhu’s-Sahih 1/84.)

Ebu Hurejra, radijallahu anh, transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut, (a.s.), duke thënë:

“Këta janë njerëzit që fillimisht do të gjykohet kundër tyre Ditën e Kiametit:

1. Ai që ka rënë dëshmor. Ai do të sillet në audiencën e Allahut. Allahu do t’i tregojë për mirësitë që i pati dhënë. Edhe ai do t’i pohojë ato. Allahu i Lartësuar do t’i thotë: “Atëherë, çfarë ke bërë në shkëmbim të këtyre?” Ai do të përgjigjet: “Kam rënë dëshmor në rrugën Tënde.” Allahu do t’i thotë: “Gënjeve. Ti ke luftuar që të thuhet se je “trim dhe hero”. Me të vërtetë, u tha edhe ashtu. Pastaj jepet urdhri për atë njeri dhe tërhiqet zvarrë me fytyrë për tokë derisa të hidhet në zjarr.

2. Ai që mëson dije, që ua mëson edhe të tjerëve dhe që lexon Kuran. Ai do të sillet në audiencën e Allahut Teala. Allahu do t’i tregojë për mirësitë që i pati dhënë. Edhe ai do t’i pohojë ato. Allahu i Lartësuar do t’i thotë: “Atëherë, çfarë ke bërë në shkëmbim të këtyre?” Ai do të përgjigjet: “Kam mësuar dije. Atë ua kam mësuar edhe të tjerëve. Kam lexuar edhe Kuran për Ty. Allahu do t’i thotë: “Gënjeve. Ti mësove dije që të thuhej se je “dijetar”. Lexove Kuran, në mënyrë që të thonë se je “lexues”. Me të vërtetë, u tha edhe ashtu. Pastaj jepet urdhri për atë njeri dhe tërhiqet zvarrë me fytyrë për tokë derisa të hidhet në zjarr.

3. Ai që Allahu i Lartësuar i ka dhënë shumë pasuri. Ai do të sillet në audiencën e Allahut Teala. Allahu do t’i tregojë për mirësitë që i pati dhënë. Edhe ai do t’i pohojë ato. Allahu i Lartësuar do t’i thotë: “Atëherë, çfarë ke bërë në shkëmbim të këtyre?” Ai do të përgjigjet: “Kam dhënë prej pasurisë sime në çdo rrugë për të cilën na ke urdhëruar. Pasurinë time e kam harxhuar vetëm në rrugën Tënde. Allahu Teala do t’i thotë: “Gënjeve. Ti e ke bërë këtë që të thonë se je “bujar”. Me të vërtetë, u tha edhe ashtu. Pastaj jepet urdhri për atë njeri dhe tërhiqet zvarrë me fytyrë për tokë derisa të hidhet në zjarr.



ZILIQARI ËSHTEË ARMIK NDAJ MIRËSISË SË ALLAHUT



— Sadik Dana —

Sipas transmetimit të Ubej ibn Ka'bit, (r.a.), i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: «*Mësojuani robërve tuaj suren Jusuf, sepse, nëse një mysliman e shkruan atë dhe ia mëson familjes së tij dhe robit të tij, Allahu do t'ia lehtësojë vdekjen. Gjithashtu u jep forcë për të mos pasur zili asnjë mysliman.*»

Në një hadith tjetër fisnik thotë: «*Shmanguni zilisë. Siç zjarri i djeg dhe i shkatërron drutë, edhe zilia bëhet shkak për shkatërrimin e mirësive.*» (Xhamiu's-Sagir)

Nga Ebu Hurejra, (r.a.), transmetohet se Hz. Pejgamberi ka thënë: «*Mos e urreni njëri-tjetrin, mos e kini zili, mos e xhelozoni, mos i ndërhyjni në allshverish dhe bëhuni robër të Allahut, vëllezër.*»

Ibn Vefa (k.s.), thotë: «*Mos ki zili ndaj një njeriu që ka arritur mirësinë e Allahut (xh.xh.) dhe është më i lartë se ti. Për shkak të zilisë, mund të marrësh zemërimin e Allahut. Mund të të ndryshojë fytyra dhe të kesh një përfundim të keq. Kështu, edhe Ib-lisi, i cili e kishte zili Ademin dhe nuk i bëri sexhde nga mendjemadhësia, u mallkua.*»

O biri i Ademit! Përderisa të posedosh attribute të mira, nuk do të ndahesh nga origjina. Nëse ia le vendin e attributeve të mira attributeve të këqija, cilësitë e tua njerëzore do të shndërrohen në demonike.

Një njeri i urtë thotë: «*Njeriu ziliqar është në konflikt me Zotin e tij në këto pesë aspekte:*

1. Zemërohet për shkak të mirësisë që sheh te të tjerët.

2. Zemërohet me shpërndarjen e furnizimit nga Allahu. Ai që bëhet xheloz për të mirat që Allahu u ka dhënë të tjerëve, sikur i thotë Zotit: Pse i shpërndave këto mirësi në këtë mënyrë?

3. Edhe pse Allahu ia dhuron mirësinë e Tij kujt të dëshirojë, ai dëshiron të jetë dorështrënguar me mirësitë e Allahut.

4. Ai dëshiron t'i poshtërojë robërit e dashur të Allahut Teala, të cilëve Ai u ka dhënë begati.

5. Me zilinë ai ndihmon shejtanin, i cili është armik edhe i Allahut Teala, edhe i tij. I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, ka thënë:

«*Edhe mirësitë e Allahut kanë një armik. Këta janë ata që i kanë zili ata që Allahu u ka dhënë nga dhuntitë e Tij dhe nuk mund t'i durojnë dot.*» (Taberani, nga Ibn Abbasi)

Sipas transmetimeve, Musai (a.s.), pa një burrë të ulur nën hijen e Arshit. Ai u magjeps nga burri dhe tha: «*Ky burrë është një njeri i mirë te Allahu.*» Dhe pastaj pyeti: «*O Zot! Kush është ky njeri? Si e ka emrin?*» Allahu i Madhëruar nuk ia dha emrin, por i tha: «*Po të informoj se këtë gradë e ka arritur me tri vepra.*» Kështu i tregoi për këto tri vepra si më poshtë.

* Nuk e kishte zili askënd.

* Nuk u rebelua kundër babait dhe nënës së tij.

* Gjithashtu nuk mbarti fjalë.

Shibli (k.s.), gjithmonë lutej:

«*O Zot, mos bëj prej ziliqarëve, por prej atyre që kihen zili.*» Sepse ziliqari sheh tek ai që e ka zili një përsosmëri që nuk e sheh te vetja. Dhe kështu e ka zili atë. Ji i durueshëm kundrejt zilisë së ziliqarëve. Durimi yt do t'i vrasë ata.

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

«*Ka tri gjëra që janë burimi i të gjitha mëkateve. Patjetër t'i shmangni këto:*

E para: Mendjemadhësia. Mendjemadhësia është ajo që e shtyu Iblisin të mos i bënte sexhde Ademit. E dyta: Lakmia. Lakmia është ajo që e shtyu Ademin të hante nga pema e ndaluar. E treta: Zilia. Zilia është ajo e cila bëri që dy djemtë e Ademit të grindeshin me njëri-tjetrin dhe të vrisnin vëllai vëllain.»

BINDJA NDAJ PROFETIT (A.S.) NËN DRITËN E AJETEVE TË KURANIT

— Doç. dr. Kerim Bulladë —

Bindja ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.), është farz / obligim për të gjithë besimtarët. Në Kuranin Fisnik theksohet qartazi se bindja ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.), është e domosdoshme.¹ Në shumë ajete, pasi Allahu Teala urdhëron bindjen ndaj Tij, kërkon që besimtarët t'i binden edhe të Dërguarit të Allahut (a.s.).² Kurani nuk e ka ndarë bindjen ndaj Allahut me bindjen ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.). Ai e ka pranuar bindjen ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.), si bindje ndaj Allahut të Lartësuar. Përveç të tjerash, kundërshtimin që mund të bëhet ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.), e ka pranuar si kundërshtim ndaj Allahut (xh.sh.). Në lidhje me këtë çështje, në Kuranin Fisnik thuhet: **“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut. Sa për ata që kthejnë kokën mënjanë, Ne nuk të kemi dërguar që të jesh rojtar i tyre.”**³

Allahu Teala ka urdhëruar bindjen ndaj të Dërguarit të Tij (a.s.). Nëse dikush i bindet të Dërguarit të Allahut (a.s.), i është bindur Allahut Teala, sepse ai që i bindet të Dërguarit të Allahut (a.s.), ka zbatuar

urdhrin e Allahut të Madhëruar. Në një ajet thuhet: **“O besimtarë! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja. Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Kiametit. Kjo për ju është më e mira dhe shpjegimi më i bukur.”**⁴ Siç shikohet, Allahu Teala e ka bërë prej kushteve të besimit bindjen ndaj Pejgamberit (a.s.). I Dërguari i Allahut (a.s.), urdhëron bindje vetëm ndaj Allahut Teala. Për këtë arsye, nëse dikush i bindet të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe e zbaton urdhrin e tij, i është bindur Allahut, azze ve xhelle. Sipas disa transmetimeve, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë kur ka qenë në Medinë: **“Kush me do mua, do Allahun. Kush më bindet mua, i bindet Allahut.”**⁵ Kur politeistët e akuzuan të Dërguarin e Allahut (a.s.), në lidhje me këtë çështje, Allahu Teala zbriti këtë ajet me synimin për ta vërtetuar fjalën e Hz. Pejgamberit: **“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut. Sa për ata që kthejnë kokën mënjanë, Ne nuk të kemi dërguar që të jesh rojtar i tyre.”**⁶⁷

1. Al Imran, 3/33; Nisa, 4/59; 59, Maide, 5/92; Enfal, 8/1.

2. Al Imran, 3/ 33, 132; Nisa, 4/69, 59; Tevbe, 9/71; Ahzab, 33/71 etj.

3. Nisa, 4/80.

4. Nisa, 4/59.

5. Buhari, *Ahkam*, 1; Muslim, Imaret, 32-33.

6. Nisa, 4/80.

7. Ebu Mansur Muhammed b. Muhammed el-Maturidi es-Semerkandi,



Në lidhje me çështjen e bindjes për të cilën bëhet fjalë në ajet me shprehjen: “Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij!..”, është bërë një shpjegim i tillë: “Bindjuni Allahut në gjërat që janë farz dhe bindjuni të Dërguarit të Allahut (a.s.), në çështjet që janë sunet.” Ndërsa edhe një shpjegim tjetër është kështu: “Bindjuni Allahut për gjërat që ka urdhëruar dhe ndaluar në Librin e Tij. Bindjuni të Dërguarit të Allahut (a.s.), në çështjet që ka urdhëruar dhe ndaluar në sunetin e tij. Bindjuni Allahut në çështjet që ka urdhëruar dhe bindjuni të Dërguarit të Allahut (a.s.), në çështjet që ka predikuar.”⁸

Besimtarët e kanë obligim t’i binden të Dërguarit të Allahut (a.s.), në çështjet që ka shpjeguar, predikuar, urdhëruar, zbatuar dhe aprovuar, sepse çdo gjë që ai ka thënë apo çdo gjë që ka bërë në lidhje me fenë, është thënë dhe është bërë nën mbikëqyrjen e revelatës hyjnore. Specifika më e rëndësishme që Kurani e kërkon nga ata që i besojnë Allahut dhe ahiretit është që ta marrin për shembull Hz. Pejgamberin. **“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.”**⁹ Nëse besimtarët nuk i binden të Dërguarit të Allahut (a.s.), e kanë të pamundur ta marrin për shembull dhe ta pranojnë si të tillë atë. Ai që e do atë, i bindet, i jep besën dhe ecën në rrugën e

tij. Pa iu bindur atij dhe pa e zbatuar sunetin e tij, nuk mund të arrihet dashuria ndaj tij.

Në ajete të ndryshme Allahu i Lartësuar shprehet se ata që i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij do të korrin një sukses të madh, do të shpëtojnë dhe do të fitojnë xhenetin:

“Ata që i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij, që kanë frikë nga Allahu e i përkushtohen Atij, do të jenë të fituarit e vërtetë.”¹⁰ **“O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe thoni vetëm të vërtetën. Ai do t’jua bekojë veprat tuaja dhe do t’jua falë gjynahet. Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, do të arrijë një fitore madhështore.”**¹¹ **“Nuk është gjynah për të verbrin, as për të çalin, as të sëmurin (që të mos marrin pjesë në luftë). Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, do të shkojë në Xhenete, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, kurse ai që shmanget, do të ndëshkohet me dënim të dhembshëm.”**¹²

Siç kuptohet plotësisht qartë nga ajetet e mësipërme, besimtari mund të korrë sukses në këtë botë provizore dhe mund të fitojë lumturinë e përhershme në ahiret vetëm duke iu bindur Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Jeta islame nuk mund të imagjinohet pa bindjen ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.), domethënë, duke e përjashtuar Sunetin e Hz. Pejgamberit. Kurani Fisnik kuptohet dhe shndërron në një libër jetësor në sajë të sunetit të të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Te’vilatu’l-Kur’an, Kontrollloi, Bekir Topalogllu-Muhammed Bojnukallën, Stamboll, 2005, III, 244.

8. Ebû Mansûr Muhammed b. Muhammed el-Mâtûrîdî es-Semerkandî, Te’vilatu’l-Kur’an, III, 292.

9. Ahzab, 33/21.

10. Nur, 24/52.

11. Ahzab, 33/70-71.

12. Fet’h, 48/17.



Personaliteti i lartë në dije, ibadet dhe singeritet:

IMAM SHAFIU (R.A.)

Imam Shafiu (r.a.), u trondit kur u pyet nëse kish-te punuar apo jo me hadithet që kishte transmetuar dhe tha:

“More njeri! A më mban toka dhe a mund të qëndroj nën këtë qiell nëse transmetoj hadith nga Resulullahu dhe nuk gjykoj me të siç duhet? Sigurisht që punoj me to! Çdo sunet i tij për mua është një kënaqësi e papërshkrueshme dhe është shumë i shtrenjtë!” (Bejhaki, Menakibu’sh-Shafii, I, 475.)

URTËSIA E NGJALL ZEMRËN

Imam Shafiu (r.a.), krahas veprave shkencore ka shkruar edhe poezi të cilat janë të thella në meditim dhe ndjenja. Ai e shprehte si më poshtë nevojën që kemi për fjalët e urta:


“Gjallëria e tokës është e mundur me shirat e begatë që bien me qetësi. Ndërsa gjallëria e vetes është e mundur me dëshirat dhe mallëngjimet. Kurse gjallëria e frymëzimit dhe përsipirtshmërisë së zemrave është e mundur me fjalët e urta.”

Nisur nga ky këndvështrim Shafiu ka një akumulim të pasur shpirtëror në luginën e fjalëve të urta, sepse fjalët e urta janë mundësia e vetme me të cilat ai shprehte të vërtetat e pavdekshme. Ja një pjesë prej tyre:

“Robërit e mençur të Allahut janë ata që nuk mashtrohen nga dëshirat dhe pasionet e pavlera të kësaj bote. Nga ana tjetër ata kanë frikë prej fatkeqësive dhe sprovave të kësaj bote dhe të botës tjetër. Këtë botë e shohin duke marrë mësim prej saj dhe e dinë se ajo kurrë nuk mund të jetë e përhershme për një të përkohshëm! Miqtë e Zotit e konsideronin këtë botë si një det. Ndërsa veprat e mira i konsideronin si anije mbi të, me të cilën (do të kalonin në botën tjetër).”

“Siç i tradhton mirazhi shikuesit dhe ua çon dëm shpresën atyre që shpresojnë te ajo, edhe shpresat, dëshirat dhe pasionet vetjake ndaj kësaj bote i kanë shkatërruar shumë njerëz.”

“Nëse frikësohesh në mos e pëlqen veten dhe kap-





lohesh nga mburrja në lidhje me çështjen e veprave të tua, atëherë mendo kënaqësinë e Zotit të cilin përpiqesh ta bësh mik, në mënyrë që t'ia dalësh mbanë. Mendohu mirë se çfarë mirësish dëshiron, se prej cilit ndëshkim ke frikë, se për cilat mirësi falënderon dhe se prej cilave fatkeqësive ke marrë mësim me veprat e tua. Nëse mendon siç duhet qoftë edhe për njërën prej këtyre, vepra jote do të të duket e pakët.”

“Njerëzit me vlerën më të lartë janë ata që nuk shohin ndonjë vlerë te vetja e tyre.”

“Imam Shafiu (r.a.), ka thënë: “Njerëzit më të virtytshëm janë ata që jetojnë me modesti. Cilësia më dalluese e njeriut të përsosur është perceptimi i dobësisë së vet.”

Domethënë ata që kanë arritur pa kapital në këtë botë dhe jetojnë me modesti, sepse çdo gjë fillon pasi të arrijë te modestia. Nisur nga këto që thamë më lart:

“Njerëzit më të virtytshëm janë ata që jetojnë me modesti.”

“Modestia është prej moralit të njerëzve bujarë dhe fisnikë. Ndërsa mendjemadhësia është natyrë e njerëzve të mjerë.”

“Modestia lind dashurinë, ndërsa të mjaftuarit me atë që ka dhënë Zoti lind rehatinë dhe prehjen shpirtërore...”

“Nderi dhe dinjiteti i njeriut gjenden te devotshmëria. Ai që nuk e arrin devotshmërinë nuk ka asnjë lloj dinjiteti.”

“Imam Shafiu (r.a.), ka thënë: “Modestia është prej moralit të njerëzve bujarë dhe fisnikë. Ndërsa mendjemadhësia është natyrë e njerëzve të mjerë.”

Te njerëzit që pandehin se kanë dinjitet pa pasur devotshmëri nuk gjendet as mirësjellje, as hijeshi, as ndjenja.

Çdo gjë që të largon nga Allahu quhet FUXHUR (mekat). Ndërsa cilësia dalluese e fuxhurit është egoizmi. Egoizmi është cilësia dalluese e Iblisit.

Ndërsa cilësia dalluese e devotshmërisë është të genët asgjë.

“Ata që kanë dëshira të forta vetjake, le ta eliminojnë mekatin duke ia përkushtuar veten ibadetit.”

Ndërsa përkushtimi ndaj ibadetit kërkon një sinqeritet të plotë. Pra, kërkon një vetëdije me të cilën kuptojmë se gjendemi nën vëzhgimin e kamerave hyjnore. Vetëm ata që e arrijnë këtë sinqeritet dhe vetëdije mund t'i eliminojnë dëshirat vetjake, dashurinë ndaj gjërave të përkohshme dhe ecjen nëpër

qorrsokakët e jetës. Kështu ata bëjnë një jetë të pastër sipas moralit Islam duke qenë monumente nderi dhe turpi. Ata e dinë se;

“Një njeri që nuk është i ndershëm, e ka dobësuar dinjitetin njerëzor.”

“Cilësia më dalluese e njeriut të përsosur është perceptimi i dobësisë së vet.”

Sepse;

Ai që e percepton dobësinë e tij, e njeh Allahun Teala. Siç janë shprehur të mëdhenjtë e Islamit:

“Ai që e njeh veten, e njeh

edhe Zotin...”

Kjo është e gjithë vlera e njeriut. Por ndërkohë që e vërteta është kjo;


“Kushdo që ka si dëshirë të vetme gjërat që hyjnë në stomak, edhe vlera e tij është sa gjërat që dalin prej stomakut të tij!”

PESË CILËSI TË MIRA

“Mirësia e kësaj bote dhe e botës së përtejme gjendet në pesë cilësi:

1. Zemra e pasur.
2. Të mos lëndosh asnjë.
3. Fitimi hallall.
4. Të veshësh petkun e devotshmërisë.
5. T'i besosh Allahut në çdo lloj situatë.”

“Zbukurimi i dijetarëve është devotshmëria. Stolia



“SIÇ I TRADHTON
MIRAZHI SHIKUESIT DHE UA
ÇON DËM SHPRESËN ATYRE
QË SHPRESOJNË TE AJO, EDHE
SHPRESAT, DËSHIRAT DHE
PASIONET VETJAKE NDAJ KËSAJ
BOTE I KANË SHKATËRRUAR
SHUMË NJERËZ.”



“MË I KEQI PREJ ATYRE QË I BËJNË ZULLUM VETES ËSHTË AI QË KUR LARTËSOHET (ARRIN NJË POZITË TË LARTË), U BËN KEQ TË AFËRMVE, BËN SIKUR NUK I NJEH MIQTË, I NËNVLERËSON NJERËZIT E NDERSHËM DHE MBAHET MENDJEMADH NDAJ NJERËZVE TË VIRTYTSHËM.”

e tyre është morali. Bukuria e tyre është bujaria me gjithë shpirt.”

“Njeriu në këtë botë e arrin përsosmërinë vetëm me katër gjëra:

1. Dijanet / Feja.
2. Emanet / Të jesh besnik dhe i besueshëm.
3. Sijanet / Të mbrosh çdo gjë që duhet mbrojtur.
4. Rezanet / Dinjiteti.

“Imam Shafiu (r.a.), ka thënë: “Nderi dhe dinjiteti i njeriut gjenden te devotshmëria. Ai që nuk e arrin devotshmërinë nuk ka asnjë lloj dinjiteti.”

“Ai që thotë se i kam mbledhur bashkë dashurinë ndaj kësaj bote dhe dashurinë ndaj Allahut, gënjen.”

“Njeriu më i shqetësuar në këtë botë është ai që mban në zemër smirë dhe urrejtje.”

“Janë katër gjëra që edhe pakica e tyre është shumë:

1. Sëmundja.
2. Varfëria.
3. Armiqësia.
4. Zjarri.

“Imam Shafiu (r.a.), ka thënë: “Ata që kanë dëshira të forta vetjake, le t'i eliminojnë mëkatet duke ia përkushtuar veten ibadetit.”

“Sa ushqim i keq është për ahiretin armiqësia ndaj njerëzve!”

“Afrimiteti me njerëzit që e duan këtë botë, e sëmuri njeriun e shëndoshë.”

“Qëndrimi bashkë me njerëzit e mjerë që nuk kanë frikë prej Allahut, është turp.”

“Atë që mendja e ndalon nga çdo lloj gjëje të keqe, të shëmtuar dhe të turpshme, në të vërtetë ai është njeri i mençur.”

Nga ana tjetër;

“Nëse një njeri bën miq me vetëdije njerëz të pandërgjegjshëm dhe të paskrupullt, konsiderohet ortak me ata në çdo sjellje të keqe sado që në pamje duket sikur ka moral të lartë.”

Sepse në kuptimin e vërtetë të fjalës;

“Njerëzit e ndërgjegjshëm dhe me moral të lartë nuk mund të qëndrojnë me njerëz që kanë moral të ulët.”

“Nëse e këshillon vëllain në fshehtësi dhe me një gjuhë të sinqertë e të ëmbël, me të vërtetë që e ke këshilluar. Nëse flet pa kujdes në prani të të gjithëve, e shkatërron atë ose e bën të paturpshëm.”

“Nuk ka gëzim më të madh se biseda me vëllezërit dhe fatkeqësi më të madhe se ndarja prej tyre.”

“Mik i sinqertë është ai që e ndan pikëllimin dhe gëzimin me shokun e vet.”

“Të mos kesh dyshim se ai që të lavdëron me një të mirë që nuk e ke, kur të nxehet me ty do të të akuzojë me një të keqe që nuk e ke!”

“Personi ndaj të cilit ndjehesh i detyruar të sillesh mirë për të mos i prishur marrëdhëniet, nuk është mik me ty.”

“T'i kënaqësh të gjithë njerëzit është e pamundur. Andaj përpigu për të rregulluar lidhjen tënde me Allahun. Pasi ta realizosh këtë, mos u jep shumë rëndësi njerëzve!”

“Më i keqi prej atyre që i bëjnë zullum vetes është ai që kur lartësohet (arrin një pozitë të lartë), u bën keq të afërmve, bën sikur nuk i njeh miqtë, i nënvlerëson njerëzit e ndershëm dhe mbahet mendjemadh ndaj njerëzve të virtytshëm.”

“Udhëheqja ka pesë pika të rëndësishme:

1. Fjala e drejtë.
2. Mbajtja e sekretit.
3. Mbajtja e marrëveshjes.

4. Të filluarit me këshillë.

5. Mbajtja e premtimit.”

“Imam Shafiu (r.a.), ka thënë: “Njeriu në këtë botë e arrin përsosmërinë vetëm me katër gjëra:

1. Dijanet / Feja.

2. Emanet / Të jesh besnik dhe i besueshëm.

3. Sijanet / Të mbrosh çdo gjë që duhet mbrojtur.

4. Rezanet / Dinjiteti.”

“Në një vend ku të tërheq biseda, përpiqu të hesh-tësh. Mos harro se ka shumë pak njerëz që janë bërë pishman për heshtjen. Ndërkohë ka shumë njerëz që janë bërë pishman për të folurën.”

“Budallai më flet në çdo lloj mënyre të shëmtuar. Ndërsa mua më duket e shëmtuar që t’i jap përgjigje. Sa më shumë që atij t’i shtohet budallallëku, aq më shumë më shtohet edhe mua pje-kuria dhe durimi si temjani që përhap erë të mirë kur digjet...”

“Imam Shafiu (r.a.), ka thënë: “Edhe e pakta e katër gjërave është e shumtë:

1. Sëmundja.

2. Varfëria.

3. Armiqësia.

4. Zjarri.”

“Për dy çështje mjeku nuk mund të bëjë asgjë: Budallallëku dhe pleqëria...”

“Ruaje gjuhën, o njeri! Ajo është një gjarpër. Andaj mos të të kafshojë!”

“Ai që i fsheh tri gjëra prej tre njerëzve, i bën pa-drejtësi vetes: Sëmundjen nga mjeku, nevojën nga miku dhe këshillën nga administruesi...”

“Humanizmi, domethënë zekati i të qenët njeri do të thotë që gjithmonë të bëhesh shkak për mirësi dhe për t’u plotësuar nevojat njerëzve.”

“Humanizmi qëndron mbi katër shtylla:

1. Morali i lartë.

2. Bujaria.

3. Modestia.

4. Falënderimi ndaj Zotit.”

“Gjithmonë shërbe dhe puno, sepse kënaqësia e vërtetë e jetës gjendet në një lodhje që s’ka aspak

bezdi.”

“Dija është një pre, ndërsa të shkruarit është laku i saj... Dijet që i ke gjuajtur (marrë) lidhi me leqe të forta... Të kapësh një sorkadhe dha ta lësh atë të lirë ndërmjet krijesave të tjera konsiderohet budallallëk.”

DIJETARI I VËRTETË

Sa më shumë që njeriu të mësojë gjëra të reja, aq më shumë e kupton mangësinë e tij. Nëse për shkak të kësaj i shtohet modestia, ja pra, atëherë bëhet dijetar.

“Baza e dijes është qëndrueshmëria. Ndërsa fryti i saj është mirëqenia... Baza e verasë, domethënë e largimit nga gjërat e dyshimta është të mjaftuarit

me ato që ka dhënë Zoti. Ndërsa fryti i saj është rehatia dhe prehja shpirtërore... Baza e durimit është pranimi. Ndërsa fryti i tij është arritja e fitores. Baza e punës është dhënia e mbështetjes nga Allahu. Ndërsa fryti i saj është arritja e suksesit... Ndërsa qëllimi i çdo gjëje është drejtësia, drejtësia, drejtësia...”

Bazuar në këto që thamë më sipër;

“Kushdo që e do këtë botë, le të kapet fort pas dijes. Kushdo që e do botën tjetër, edhe ai le të kapet fort pas dijes.”

“O vëlla! Dijen mund ta arrish vetëm me këto gjashtë gjëra: Zgjuarsia, vendosmëria, puna, mundësia ekonomike, qëndrimi me mjeshtrin dhe jeta e gjatë...”

“Ai që i mëson dije dikujt që nuk e njeh veten, e çon dëm të drejtën e dijes. Ndërsa ai që e fsheh dijen nga ai që e meriton, bën padrejtësi.”

“Imam Shafiu (r.a.), ka thënë: “Humanizmi qëndron mbi katër shtylla:

1. Morali i lartë.

2. Bujaria.

3. Modestia.

4. Falënderimi ndaj Zotit.”

“Konflikti në dije i ngurtëson zemrat dhe u hap rrugë urrejtjeve të fshehta.”

“Nuk ka mirësi në dijen që merret me mendjemadhësi dhe mburrje.”



“Mos qëndro në një vend ku nuk gjendet një dijetar për të të mësuar fenë dhe një mjek për të të shëruar kur të sëmuresh!”

“Dija nuk është ajo që ka mësuar përmendësh dijetari, por ajo prej të cilës ka dobi (shpirtërisht).” (Divanu’l-Imam esh-Shafii, Abdurrahman el-Mustavi; Hilmizade Ibrahim Rifat, Meshahir-i As’hab-i Gyzin ve Teraxhim-i Ahval-i Fukaha, fq. 131, 134, 137.)

Pejgamberi ynë i Nderuar ka thënë për dijetarët e vërtetë ndërmjet të cilëve gjendet edhe Imam Shafiu:

DIJETARËT JANË TRASHËGIMTARËT E PEJGAMBERËVE...

Njëra prej mrekullive më të mëdha të Krenarisë së Gjithësisë, të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) dhe trashëgimive më me vlerë që ka lënë janë sahabët e nderuar që ka edukuar.

“Imam Shafiu (r.a.), ka thënë: “Të mos kesh dyshim se ai që të lavdëron me një të mirë që nuk e ke, kur të nxehet me ty do të të akuzojë me një të keqe që nuk e ke!”

Zinxhiri i artë që fillon me këtë brez të famshëm dhe që formohet me tabiinët dhe etbai tabiinët të cilët i kanë ndjekur ata me mirësi, e kanë shfaqur në mënyrën më të bukur dhe të shkëlqyer fytyrën e qeshur të Islamit përgjatë shekujve që kanë ardhur pas Epokës së Lumturisë. Po ashtu nxorën në pah shembujt më të bukur të institucionalizimit në fushën e dijes dhe të urtësisë.

Hadithet fisnike që Resulullahu (s.a.s.), ua ka lënë dhuratë njëqind e njëzet mijë sahabëve të tij përgjatë njëzet e tre vitesh si të ishin perla dhe rubinë, u gjetën dhe u mblodhën pothuajse me përpikërinë e argjendarit. Aftësitë si gjykimi dhe nxjerrja e kuptimeve të fshehta, u mblodhën dhe si rrjedhojë dolën në pah ekolet e jurisprudencës islame. Në këtë mënyrë u shfaqën të gjitha shkencat islame të cilat si qëllim kishin arritjen e lumturisë së të dyja botëve.

U edukuan breza të devotshëm dhe të singertë që e bënë ditën natë në rrugën e dijes së dobishme

e cila e shpie njeriun te lumturia e kësaj bote dhe e botës tjetër dhe që përbën themelin e fortë të veprave të mira. Sahabët dhe brezat e mëvonshëm jepnin përpjekje shumë të mëdha për mësimin dhe përhapjen e dijes së dobishme.

Sepse ata e kishin mësuar nga i Nderuari ynë se;

Dija dhe urtësia janë prej faktorëve më të rëndësishëm që mundësojnë jetesën në një vend. Pejgamberi ynë i Nderuar e ka konsideruar prej shenjave të kiametit ngritjen e dijes në qiell.

Ja pra, në shekullin e 2-të hixhri;

Në vitin 150 hixhri kur ndërroi jetë Imam Azami, Ebu Hanife, i cili ishte një gjeni në jurisprudencën islame, në qytetin e Gazës në Palestinë, në një familje fisnike por të varfër prej kurejshëve, lindi fakihu i madh i të ardhmes:

MUHAMED IBN IDRIS ESH-SHAFII...

Imam Shafiu ishte një dijetar i madh i cili e kaloi të gjithë jetën me vështirësi ekonomike, presione politike dhe kurbet. Në moshën dy vjeçare mbeti jetim. Në moshë fëmijërore shkoi në Mekë. Aty mori mësim nga dijetarët që u jepnin mësim nxënësve në Mesxhidu’l-Haram (Qabe). Për shkak të varfërisë nuk gjente dot letër. Andaj ato që i mësonte i shkruante mbi kocka. Por ishte shumë i aftë dhe shumë i zellshëm. Ai mësoi përmendësh Kuranin Fisnik dhe koleksionin e haditheve që

titullohet Muvatta. Më vonë mori mësim nga Imam Maliku i cili ishte shembulli i edukatës dhe dinjitetit në Medine. Derisa i bëri të pavarura mendimet e tij në lidhje me jurisprudencën islame, e prezantoi veten si nxënësi i Imam Malikut. Më vonë mori detyrën si administrues në Jemen ngaqë kishte nevojë materiale.

“Imam Shafiu (r.a.), ka thënë: “Ai që i mëson dije dikujt që nuk e njeh veten, e çon dëm të drejtën e dijes. Ndërsa ai që e fsheh dijen nga ai që e meriton, bën padrejtësi.”

Imam Shafiu (r.a.), i cili u dallua me drejtësinë dhe devotshmërinë e tij, nuk i mbyllte sytë kun-



ZINXHIRI I ARTË QË FILLON ME KËTË BREZ TË FAMSHËM DHE QË FORMOHET ME TABIINËT DHE ETBAI TABIINËT TË CILËT I KANË NDJEKUR ATA ME MIRËSI, E KANË SHFAQUR NË MËNYRËN MË TË BUKUR DHE TË SHKËLQYER FYTYRËN E QESHUR TË ISLAMIT PËRGJATË SHEKUJVE QË KANË ARDHUR PAS EPOKËS SË LUMTURISË. PO ASHTU NXORËN NË PAH SHEMBUJT MË TË BUKUR TË INSTITUCIONALIZIMIT NË FUSHËN E DIJES DHE TË URTËSISË.



drejt padrejtësive. Ai nuk kishte konsideratë ndaj njerëzve që debatonin me njëri-tjetrin me metodat e ndyra të politikës. Në lidhje me këtë çështje jepte këto këshilla:

“Ai që të sjellë fjalë nga të tjerët, edhe të tjerëve u çon fjalë prej teje. Ai që të lavdëron me cilësi që nuk i ke kur e bën të lumtur, do të thotë për ty ligësi që nuk i ke kur ta nxehësh.”

“Imam Shafiu (r.a.), ka thënë: “Dija nuk është ajo që ka mësuar përmendësh dietari, por ajo prej të cilës ka dobi (shpirtërisht).”

Ai u arrestua dhe u shpie në Bagdad për shkak të shpifjes së një prefekti të cilin e kishte kritikuar për padrejtësitë dhe gabimet e tij. Ngaqë dihej dashuria që Imam Shafiu kishte për fëmijët e Pejgamberit tonë të Nderuar, qendra ishte njoftuar se ai ishte një rafidi. Në këtë mënyrë u kërkua që fakihu i madh të ekzekutohej me shpifje.

Ndërkohë Imam Shafiu i donte Aliun, Hysejnin dhe fëmijët e tyre për shkak të dashurisë dhe besnikërisë së madhe që kishte ndaj të Dërguarit të Allahut (s.a.s.).

DASHURIA NDAJ EHLI BEJTIT ËSHTË OBLIGIM!

Edhe vetë prejardhja e Imam Shafiu (r.a.), bashkohej me Muttalibin, i cili ishte prej gjyshërve të Pejgamberit tonë të Nderuar. Ky fakih i madh që ishte prej të afërmve të të Nderuarit tonë, e konsideronte obligim dashurinë ndaj ehli bejtit, të cilët ishin kujtimet fisnike të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Gjithashtu ai e konsideronte si një shtyllë të namazit thënien e lutjeve sal-li dhe barik në namaz. Këtë e kishte shprehur në këtë formë:

“O ehli bejti i Resulullahut! Dashuria ndaj jush është një obligim që ka zbritur në Kuranin e Allahut. Juve ju mjafton si lavdërimi më i madh që, atij të

cilit nuk ju çon salavate, nuk i pranohet namazi.”

Imam Shafiu (r.a.), ka thënë në lidhje me frymëzimin dhe atmosferën shpirtërore të Musa Kazimit, i cili ishte biri i Xhafer es-Sadikut:

“Pranimi i lutjes sime te varri i Imam Musa Kazimit ka krijuar vartësi te unë. Këtë e kam provuar shumë herë.”

Edhe Imam Shafiu mbeti ballë për ballë me sproven që e përjetuan të gjithë imamët e medhhebeve. Në Bagdad u shpie si një i dënuar. Ai mezi e shpëtoi jetën prej shpifjes se gjoja ishte kryengritës falë fuqisë së elokuencës dhe dëshmisë së mirë të dijetarëve të tjerë.

Përgjatë ditëve të qëndrimit në burg pa në ëndërr Aliun (r.a.). Në ëndërr Aliu (r.a.), e nxori unazën nga gisht i tij dhe ia vendosi në gisht Imam Shafiu. Kjo ëndërr tregonte se Imam Shafiu ishte flamurtar i dijes që përfaqësonte Aliu, i cili siç shprehet i Dërguari i Allahut (s.a.s.), ishte dera e qytetit të dijes.

Në Bagdad, atje pra ku e çoi kaderi, mori dije edhe nga nxënësi i Imam Azamit, Imam Muhamedit. Kështu u kthye përsëri në atmosferën e dijes prej të cilës kishte qëndruar larg ngaqë zgjodhi administrimin për arsye të nevojës. Në dijen e Hixhazit e cila kishte si bazë tekstet hyjnore e profetike, futi edhe qasjen me bazë mendjen sipas mënyrës së shqyrtimit të revelatës hyjnore që kishte Iraku.

“Imam Shafiu (r.a.), ka thënë: “O ehli bejti i Resulullahut! Dashuria ndaj jush është një farz që Allahu e ka zbritur në Kuran. Juve ju mjafton si burimi më i madh i krenarisë fakti që nuk i pranohet namazi atij që nuk ju dërgon salavate.”

Imam Shafiu (r.a.), ka thënë:

“Siç ka syri një kufi përtej të cilit nuk mund të shikojë, edhe mendja ka një kufi deri te i cili arrin.”

RINIA ËSHTË PERIUDHA E EMOCIONIT DHE E NJË ENERGJIE TË MADHE. E RËNDËSISHME ËSHTË QË KËTË ENERGJI TA DREJTOJMË KAH E MIRA, E DREJTA DHE E DOBISHMJA PËR TË DJYA BOTËT. NËSE AJO ENERGJI NUK DREJTOHET KAH MIRËSIA, ATËHERË AJO E GJEN RRUGËN VETË DREJT TË KEQES. KUR UJI ORIENTOHET, BËHET I DOBISHËM PËR VRESHTAT DHE KOPSHTET, POR KUR LIHET SIPAS RRJEDHËS, SHNDËRROHET NË RRËKE DHE SHKATËRRON ÇDO GJË QË I DEL PËRPARA. SA BUKUR E SHPREH IMAM SHAFIU KËTË DUKE E PËRMBLEDHUR: “NËSE NUK E PREOKUPON VETEN ME TË VËRTETËN, DO TË TË PUSHTOJË E PAVËRTETA.”

Në këtë mënyrë ka mbrojtur sunetin e të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të, kundër racionalizmit të tepruar.

MBROJTJA E SUNETIT

Imam Shafiu kishte një përpikëri shumë të madhe për sa i përkiste çështjes së pasimit të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), me një nënshtrim të plotë. Nxënësve të tij dhe atyre që merrnin fetva dhe dije prej tij shumë herë u bëri këtë paralajmërim:

“Nëse gjendet ndonjë hadith që është në kundërshtim me mendimet e mia dhe që transmetohet në mënyrë të saktë nga Pejgamberi, dijeni se hadithi është më lart se mendimi im. Në këtë situatë mos e ndiqni mendimin tim!”

Kur dikush e pyeti Imam Shafiun (r.a.):

“A punon me këtë hadith?”, Imami i madh i dha këtë përgjigje:

“Si mund të dëgjoj një hadith nga i Dërguari i Allahut dhe të mos punoj me të?! Mos vallë më ke parë duke dalë nga kisha me kryq të lidhur në brez?” (Ebu Nuajm, Hilyetu’l-Evlia, IX, 106.)

Përsëri një ditë tjetër kur u pyet nëse punonte apo jo me hadithin që transmetonte, Imam Shafiu u dridh dhe u lëkund. Pastaj u përgjigj:

“More njeri! A më mban kjo tokë dhe a më pranon ky qiell nëse transmetoj hadith nga Resulullahu dhe nuk gjykoj sipas tij? Sigurisht që punoj me të! Çdo sunet i tij është një kënaqësi e papërshkrueshme për mua dhe ka një vend të veçantë te unë!” (Bejhaki, Menakibu’sh-Shafii, I, 475.)

Në fund të jetës së tij të mbushur plot me udhëtime, pas viteve që kaluan duke marrë dije në Mekë dhe Bagdad, shkoi në Egjipt. Në Egjipt gjeti respekt dhe mirëqenie. Pasi ndërroi vend, domethënë pasi u vendos në Egjipt, themeloi medhhebin e tij.

Imam Shafiu (r.a.), me veprat e tij në formën e themelit të metodologjisë së jurisprudencës islame, u bë mbrojtësi i rrugës së Ehli sunet ve’l-xhemat, domethënë i rrugës së drejtë në një periudhë kur frynin fuqishëm rrymat e përkthimeve filozofike dhe ato politike e teorike në kundërshtim me ehli sunetin.

Imam Shafiu dijen gjithmonë e shihte bashkë me devotshmërinë. Sa bukur e ka shprehur me këtë fjalë dallimin ndërmjet dijes së dobishme dhe dijes së padobishme:

DIJA E PADOBISHME ËSHTË FATKEQËSI!

“Nëse dija nuk ia shton të riut udhëzimin në zemër, ndjekjen e rrugës së drejtë përgjatë jetës dhe moralin e lartë, njoftojeni atë se Allahu Teala i ka zbritur një ndëshkim aq sa ai i atyre që adhurojnë idhujt.”

Imam Shafiu (r.a.), këtë vetëdije e pati marrë nga mësuesit e tij. Sa shumë domethënës është ky sugjerim i mësuesit të tij, Vekiut:

“Mësuesit tim, Vekiut iu ankova për memorien time të dobët. Ai më këshilloi që t’i lija mëkatet, “sepse”, tha: “Dija është drita e Allahut. Drita e Allahut nuk i jepet një mëkatari!”

“Imam Shafiu (r.a.), ka thënë: “Nëse dija nuk ia shton të riut udhëzimin në zemër, ndjekjen e rrugës së drejtë përgjatë jetës dhe moralin e lartë, njoftojeni atë se Allahu Teala i ka zbritur një ndëshkim aq sa ai i atyre që adhurojnë idhujt.”

Po ashtu edhe Imam Maliku i pati sugjeruar devotshmërinë Shafiut kur e takoi për herë të parë si një i ri i aftë.

Imam Shafiu kaloi një rini në varfëri, por me dëlirësi dhe pastërti. Ai e shpreh si më poshtë të fshehtën e kësaj:

“Baza e verasë, domethënë e largimit nga gjërat

e dyshimta është të mjaftuarit me atë që ka dhënë Zoti... Rezultati i kësaj është rehatia...”

“Imam Shafiu (r.a.), ka thënë: “Mësuesit tim, Vekiut iu ankova për memorien time të dobët. Ai më këshilloi që t’i lija mëkatet, “sepse”, tha: “Dija është drita e Allahut. Drita e Allahut nuk i jepet një mëkatari!””

Me këtë përsëritshmëri dhe dije arriti një gradë të tillë që, siç u bë imami i njërit prej katër medhhebeve, u bë edhe prej evliave të kohës duke përparuar në rrugën e miqësisë ndaj Allahut Teala. Historia e mëposhtme që tregohet për të, shpreh qartë se ai kishte arritur edhe kerametet (mrekullitë) që i arrijnë “evlijau’ll-llah / miqtë e Allahut”:

Perandori bizantin i cili i paguante taksa të larta shtetit Ab-basi, propozoi një debat duke dërguar katërqind priftërinj. Nëse priftërinjtë e krishterë do të fitonin, ata nuk do të paguanin më taksë.

Kalifi Harun Rrashidi i mbledhi buzë lumit Tigër të gjithë dije-tarët që gjendeshin në Bagdad. Ndërsa Imam Shafiu u caktoi zëdhënës. Imam Shafiu (r.a.), mori sixhadenë dhe shkoi drejt lumit Tigër plot dinjitet. Sixhadenë e shtroi mbi ujë, u ul mbi të dhe u tha priftërinjve:

“Ata që dëshirojnë të debatojnë me mua, le të vijnë këtu!”

Nuk kishte mbetur asgjë për t’u folur dhe debatuar. Imam Shafiu e tregoi realisht krenarinë e Islamit dhe i mposhti të gjithë priftërinjtë.

Të gjithë priftërinjtë që e dëshmuuan këtë skenë, e pranuan se Islami është feja e vërtetë dhe u bënë myslimanë. Ndërsa perandori i cili u njoftua për situatën, e ngushëlloi veten në këtë mënyrë:

“Sa mirë që nuk erdhi ai këtu. Përndryshe edhe priftërinjtë që gjenden këtu do të bëheshin myslimanë!”

Imam Shafiu (r.a.), e pati zgjidhur në formën më të bukur provën e njeriut me kohën. Për këtë arsye shprehej se njerëzit janë të shkujdesur ndaj sures Asr e cila ka pak fjalë, por kuptime shumë të thella. Andaj bëri këtë paralajmërim:

DO TË MJAFTONTE SURJA ASR...

“Nëse njerëzit do të mendonin dhe meditnin rreth sures Asr, ajo do t’u mjaftonte.” (Ibn Kethir)

“Imam Shafiu (r.a.), ka thënë: “A është logjike që karvanët të ndërtojnë shtëpi përgjatë udhëtimit?” “Ai që dëshiron të arrijë në vendin ku do të shkojë, nuk fle në stacion (nuk kaplohet nga shkujdesja në stacion).”

Kjo jetë e shkurtër e kësaj bote nuk është gjë tjetër përveç një shtëpi në të cilën bun apo një stacion në të cilin shkon njeriu përgjatë udhëtimit për në botën e përtejme. Imami i madh ka thënë:

“A është logjike që karvanët të ndërtojnë shtëpi përgjatë udhëtimit?”

“Ai që dëshiron të arrijë në vendin ku do të shkojë, nuk fle në stacion (nuk kaplohet nga shkujdesja në stacion).”

Imam Shafiu (r.a.), i cili shkroi vepra të mëdha dhe bëri shërbime të virtytshme përgjatë jetës së tij pesëdhjetë e katër vjeçare, bëri shumë kujdes për ta vlerësuar në mënyrën më efikase jetën e cila është një kapital, veçanërisht periudhën e rinisë. Këtë ua sugjeronte edhe brezave të rinj në poezitë që i thurte me këshilla plot urtësi:

“Një njeri që nuk e përjeton për një kohë vuajtjen e marrjes së dijes dhe nuk e ndjen dhimbjen e saj, përgjatë gjithë jetës do të përpëlitet në mjerimin e

inJORANCËS. Ai që e humbet mundësinë e nxënies së dijes në rini, do të thotë se ka vdekur. Andaj jepni katër tekbire për të! Pasha Allahun, vitaliteti i një të riu arrihet me dijen dhe devotshmërinë. Nëse nuk ekzistojnë këto të dyja, ekzistenca nuk ka asnjë dobi!”

“Imam Shafiu (r.a.), ka thënë: “Pasha Allahun, vitaliteti i një të riu arrihet me dijen dhe devotshmërinë. Nëse nuk ekzistojnë këto të dyja, ekzistenca nuk ka asnjë dobi!”

Rinia është periudha e emocionit dhe e një energjie të madhe. E rëndësishme është që këtë energji ta drejtojmë kah e mira, e drejta dhe e dobishmja për të dyja botët. Nëse ajo energji nuk drejtohet kah mirësia, atëherë ajo e gjen rrugën vetë drejt të keqes. Kur uji orientohet, bëhet i dobishëm për





vreshtat dhe kopshtet, por kur lihet sipas rrjedhës, shndërrohet në rrëke dhe shkatërron çdo gjë që i del përpara. Sa bukur e shpreh Imam Shafiu këtë duke e përmbledhur:

ZGJIDHE PREOKUPIMIN TËND!

“Nëse nuk e preokupon veten me të vërtetën, do të të pushtojë e pavërteta.”

Në rini, e cila është një periudhë kur jetës i shtohet jetë dhe përshpirtshmërisë i shtohet përshpirtshmëri, është shumë e rëndësishme që netët në veçanti të kalohen me ibadet. Sa bukur që e shpreh Imam Shafiu të vërtetën e kalimit të natës me ibadet, gjë e cila është e vlefshme kurdoherë:

DINJITETI I NJERIUT ËSHTË NË NETËT PA GJUMË!..

“Virtytet e larta arrihen sipas përpjekjeve të dhëna. Ai që kërkon virtyte të larta, i kalon netët pa gjumë. Kushdo që dëshiron të lartësohet pa u përpjekur, ai njeri do të thotë se po e çon dëm jetën për diçka të pamundur. Edhe kërkon dinjitet, edhe fle natën! (Ashtu?!.) Ndërkohë ai që kërkon perla, zhytet në det, jo në gjumë. Vlera e lartë është e lidhur ngushtë me përpjekjen e madhe. Ndërsa dinjiteti i njeriut gjendet në netët pa gjumë...”

O Zot! Për hatrin Tënd e kam lënë gjumin natën, o Zot i plotfuqishëm!.. Më jep sukses në marrjen e dijës dhe me ngre në gradat më të larta!..”

Gradat e larta që Imam Shafiu dëshironte t'i arrinte dhe të cilat i arriti me lejen e Allahut, sigurisht që nuk ishin pozita të larta që i përkasin kësaj bote. Ai kërkonte kënaqësinë e Allahut. Vlerat dhe pasuria që kërkonte ai nuk ishin gjëra të përkohshme dhe

që bëjnë tre-pesë grosh në peshoren e kësaj bote, por ishin gjëra si besimi, mirësia, devotshmëria dhe dija që mbartin vlera jetike në peshoren e ahiretit. Përsëri thotë në rreshtat e tij plot urtësi:

MOS KËRKO TË PËRKOHSHMEN!

“O ti që mendon se ke gjetur fisnikëri me dynjanë dhe gjërat e bukura të saj! Vdekja do t'i vijë edhe ndërtesës, edhe atij që e ka ndërtuar... Kushdo që ka për fisnikëri dynjanë dhe gjërat e bukura të saj, le ta dijë se fisnikëria e tij është shumë e pakët, provizore dhe e përkohshme... Dije se thesaret e kësaj bote janë prej floriri. Ti formoje thesarin tënd prej mirësive dhe besimit!..”

Me të vërtetë Imam Shafiu (r.a.), ishte një njeri me zemër të butë, me fjalë plot elegancë, me sy të përplotur dhe me ndjeshmëri. Kishte raste kur e humbte veten për shkak të ndikimit të përmbajtjes së ndonjë ajeti apo hadithi fisnik.

Edhe pse e kaloi me varfëri një pjesë të madhe të jetës, nuk ia shtriu dorën askujt ngaqë u mjaftonte me atë që kishte. Ndërsa kur posedonte qoftë edhe diçka të vogël, e jepte atë me një bujari të madhe. Ja një shembull për bujarinë e tij të rrallë:

Imam Shafiu (r.a.), bëri një udhëtim drejt Jemenit. Pastaj u kthye në Mekë. Me vete kishte 10.000 dërhëmë. Ai urdhëroi që t'i bënin një çadër jashtë Mekës dhe aty i priti vizitorët e tij. Populli shkoi grupe-grupe për ta vizituar dhe për t'i shfaqur nevojat. Imam Shafiu ua dha të varfërve që i shkuan dhjetë mijë dërhëmët dhe pastaj tha:

“Oh, tani u qetësova!”

Ai u jepte të tjerëve edhe pse vetë ishte nevojtar. Këto tri cilësi që i konsideronte të domosdoshme për përsosmërinë e vërtetë, i përjetonte edhe vetë:



“Veprat më të vështira janë këto të tria:

1. Bujaria kur ke pak pasuri.
2. Devotshmëria në vetmi.
3. Të thënët e vërtetës.”

Jahja ibn Maini, rahmetull-llahi alejh, e shpreh si më poshtë se si e thoshte të vërtetën (Imam Shafiu):

“Le të supozojmë se gënjeshtria është e lejuar. Prapë se prapë atë e ndalonte burrëria për të mos gënjyer.” (Muhammed Ebu Zehra, Imam Shafii, Botimet DiB – Diyanet Isleri Baskanlığı – e Kryesisë së Entit për Çështjet Fetare, fq. 36-39.)

Sinqeriteti i tij kishte arritur deri në atë pikë sa që lutej si më poshtë në një formë shumë të dëlirë:

“Sa shumë do desha që njerëzit ta mësonin këtë dije, të mos më atribuonin asgjë mua prej saj dhe të mos më lavdëronin. Në këtë mënyrë, ta merrja edhe unë shpërblimin dhe sevapin e saj.”

Imam Shafiu, rahmetull-llahi alejh, si një mirësi dhe dhunti e Allahut për të sinqertët dhe të devotshmit, edhe e ka marrë shpërblimin e botës tjetër për shërbimet fetare të tij inshallah, edhe është bërë imami i një prej medhhebeve me përhapjen më të gjerë në botën islame.

Prej medhhebit të Imam Shafiut u edukuan me mijëra dijetarë. Shumë dijetarë si Imam Neveviu, Imam Gazaliu dhe Imam Sujuti, i shërbyen dijes duke pasuar medhhebin e Imam Shafiut.

“Imam Shafiu (r.a.), ka thënë: “Sa shumë do desha që njerëzit ta mësonin këtë dije, të mos më atribuonin asgjë mua prej saj dhe të mos më lavdëronin. Në këtë mënyrë, ta merrja edhe unë shpërblimin dhe sevapin e saj.”

Imami i madh i cili kishte një dashuri jashtë-zakonisht të madhe ndaj Kuranit Fisnik, mbeti i privuar nga leximi i Kuranit afër vdekjes për shkak të sëmundjes. Andaj i kërkoi njerit prej nxënësve të tij që t’i lexonte ajetet e fundit të sures Al Imran. Edhe në momentet e fundit të jetës së tij të begatë dëgjoji me përkushtim këto ajete fisnike:

“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët.

Për ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës (duke thënë:)

“O Zoti Ynë!

Ti nuk i ke krijuar kot këto.

I lartësuar qofsh (nga çdo e metë)!

Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit.” (Al Imran, 190-191)

Allahu i Lartësuar mos na privoftë në këtë kohë të fundit të botës nga dija e vërtetë, e dobishme dhe që na shpie te lumturia e të dyja botëve. Gjithashtu mos na privoftë prej dijetarëve që kanë arritur përsosmërinë me këtë dije dhe që punojnë me dijen që posedojnë!

Zoti (xh.xh.), na e mundësoftë neve dhe fëmijëve tanë që të përfitojmë nga gjendjet e robërve fatlumë të cilët thellohen me sinqeritet e devotshmëri dhe lartësohen me modesti në dije e urtësi, të cilët pasurohen duke u mjaftuar me atë që posedojnë, të cilët e ndejnë kënaqësinë e jetës në shërbime fetare e ibadet dhe të cilët e kthejnë pro tyre rrjedhën e shpejtë të kohës me besim, vepra të mira dhe duke sugjeruar të vërtetën e durimin!

Amin!..

PA ARDHUR ENDE AJO DITË

— Sami Gëksyn —

Në kohën e hilafetit të vet, Omeri (r.a.), në vulën e tij kishte shkruar:

“O Omer! Vdekja të mjafton si ligjërues!”

Pra, në kuptimin; *“a mos po kërkon ndonjë ligjërues tjetër, nuk të mjafton vdekja?”*. Dhe sa herë që vuloste një shkresë zyrtare, e shikonte këtë fjali dhe merrte mësim.

Çdo i gjallë do të vdesë dhe çdo trup do të mbëshetet në prehrin e varrit. Këtë të vërtetë e di çdo gjallesë. Mirëpo, ata që nuk janë të përgatitur për jetën pas vdekjes, vazhdimisht largohen prej realitetit të vdekjes...

Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Thuaj: «Vdekja prej së cilës po ikni, do t’ju arrijë. Pastaj, ju do të ktheheni tek Ai, i Cili e di të padukshmen dhe të dukshmen dhe Ai do t’ju njoftojë për atë që keni bërë.» (Xhumu’a, 8.)

Ajo që i ka hije njeriut besimtar, është të mendojë shumë në lidhje me vdekjen, të mos e harrojë kurrë atë dhe të përgatitet për të. Kuptimi në mënyrë të drejtë i vdekjes, i lehtëson vështirësitë e kësaj bote dhe e ruan njeriun prej lakmisë së saj.

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Kujtojeni shpesh vdekjen që ua prish kënaqësitë.” (Tirmidhi, Zuhd, 4.) Me këto fjalë, Profeti (a.s.), ka dëshiruar që ne ta përkujtojmë vazhdimisht vdekjen me një meditim të thellë.

Vdekja u jep fund kënaqësive. Mirëpo këto kënaqësi, të cilave ajo u jep fund, janë thjesht të përkohshme. Nëse bëhen përgatitjet e duhura për vdekjen, nëse bëhet një jetë e dobishme, vdekja bëhet dera e kënaqësive të përhershme dhe të përjetshme. Lidhur me këtë, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Kush e do takimin me Allahun, edhe Allahu e do takimin me të. Por kush nuk e pëlqen takimin me Allahun, as Allahu nuk e pëlqen takimin me të!” Kur e dëgjoji këtë, nëna jonë Aishja (r.anha), u habit dhe pyeti:

“O i Dërguar i Allahut! A përfshihet këtu edhe mospëlqimi i vdekjes? Sepse askujt prej nesh nuk i pëlqen të vdesë” Resulullahu (a.s.), tha:

“Jo, nuk është kështu! Kur besimtari përgëzohet (i vjen vdekja) me mëshirën e Allahut, kënaqësinë dhe xhenetin e tij, ai e dëshiron shumë takimin me Allahun. Gjithashtu, edhe Allahu e dëshiron takimin me të. Ndërsa kur i vjen vdekja mohuesit, ai njoftohet me zemërimin dhe dënimin e Allahut. Për këtë arsye, ai nuk e pëlqen takimin me Allahun. Po ashtu, as Allahu nuk e do takimin me të.” (Buhari, Rikak, 41; Muslim, Dhikr, 14.)

Atëherë, për vdekjen, pra për botën tjetër duhen bërë përgatitjet e duhura.

Si?

Ashtu siç përgatitet dikush për një udhëtim të gjatë...

Pra, duke përgatitur mjetet dhe ushqimet e nevojshme për udhëtim...

Po çfarë janë këto mjete dhe ushqime?

Allahu i Madhëruar shpreh:

“...Pajisuni me gjërat që ju nevojiten për rrugë dhe dijeni se pajisja më e mirë është devotshmëria!..” (Bekare, 197.)

Në këtë udhëtim, neve na nevojiten më tepër përgatitje dhe pajisje. Ushqimi i këtij udhëtimi janë veprat e mira dhe devotshmëria. Frika nga Allahu dhe kërkimi i mbrojtjes së Tij. Kush pajiset mirë me devotshmëri, arrin shpëtimin dhe vendin e paqes. Kurse ata që nuk e bëjnë këtë përgatitje, pësojnë disfatë dhe shkatërrohen.

Ata që dalin në udhë pa u përgatitur, vuajnë dhe hasin shumë vështirësi... Po ashtu, edhe ata që dalin pa u përgatitur në udhëtimin drejt botës tjetër, do të digjen në një mijë e një pendime të padobishme:

“Kur i vjen vdekja ndonjërit prej tyre (jobesimtarëve), ai thotë: «O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira në botën që kam lënë!» Kurrsesi! Me të vërtetë, kjo është një fjalë të cilën ai (kot) e thotë! Prapa (vdekjes së) tyre do të ketë një (kohë) ndarëse, deri në ditën kur do të ringjallen.” (Mu'minun, 99-100.)

Atë ditë nuk ka kthim mbrapa!

Ndërsa sot ka. Sot, dera e teubes është e ende e hapur. Madje e hapur deri në fund. Sot është e mundur të kthehesh prej gabimeve, të heqësh dorë prej kundërshtimeve dhe të pendohesh.

Kjo derë është e hapur deri në frymën e fundit. Mirëpo, këtë çështje nuk duhet ta shtysh deri në frymën e fundit, sepse të nuk mund ta dish kurrë se kur do të jetë ajo frymë e fundit.

Kanë thënë:

“O njeri i mashtruar prej iluzioneve të gjata që je marrë me këtë botë! Vdekja të vjen kur nuk e pret, ndërsa varri është sënduku i veprave.”

Duhet menduar mirë se, askush nuk e di se kur do të vdesë. Edhe pse në lidhje me këtë botë ka shumë plane e projekte, vdekja mund t'i vijë papritur njeriut. Prandaj, mos u mashtro prej rinisë tënde duke thënë, “sa të kemi pleqtë s'na vjen radha neve!”

Shumë njerëz të rinj e të moshuar, të cilët kanë

rendur pas projekteve më të mëdha se të tuat, kanë vdekur dhe kanë ikur nga kjo botë duke i lënë punët e tyre përgjysmë. Ka shumë njerëz që e kanë përfunduar shtëpinë e tyre dhe kanë vdekur pa pasur mundësi të hyjnë brenda. Shumë bujq e kanë korrur e vjelë prodhimin e tyre, por kanë vdekur pa pasur fatin të hanë qoftë edhe një kafshatë prej tij. Po ashtu, ka edhe shumë shkrimtarë, të cilët kanë mbyllur sytë para se t'i mbarojnë veprat e tyre. Lidhur me këtë çështje, një i urtë thotë:

“O njeri që ke harruar ditën e udhëtimit! Po të shoh indiferent ndaj vdekjes që ndan miqtë nga njëri-tjetri.

Ti nuk po merr fare mësim prej atyre që shkojnë drejt asgjësimit. Në fakt, ai që vdes, shkon duke e lënë këtë botë kështu si është.

Ajo që kanë marrë me vete, është vetëm një copë qefini. Gjithçka që kanë bërë ka mbetur ashtu siç ishte.

Ata kanë rënë larg njëri-tjetrit atje poshtë në tokë. Ndërsa kur ishin gjallë, ishin miq e shok për kokë.

Edhe ti, nesër ose ndonjë ditë tjetër, do të jesh pranë tyre. Por në varr do të jeni të vetmuar.

Aty nuk do të kesh asnjë dobi prej njerëzve të cilëve u besoje, sepse nuk do të gjesh një mik që do ta mbajë premtimin.

Atëherë, përgatitu që tani për vdekjen dhe shpëto prej iluzioneve të kota, sepse ajo është shumë afër!”

Për të kujtuar, kuptuar dhe për t'u përgatitur për vdekjen, le t'u vëmë veshin këtyre fjalëve të Allahut të Madhëruar:

“Atëherë, përse kur (dikujt) i vjen (shpirti) në grykë para syve tuaj, ndërkohë që Ne jemi më afër atij se ju, por ju nuk e vini re. Përse pra, nëse nuk do të gjykohehi (në jetën e përtejme), ju nuk ia ktheni shpirtin atij? Përgjigjuni kësaj, nëse thoni të vërtetën! Kështu, nëse ai (në agonin) është nga ata që janë të afërt (me Allahun).” (Uakia, 83-88.)

“Por, kur shpirti të vijë në grykë e të thërrasin “A ka shërues”, atëherë, ai (që po vdes) do të bindet se ky është çasti i ndarjes dhe këmbët do të ngrijnë. Atë ditë, ai do të sillet te Zoti yt.” (Kijame, 26-30.)

Si përfundim, sado gjatë të jetojmë, një ditë do të futemi në varr dhe do të kthehemi tek Zoti ynë.

Allahu i Madhëruar na bëftë prej atyre që kthehen tek ai me besim të përsosur!..

Amin...



KJO BOTË ËSHTË E PËRKOHSHME

— Irfan Ozturk —

Një tregim prej epokës së lumturisë. Ta lexojmë e ta dëgjojmë duke e kuptuar për të marrë mësim:

Në shtëpinë e bekuar të Profetit (a.s.), ishte një gjendje ndryshe nga herët e tjera. Profeti ynë (a.s.), rrinte i heshtur dhe nuk lëvizte. Atyre që dëshironin të hynin brenda nuk u jepej leje. Më vonë, kur kërkuan leje Ebu Bekri dhe Omeri (r.anhuma), atyre iu dha leje nga Profeti dhe hynë brenda.

Profeti qëndronte ulur dhe përreth kishte bashkëshortet e tij...

Asgjë nuk pipëtinte... Mirëpo, ishte e qartë se kishte ndodhur diçka që e kishte shtyrë Profetin (a.s.), në heshtje...

Në sajë të intuitës së Ebu Bekrit (r.a.), çështja u kuptua disi:

Bashkëshortet e nderuara të Profetit tonë (a.s.), deri atë ditë, kishin bërë durim ndaj vuajtjeve dhe vështirësive që kishin kaluar. Mirëpo, me shtimin e mundësive, ato, të gjitha së bashku, i kishin shprehur dëshirat e tyre tek Profeti (a.s.). Ato kishin filluar të kërkonin diçka më shumë në shtëpi, si ushqim e pije dhe plotësimin e nevojave të tyre.

Mirëpo, çfarëdo që t'i binte në dorë, Profeti (a.s.), ua dërgonte të varfërve ose sahabëve të sufes. Atë që kishte në mbrëmje, nuk e linte për në mëngjes. Në këtë mënyrë, ai vazhdonte të ishte bujar dhe altruist. Dhe po të njëjtën gjë e priste edhe prej bashkëshorteve të tij të nderuara.

Resulullahu (a.s.), i buzëqeshi lehtë shokut të tij të shpellës, Ebu Bekrit (r.a.), i cili do ta kuptonte më mirë atë dhe i tha:

“Të gjitha këto që shihni përreth, kërkojnë nafakë¹ prej meje!”

Kur Omeri (r.a.), dëgjoji se vajza e tij Hafsa

(r.anha), e kishte mërzitur Profetin (a.s.), për gjëra të kësaj bote, menjëherë iu vërsul asaj. Po ashtu, edhe Ebu Bekri (r.a.), u çua dhe iu drejtua vajzës së tij Aishes (r.anha), duke i thënë:

“Domethënë ju po kërkonit prej Resulullahut atë që ai nuk e ka!?”

Ato thanë:

“Betohe mi në Allahun se ne kurrë nuk kërkojmë prej tij atë që ai nuk e ka!”

Profeti ynë (a.s.), ishte i vendosur që të mos fuste në shtëpi asnjë pasuri tjetër përveç thesarit të “mjaftueshmërisë” dhe “pasurisë së zemrës”. Për shkak të hidhërimit që ndjeu prej kërkesave të bashkëshorteve të tij, ai qëndroi një muaj larg tyre. Pas kësaj, zbriti ky ajet fisnik:

“O i Dërguar! Thuaju grave tua: «Nëse dëshironi jetën e kësaj bote dhe shkëlqimin e saj, ejani, unë do t’ju lë të kënaqeni për ca kohë dhe do t’ju lëshoj si është më mirë. Por, nëse dëshironi Allahun, të Dërguarin e Tij dhe botën tjetër, dijeni se Allahu ka përgatitur shpërblim të madh për ato prej jush që bëjnë vepra të mira.» (Ahزاب, 28-29.)

Ky ajet fisnik, shpall se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka të drejtë dhe i bën thirrje bashkëshorteve të tij të bëjnë zgjedhjen që dëshirojnë.

Më pas, i Dërguari i Allahut (a.s.), i tha kështu Aishes (r.anha):

“Do të të pyes në lidhje me një çështje. Dëshiroj që të mos nxitohesh në dhënien e përgjigjes. Mund të përgjigjesh pasi të jesh këshilluar me nënën dhe babanë tënd.”

“Ç’është ajo çështje o i Dërguar i Allahut?” – pyeti Aisheja (r.anha). Më pas, Profeti (a.s.), këndoi ajetin që u zbrit. Ndërsa Aisheja (r.anha), me keqardhje dhe emocion thirri:

1. -Nafak: të mira materiale; para; ndihmë ekonomike

“A do të këshillohem me nënën dhe babanë tim për të të zgjedhur ty? Kurrë! Unë zgjedh Allahun, të Dërguarin e Tij dhe botën tjetër.” (Muslim, Talak, 29.)

Padyshim se, edhe zgjedhja e nënës sonë Hafsës (r.anaha) dhe e bashkëshorteve të tjera të Profetit (a.s.), ishte e njëjtë me atë të Aishes (r.anha).

Ato nuk deshën luks, madhështi dhe rehati, por vetëm diçka për të jetuar. Kërkuan vetëm ushqime për shtëpinë e tyre. Mirëpo, i Dërguari i Allahut nuk pranoi. Një kërkesë, që për ne mund të konsiderohet e arsyeshme dhe e pafajshme, për familjen e tij ishte diçka e pafalshme. Ai u mërzi me to. Ndërsa Allahu i Madhëruar i ftoi të zgjidhnin: **“Ose këtë botë, ose Resulullahun!”**

Ato zgjodhën Resulullahun (a.s.). Zgjodhën botën tjetër. Jeta ndaj së cilës bënë durim, nuk ishte e lehtë dhe e thjeshtë. Lidhur me këtë, Aisheja (r.anha), i tregon nipit të saj Urues:

“O biri i motrës sime! Betohe me në Allahun se ne kemi parë një hënë, pastaj një hënë tjetër, pastaj edhe një hënë, pra, kemi parë tri hëna në dy muaj, ndërkohë që në shtëpinë e të Dërguarit të Allahut nuk ndizej fare zjarr.”

“Po si jetonit, o teze?” – e pyet Urue:

“Me dy gjëra; hurma dhe ujë. Përveç këtyre, Resulullahu (a.s.), kishte disa fqinj prej ensarëve, të cilët kishin bagëti. Ata i dërgonin Resulullahut prej qumështit të bagëtive të tyre, të cilin ai na e jepte neve.” (Buhari, Hibe, 1.)

Profetit tonë (a.s.), i vini shumë mundësi për të mira materiale. Mirëpo, ai më parë mendonte për nxënësit e tij të varfër, fqinjët e tij të uritur dhe për luftëtarët dhe ligjëruesit e fesë që përpiqeshin për të ftuar njerëzit në Islam. Kjo, sepse në Islam, në plan të parë vihet tjetri, pastaj vetja. Ata që e fryjnë barkun bashkë me familjen në shtëpitë e tyre, ndërkohë që fqinji i tyre fle i uritur, nuk e kanë besimin të pjekur aq sa duhet. Sahabët fisnikë, të cilët ishin edukuar me këto virtyte të larta të Profetit (a.s.) dhe e zbatonin sunetin e tij gërmë për gërmë me respekt të jashtëzakonshëm, brenda çerek shekulli çliruan shumë vende. Në këtë mënyrë, ata arritën lumturinë e ndërtimit edhe të fesë, por edhe të botës së tyre.

O vëlla!

Kjo botë është e përkohshme dhe fundi i kësaj bote është shkatërrimi. Për këtë arsye, edhe neve duhet të ndjekim rrugën e sahabëve fisnikë. Po ashtu, në çdo punë, në çdo fjalë dhe në çdo vepër tonën, duhet të synojmë vetëm pëlqimin e Allahut të Madhëruar, me qëllim që në sajë të kësaj bote të përkohshme, të fitojmë lumturinë dhe shpëtimin e botës së përjetshme.

Rruga që ka treguar Profeti ynë (a.s.), është rruga e xhenetit. Është rruga e kënaqësisë, faljes dhe mirësisë së Allahut.

Sado gjatë të jetojë një njeri, fundi i tij është vdekja. Dhe, nga vdekja nuk ka shpëtim. Ndërsa Islami do të ekzistojë deri në ditën e kijametit. Mirëpo, këtë amanet të shenjtë që sollën deri tek ne sahabët fisnikë, tabiinët, tab-i tabiinët, muxhtehidët dhe dijetarët, duhet t’ua përçojmë edhe ne brezave të mëvonshëm në të njëjtën mënyrë, me qëllim që ashtu si të parët tanë, edhe ne të arrijmë lumturinë dhe shpëtimin në këtë botë dhe në botën tjetër.

O vëlla që thua “e kam mendjen në vend”!

A mund t’i mendosh të gjitha këto? Shikoje me kujdes këtë gjithësi për të marrë mësim! Do të shohësh se shumë ndërtime janë shkatërruar, kush vjen ikën dhe kush ikën nuk kthehet më pas. Ty dhe mua na është afuar shumë ky udhëtim drejt pafundësisë dhe, dita kur do të ndahemi nga kjo botë që na ka mashtruar, është e afërt. A je përgatitur?

O ti që i beson rinisë tënde!.. Shumë fruta ranë pa u pjekur dhe u kalbën. Edhe këta të moshuar që i sheh dhe ndjen keqardhje për ta, njëherë e një kohë kanë qenë të rinj dhe të fortë si ti. Pa shiko tani se si u është kërrusur beli dhe këmbët nuk u mbajnë më trupin. Edhe këto fytyra të rrudhura që sheh, njëherë e një kohë kanë qenë shumë të bukura, aq sa ata që i shihnin mrekulloheshin. Edhe këta njerëz të sëmurë e të vuajtur, njëherë e një kohë kanë qenë të shëndetshëm dhe të fortë. Këto ndërtesa të shkatërruara që sheh, më herët kanë qenë të bukura. Prej këtyre dritareve të prishura, njëherë e një kohë dëgjoheshin zërat e sazeve dhe të qeshurave deri në rrugë. Ndërsa tani, janë bërë fole për qyqet.

Ata që prehen në atë varrezë që sheh, një herë e një kohë, ishin të gjallë. Ata qeshnin, argëtoheshin, vraponin, hidheshin, kërcenin dhe jetonin në qejf të tyre ashtu si ti. Pa shiko, tani nuk u dëgjohet as zëri as fryma.

Atëherë, thirri mendjes, sepse në fund, do të shkosh në një vend që quhet varr. Aty nuk do të kesh as shokë dhe as fqinj. Bashkudhëtarët e tu do të jenë veprat e tua të mira ose të këqija që ke bërë në këtë botë. Ndërsa Ai që i di të gjitha të fshehtat e tua, është Allahu i Madhëruar.

Ai vend që quhet varr, është i errët. Prandaj merr dritë me vete. Drita e atij vendi është teuhidi dhe Kurani. Nëse dëshiron të marrësh shok aty, atëherë bëj punë të mira dhe të dobishme sa të kesh mundësi dhe përpigu të jesh njeri i moralshëm.

O vëlla! Në fund të gjithë do të vdesim dhe do të hyjmë në varr, apo jo!..



SISTEMI NERVOR

NE JEMI TË PAAFTË PËR TA FALËNDERUAR ZOTIN

— Doç. dr. Fërat Erdoan —

Komentet tona përballë faktit që receptorët përpunojnë mesazhin e çastit nga organi më ekstrem, nervat e çojnë në qendër, reagimi ndaj tij në një fraksion të vogël sekonde, pyetjet që kërkojnë arsytim të tillë si, nëse do ta pyesim këtë çështje në qendër apo do t'i përgjigjemi sipas memories, me kaç përsosmëri, shpejtësi dhe gabim shumë të ulët, janë: Ne jemi të paaftë për ta falënderuar Zotin...

Kur jemi të lodhur ose të sëmurë, shpesh përdorim fjalinë: “Nuk kam fuqi as për ta ngritur krahun.” Në fakt, në këtë fjali mendoj se ka një neglizhencë të madhe që nuk vihet re. Sikur ngritja e krahut është një punë e vogël, e lehtë, e parëndësishme...

Jini të sigurt se artikulli më i shkurtër që mund të shkruhet për të vlerësuar ata që kontribuojnë në transportin e çantës me dy bukë dhe për ta falënderuar Atë që na e ka dhënë këtë mirësi, do të mbushte disa vëllime. Në këtë artikull, le të ndajmë historitë e disa ngjarjeve që i përkasin këtij organizimi madhështor me shpresën se do të bëhet shkak për meditim.

Kur bëhet fjalë për aktivitetin motorik, vendimarrësi i aktivitetit të planifikuar është truri, siç mund të pandehet. Ne përdorim 43 muskuj për të vrenjtur vetullat, gjë që mund të konsiderohet si gjëja më e

thjeshtë. Kur themi e thjeshtë, është e nevojshme të pyesim ata me paralizë të fytyrës për madhështinë e «mirësisë së të vrenjturit të vetullave»...

Kur u zgjuat në një mëngjes, ndjetë «diçka të çuditshme». Kur shikoni në pasqyrë, njëra anë e fytyrës suaj është si natën e kaluar. Ana tjetër është si fytyra e dikujt tjetër. Ajo nuk lëviz. Prandaj, nuk mund të buzëqeshni dhe goja juaj është varur në njërenë anë. Vetullat mund t'i vrenjtni në anën tjetër, por në këtë anë nuk ka asnjë «lëvizje». Arsyeya mund të jetë ose gjumi para kondicionerit mbrëmë, ose ndonjë infeksion...

Më keq akoma, një tumor i trurit mund të fillojë kështu. 12 nerva të quajtura «çiftet e kokës» në zonën e kokës i mundësojnë fytyrës sonë të kryejë aktivitetet e saj. Kur njëri prej këtyre nervave i ekspozohet presionit përgjatë rrugës që kalon, shkakton

humbje të përkohshme ose të përhershme të aktivitetit të tij. Është i njëjti parim si në sëmundjen e hernies së diskut ose të tunelit karpal. Lëvizjet milimetrike e prishin të gjithë organizimin.

Një tjetër organ ekzekutiv i udhëzimeve që dalin nga zona e trurit të quajtur korteksi motorik janë «nervat periferikë». Palca kurrizore, të cilën mund ta quajmë shtrirje natyrale e trurit, shtrihet poshtë nga pjesa e brendshme e shtyllës kurrizore dhe përfundon 2-3 cm mbi majën e kockës së kofshës. Kjo është veçanërisht e rëndësishme. «Lëngu cerebrospinal» (CSF), i cili prodhohet në tru dhe gjendet brenda në tru, zbrit deri në këtë pikë. Analiza e lëngut që merret prej këtu me një proces të thjeshtë jep informacione të rëndësishme për trurin. Diagnoza më e lehtë/e garantuar e meningjtit bëhet duke ekzaminuar këtë lëng.

Palca kurrizore që zbrit poshtë ka degë në nivelin e secilës rruazë. Vetëm një nga aktivitetet e shumta të këtyre nervave është «funksioni motorik». E shihni shpesh në buletinet e lajmeve, "...miliona lekë duhen që djali i vogël të ecë". Pse? Sepse ai nuk mund të ecë për shkak të një sëmundjeje të quajtur SMA... (Shumë lloje të saj për fat të keq shkojnë deri në vdekje.)

Kur gjeni SMN, i cili është përgjegjës për zonën ku dalin nervat në palcën kurrizore (qelizat e britit të përparmë), është me defekt, proteina smn nuk mund të prodhohet dhe qelizat nervore fillojnë të vdesin një nga një. Nëse ekziston vetëm një proteinë e prodhuar nga një gjen i vetëm, ju mund të ekzistoni. Përndryshe... Enzimat dhe proteinat si kjo që funksionojnë për ju pa dijeninë tuaj... Allahu mos na sprovoftë me mungesën e tyre! Fibra nervore që del nga këtu shkon te muskuli për të cilin është përgjegjës, ngjitet me të dhe aktivizon proteinat atje. Aktina, miozina, troponina...

Organi që ne e quajmë muskul, formohet nga fibrat (qeliza) muskulare. Të gjitha mbliidhen në një këllëf dhe forca lind nga uniteti.


Një fibër nervore mund të stimulojë shumë fibra muskulare në të njëjtën kohë. Qelizat muskulare (fibrat) kontrahohen me instruksionin nga nervi dhe mundësojnë lëvizjen e kockave (dhe nyjeve) me të cilat janë të ngjitura. Ne e kemi përmbledhur në 3 fjali, por edhe emrat e proteinave që shërbejnë gjatë kësaj tkurrjeje dhe janë të pranishme në një sasi të pamatshme në çdo fije muskulare, zënë një vend shumë të madh.

Relaksimi i një muskuli është po aq kompleks sa edhe tkurrja e tij. Më e rëndësishmja, gjatë tkurrjes

së një grupi muskujsh, duhet të relaksohen muskujt e tjerë gjithashtu. Më e thjeshta, nëse muskujt në syrin tuaj që shërbejnë për të parë brenda dhe jashtë nuk mund të punojnë në koordinim, ndodh «shtrembërimi i syve» .

Përveç kësaj, gjatë hedhjes së një hapi, një grup muskujsh tkurret ndërsa të tjerët relaksohen, por brenda të njëjtës sekondë, ky aktivitet duhet të kryhet në këmbën tjetër dhe kjo duhet të bëhet në harmoni të madhe me këmbën tjetër. Kur ata që kryejnë shërbimin ushtarak t'i kujtojnë vështirësitë që kanë vuajtur gjatë ceremonive, do ta admirojnë më shumë këtë sistem.

Nuk kemi durim dhe vend të mjaftueshëm për të thënë se receptorët, rrugët e ndryshme nervore, truri i vogël dhe veshi i brendshëm punojnë që ata të jenë të ekuilibruar dhe të fokusuar te qëllimi. Faktikisht, detajet teknike nuk janë aq të rëndësishme. Çfarë mrekullish kemi parë deri në ditët e sotme?! Megjithatë, komentet tona përballë faktit që receptorët përpunojnë mesazhin e çastit nga organi më ekstrem, nervat e çojnë në qendër, reagimi ndaj tij në një fraksion të vogël sekonde, pyetjet që kërkojnë arsytim të tillë si, nëse do ta pyesim këtë çështje në qendër apo do t'i përgjigjemi sipas memories, me kaq përsosmëri, shpejtësi dhe gabim shumë të ulët, janë: Ne jemi të paaftë (të pamundur) për ta falënderuar Zotin...





CILA STINË VJEN KUR BIE GJETHJA E FUNDIT?

— M. Ali Eshmeli —

Biri i njeriut, kur nuk mund të shohë, është një krijesë e çuditshme, ndërsa kur ka mundësi të shohë, është një krijesë krejt tjetër.

Kur ai e mbush me pluhurin e kësaj bote dhe e verbon gjethen e shpirtit të jetës që i jepet për të hapur sytë, mjafton që ajo gjethe të bjerë, që ai të kuptojë të vërtetën e madhe. Kështu ka ndodhur edhe për bij profetësh. Pa rënë gjethja e fundit, nuk e kanë kuptuar se në cilën stinë janë dhe kanë jetuar si indiferentë të dobët. Ndërsa fundi i tyre ka mbaruar me “Mjerë unë!”.

Në fakt:

Ata që kanë vdekur para tyre e kanë thënë, por ata nuk e kanë kuptuar.

Librat e kanë thënë, por nuk e kanë kuptuar.

Allahu e ka thënë, përsëri nuk e kanë kuptuar.

Edhe profetët e kanë thënë, por përsëri nuk e kanë kuptuar.

Pa shpresë:

Çështja ka mbetur veç në rënien e gjethes së fundit.

Sa e hidhur!

Ja një shembull mësimdhënës:

Tokën kishin filluar ta përpinin ujërat e tufanit. Nuhu (a.s.), i thërret edhe një herë me shpresën e fundit djalit të tij, i cili nuk e dëgjonte:

“Biri im! Do të mbytesh mes dallgëve, prandaj eja, hip shpejt në anijen e babait tënd!

Mirëpo djali i tij Kenani, nuk ia vuri veshin dhe i tha:

“Jo! Ti e di që unë kam besim tjetër. Pastaj, unë jam një notar shumë i mirë.”

“Biri im! Të dish not, nuk të bën aspak dobi përballë këtij dënimi hyjnor që quhet tufan! E çfarë dobie ka njohja e notit përballë një katastrofe të tillë të tmerrshme? Zgjuhu biri im, thirri mendjes! Mos humb kohë por hip shpejt në anijen e shpëtimit!”

“Mos u lodh kot baba! Ki besim tek unë dhe mendja ime. Pa shikoje atë malin. Ai është më i lartë se anija jote. Do të ngjitem atje dhe do shpëtoj.”

“Eh o biri im i pabindur! Ai që ti e quan mal, sot nuk ndryshon aspak prej një gjetheje. Pas pak edhe atë do ta përpijnë dallgët.”

“Një gjë e tillë s’ka për të ndodhur. Këto broçkulla thua jua atyre që ke me vete. Lërmë rahat tashmë. Unë jam i një feje dhe i një botëkuptimi tjetër. Këshillat e tua nuk më duhen.”

“Biri im! Tani nuk është koha për naze. Dënimi i Allahut është duke ardhur. Para fuqisë së Tij, çdo gjë është një hiç. Hakmarrja e Tij është e dhimbshme. Thirri mendjes dhe shiko të shpëtosh veten!”

“O baba! Ende vazhdon të thuash të njëjtat gjëra. Gjithmonë këto thua gjatë gjithë këtyre qindra viteve që ke jetuar. Në këtë mënyrë i ke bezdisur të gjithë, edhe mua. Sa njeri i paditur që je! Ke një mendje aq injorante, sa nuk arrin ta shohësh këtë bezdi që kemi! Çfarë je duke folur më? A nuk të mjaftuan përgjigjet e akullta që more prej gjithë atyre njerëzve? Unë kam qenë kundër fjalëve të tua që prej kur kam rënë në mend. A do të dëgjoj fjalët e tua tani që jam bërë burrë i mençur dhe i ditur? Kurrë!”

“Sa keq biri im! Të paktën kësaj here dëgjoje fjalën e babait tënd.”

Sapo Kenani po bëhej gati t’i kthente një tjetër përgjigje arrogante, një dallgë e stërmadhe, i zuri gojën atij djali të pabindur, duke i dhënë një shuplakë të fuqishme majtas-djathtas. Ajo nuk i dha mundësi të kundërvihet qoftë edhe për një çast të vetëm, por e tërhoqi dhe e mori në thellësitë e atij deti dënimi, duke e shkatërruar në një errësirë pa fund të një dënimi të dhimbshëm.

Më pas:

Kenanit nuk i mbeti as tru, as mendje. Nuk i mbeti as njohja e notit dhe as burrëria. Nuk i mbeti as mali dhe as gjërat në të cilat besonte. Ai u shkatërrua së bashku me gjithçka që kishte.

Përballë kësaj të vërtete shumë domethënëse, Mevlana i nderuar thotë:

“Filozofi i besoi vetëm mendjes së vet, duke e mbushur veten me një mijë e një mendime të komplikuara.

Mirëpo:

Ka shumë dije, shumë mendje, shumë botëkuptime dhe shumë zgjuarsi, të cilat u bëhen fantazma shumë udhëtarëve të së vërtetës dhe u presin rrugën. Për të shpëtuar prej së keqes së filozofëve, shumica e xhendetlinjve nuk i besojnë shumë mendjes.

Po kështu edhe djali i Nuhut (a.s.), Kenani... ah sikur ai të mos dinte not dhe të dëgjonte fjalët e babait të tij për të hipur në anije bashkë me të!

Ah sikur edhe ai të ishte si ata fëmijët e vegjël të paditur, të cilët kapen pas fustanit të nënës dhe të kapej pas fjalës dhe urtësisë së babait të vet, e të shpëtonte prej tufanit!

Ah sikur të mos ishte bërë si ata racionalistët me pak dije, të cilët mburren me veten e tyre, por të kishte dëgjuar dhe kuptuar fjalët e shpalljes hyjnore prej një të dashuri të Allahut!”

Domethënë:

Sikur të mos ishte një i zgjuar i tillë, por veç një i marrë. Ose më drejtë:

Sikur të ishte i marri i tokës dhe i mençuri i qiejve. Sikur të ishte i marrë në sytë e shejtanit, por i mençur në sytë e Rrahmanit! Mirëpo nuk ishte. Logjika e tij nuk i mjaftoi. Nuk arriti ta mendonte dhe u bë kurban i filozofisë së tij të pafrytshme.

Ajo ndodhi mbeti në të shkuarën. Ndërsa mësimet dhe urtësitë erdhën në ditën tona, me qëllim që indiferenca e mendjes dhe intuita e saj të njihen drejt dhe robërit ta përdorin atë për të shpëtuar e jo për t’u shkatërruar. Mirëpo, gjithmonë ka prej atyre që nuk arrijnë të lexojnë dhe të shohin ashtu siç duhet. Sot, si dje... Dikush është Nuh, e dikush Kenan. Pavarësisht tablove të hidhura të së djeshmes, sot ende:

Nxjerrja në plan të parë e mendjes njerëzore e cila mbyti Kenanin, duke lënë mënjanë meditimin dhe të vërtetat hyjnore që do ta hipte në anijen e shpëtimit të Nuhut (a.s.), pandehet si diçka e mençur nga disa të mjerë. Mbi të gjitha, disa prej këtyre janë edhe përfaqësues të fesë dhe bëjnë pjesë në kuadrot që japin edukim fetar.

Padyshim se i njëjtë si dje, do të jetë edhe fundi i atyre që vënë në garë mendjet e tyre përballë të vërtetave hyjnore pa e ditur se në cilin tufan të fund-kohës do të mbyten. Edhe nëse nuk ndodh ndonjë tufan gjithëpërfshirës, herët a vonë ata indiferentë i pret fundi i errët i dënimit kur të bien në tufanin e exhelit.

Të mos harrojmë se e vërteta që do ta mbrojë njeriun nga tufani i exhelit, nuk është idhujtaria e mendjes njerëzore e mbushur plot dobësi si në rastin e Kenanit, por vetëm ndjekja e ftesës së profetëve. Pa u hapur sytë me atë ftesë:

Të gjitha faqet në kalendarin e jetës, në të njëjtën kohë, janë edhe një lloj perdeje. Çdo fletë, është një perde. Perde të cilat formojnë një pengesë që njeriu të shohë më larg. Madje, për ata që bien në indiferencë të thellë, çdo fletë është si një mur i trashë që i verbon përballë të vërtetave.

Në këtë mënyrë edhe një fletë e stërhollë e jetës që ua mbyll sytë njerëzve të pabindur, është si një perde e çuditshme me trashësi kilometrike.

Ja pra, vetëm nëse këto perde të holla, por që në fakt janë shumë të trasha, largohen një nga një, njeriu mund të shohë, të kuptojë, të provojë dhe të konceptojë të vërtetat e qarta që më parë nuk i kuptonte.

Të njëjtat të vërteta:

Pyetjani një fëmije dhjetë vjeç, më pas një të riu njëzetepesë vjeçar, pastaj një të moshuari gjashtëdhjetëvjeçar dhe në fund një plaku që ka kaluar të njëqindtat. Sikur të kishit mundësi, mund të pyesnit

edhe një njeri që prehet në varr... Sa të ndryshme do të jenë përgjigjet!? Para syve të fëmijës dhjetë vjeç, gjenden ende një tufë me fletë që e pengojnë të shohë. I riu njëzetepesëvjeçar është ende i zënë me joshjen e fletëve që i zënë sytë dhe ende gjendet në pavetëdijen e pandehmës se imagjinata e tij është e vërteta dhe se e vërteta midis fletëve është imagjinatë. Po kështu, edhe i moshuari gjash-tëdhjetëvjeçar, pavarësisht prej mundësive që i jep përvoja, për shkak të shqetësimit për t'u kapur pas kësaj bote, ai preferon të mos shohë pas fletëve dhe, për këtë arsye edhe sytë e tij janë ende të robëruar nga perdet. Ndërsa plaku që i ka kaluar të njëqindtat, edhe pse ka kthyer shumë fletë, ai ende nuk e ka kthyer fletën e fundit. Mirëpo, ata që prehen në varr, janë ata të cilët e kanë kthyer edhe fletën e tyre të fundit!

Ja pra, ajo që shohin ata është pa perde, e qartë dhe hapur. Për shkak se para tyre nuk ka mbetur më asnjë perde, tashmë sytë e tyre nuk gabojnë. Tashmë, nuk ka asnjë të vërtetë që nuk mund ta shohin dhe nuk mund ta kuptojnë. Përballë së vërtetës së përjetshme, ata, janë ose të hidhëruar, ose të gëzuar, sipas gjendjeve që kanë pasur në këtë botë.

Domethënë:

Pasi të ketë rënë edhe gjethja e fundit, njerëzit do të jenë në dy grupe:

Njëri:

Është grupi i atyre që e kanë kaluar jetën në indiferencë ndaj Allahut, në të këqija, në kundërshtime dhe padrejtësi. Këta janë ata të cilëve do t'u jepet libri i punëve nga e majta.

Tjetri:

Është grupi i atyre që e kanë kaluar jetën në punë të mira, në përpjekje të dobishme, me sevape, vepra të mira e të sinqerta. Këta janë ata të cilëve do t'u jepet libri i punëve nga e djathta.

Këto dy grupe në aspektin e kuptimit të të vërtetave hyjnore, në jetën e kësaj bote kanë qenë shumë të ndryshëm nga njëri-tjetri, por të drejtat i kanë pasur pothuajse të barabarta. Mirëpo, kur u ra edhe gjethja e fundit, kësaj here të vërtetat i kanë pasur të njëjta, ndërsa të drejtat të ndryshme. Njëri është banor i xhenetit, tjetri është i xhehenemit.

Edhe pse shumica vazhdojnë të jetojnë pa e kuptuar këtë të vërtetë në këtë botë, kur të bjerë edhe gjethja e fundit, nuk do të mbetet askush që nuk e kupton.

Kur bie gjethja e fundit, shprehjet "ah sikur", "mjerë unë" etj., përhapen me shumicë. Ja disa nga shprehjet "ah sikur", për të cilat na njofton Kurani Fisnik:

"...Ah! Sikur të ktheheshim pas, nuk do t'i mthonim shpalljet e Zotit tonë dhe do të bëheshim

besimtarë!" (En'am, 27.)

"Ah sikur të ishim prej myslimanëve!.." (Hixhr, 2.)

"Ah, sikur të ktheheshim përsëri (në jetë) e të bëheshim besimtarë!" (Shuara, 102.)

"...Ah, sikur t'i ishim bindur Allahut dhe të Dërguarit!" (Ahzab, 66.)

"...Ah, sikur të ktheheshim edhe një herë (në jetën e Tokës)..." (Bekare, 167.)

"...Të mjerët ne, sa shumë që e kemi neglizhuar (Kiametin) në jetën e Tokës!.." (En'am, 31.)

Kur të bjerë gjethja e fundit:

"Atë Ditë keqbërësi do të hajë gishtat e duarve të veta, duke thënë: "Ah, sikur ta kisha marrë rrugën (e drejtë) me të Dërguarin! Ah, sikur të mos e kisha bërë filanin mik! Ai më ka larguar nga Këshilla (Kurani) që më kishte ardhur!" Në të vërtetë, djalli e braktis gjithmonë njeriun në çastin e nevojës." (Furkan, 27-29.)

"Ah, sikur të kisha bërë diçka të mirë për jetën time!" (Fexhr, 24.)

"Ah, sikur të ishte e mundur për t'u kthyer edhe një herë e të bëhesha njeri i mirë!" (Zumer, 58.)

Kur të bjerë gjethja e fundit:

"Por ai, të cilët do t'i jepet libri i veprave të tij nga ana e majtë, do të thotë: "Ah, sikur të mos më ishte dhënë libri im dhe të mos e kisha ditur llogarinë time! Ah, të kisha qenë i vdekur (e të mos isha ringjallur)! Pasuria ime nuk më solli dobi dhe më la fuqia ime!" (Hakka, 25-29.)

"Ah sikur të isha dhe!" (Nebe, 40.)

Ndërkohë që ata janë duke u përpëlitur me këto "ah sikur", nga melekët do të dëgjojnë: **"Sot për ju nuk ka lajm të mirë"** (shih. Furkan, 22.)

Kush janë ata që do të mbyten në "ah sikur", ditën kur do të ndalohet qoftë edhe një lajm i mirë?

Janë ata që në këtë botë:

Fletët e kalendari të jetës u janë bërë perde para syve.

Ata që për shkak të atyre perdeve, nuk i shohin dhe nuk i respektojnë të vërtetat madhështore, paralajmërimet hyjnore, urdhrat dhe ndalesat e Allahut të Madhëruar.

Ata që janë mbytur midis gënjeshtreve.

Ata që kanë jetuar larg fesë dhe moralit të vërtetë.

Ata që nuk i kanë hapur krahët e mëshirës për të varfrit dhe të vuajturit.

Ata që kanë heshtur përballë rënkimeve "kini mëshirë për ne!", të cilat shtohen dita ditës.

Ata që nuk e mbajnë fjalën.

Ata që janë të pistë dhe hipokritë në shpirt.
Ata që braktisën drejtësinë dhe zgjodhën mizorinë.

Mashtrulesit.
Të devijuarit
Ngatërrestarët.

Ata që pengojnë rrugën e mirësisë dhe rrugën e drejtë.

Ata që çojnë dëm gjithë brezat.

Ata që janë shokë të shejtanit dhe shpurës së tij.

Gjynahqarët.

Kriminalët gjakatarë.

Mosmirënjohësit ndaj Allahut.

Ata që kanë rënë në të keqen e mendjemadhësisë dhe arrogancës.

Ata që nga një anë bëjnë të diturin, nga ana tjetër janë në errësirën e injorancës.

Ata që nuk e kanë dëgjuar ashtu siç duhet Allahun dhe Profetin e Tij (a.s.).

Ata që kanë shfaqur besime dhe stil jete të devijuar sipas dëshirave dhe qejfeve të veta.

Ata që nuk e kanë marrë fare në konsideratë llogarinë dhe dënimin.

Ata që kanë ngrënë të drejtën e robit.

Ata që janë përzier në harame.

Ata që janë zhytur në amoralitet.

Ata që përhapin mikrobe dhe viruse në shpirtrat dhe zemrat e njerëzve.

Ata, këmbët e të cilëve kanë rrëshqitur nga rruga e drejtë.

Ata që pavarësisht të gjitha këtyre, nuk pendohen.

Ata që vdesin pa u penduar.

Ja pra:

Këta janë të mjerët që do të përpëliten midis “ah sikur”-ëve të tyre të pashpresa në një pendim të përgjeshëm.

Kur atyre t’u bien edhe gjethet e fundit në këtë jetë, stina e vetme që do të shohin, është vetë stina e katastrofës dhe e dështimit. Në të ardhmen e tyre, stina e vetme dhe e fundit për ta, do të jetë plot dënim...

**“A është i njëjtë ai, që veprat e veta të këqija i duken të mira (me atë që është i udhëzuar në rrugën e drejtë)?..”
(Fatir, 8.)**

Ata:

“Që shkelin besëlidhjen me Allahun, pasi janë zotuar për atë e, që këpusin lidhjet (familjare) që ka urdhëruar Allahu të ruhen dhe bëjnë çrregullime në Tokë - mbi ta rëndon mallkimi dhe përfundimi i keq!” (Rad, 25.)

Tashmë ata:

“..do të qëndrojnë përherë në zjarr dhe do t’u jepet ujë i valuar, që ua copëton zorrët” (Muhammed, 15.)

Ata:

“Njerëzit e së majtës – sa të poshtëruar janë fatkeqët! Ata do të jenë në afshin përcëllues të zjarrit dhe ujit të vluar dhe nën hijen e një tymi të zi, e cila nuk do të jetë as e freskët e as e këndshme. Ata, para kësaj, jetonin në luks dhe në vazhdimësi bënë gjynahe të rënda.” (Uakia, 41-46.)

Për rrjedhojë:

Sapo t’u bien edhe gjethet e fundit të jetës së tyre, ata dënohen menjëherë me pendimet, “ah sikur”.

Padyshim që:

Ata korrën atë që mbollën. Mbollën erë dhe korrën furtunë. Mbollën kundërshti dhe korrën dështim. Mbollën gjynahe dhe korrën “mjerë ne”. Mbollën urrejtje ndaj bukurive hyjnore, veprave të mira dhe devotshmërisë dhe korrën “ah sikur”.

Mirëpo:

Padyshim se, ata që të mbjellat i kanë prej mirësive, edhe të korrat do t’i kenë prej mirësive.

Ata që mbollën mirësi, korrën shpërblim.

Ata që bënë mirë, panë mirësi.

Allahu i Madhëruar shprehet:

“A është i njëjtë ai, që veprat e veta të këqija i duken të mira (me atë që është i udhëzuar në rrugën e drejtë)?..” (Fatir, 8.)

Kjo, sepse:

Ai që për shkak të perdes së indiferencës në sytë e tij, e pranon për të bukur një vepër që Allahu ka thënë se është e shëmtuar dhe e kryen atë si diçka të mirë, do ta marrë librin e punëve nga e majta.

Sa përfundim i keq është ky!

Mirëpo:

Ndërkohë, atij që nuk bën asnjëherë gjëra të këqija, por që edhe nëse bën, me anë të teubes së sinqertë, ai i kthen të gjitha të këqijat në të mira me lejen e Allahut, do t’i jepet libri i punëve nga djathta. Allahu është i kënaqur me të dhe ai është i kënaqur me Allahun. Në çastin që po i bie edhe gjethja e fundit e jetës, ai ftohet në një shpërblim të pafundmë në xhenet. Në Kuran urdhërohet:

“O ti shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai i kënaqur me ty! Bashkohu me robërit e Mi dhe hyr në Xhenetin Tim!”
(Fexhr, 27-30.)

Në një mënyrë të tillë, edhe Habibi Nexharit iu tha: “Hyr në xhenet!”

Ndërsa ai (përballë mirësive të pafundme që pa), tha:

“Ah, sikur ta dinte populli im, se si më fali Zoti im dhe më bëri të nderuar!” (Jasin, 26-27.)

Mjerë ata që nuk e dinë, lum ata që e dinë!

Kur t’i bjerë edhe gjithja e fundit e jetës, atij që i jepet libri i punëve nga e djathta, i thuhet:

“Selami qoftë për ty” nga njerëzit e së djathtës” (Uakia, 91.)

“Ai, të cilit do t’i jepet libri i veprave të tij nga ana e djathtë, do t’u thotë (njerëzve të tij): “Ja, lexoni librin tim! Vërtet, unë kam qenë i bindur se do të jepja llogari.” (Hakka, 19-20.)

Sepse, robër të tillë kanë jetuar gjithmonë sipas ajetit:

“Është i shpëtuar ai që pastrohet, që e përmend emrin e Zotit të vet dhe që fal namaz!” (A’la- 14-15.)

Për rrjedhojë:

“Kur melekët ua marrin shpirtrat, duke qenë të pastër, u thonë: “Shpëtimi qoftë mbi ju! Hyni në Xhenet, si shpërblim për veprat që keni kryer!” (Nahl, 32.)

“...banorëve të xhenetit u thuhet: “Selam qoftë mbi ju!” (A’raf, 46.)

Sepse:

“«Paqe!» do të jetë fjala prej një Zoti Mëshirëplotë.” (Jasin, 58.)

“(Njerëzve të tillë u thuhet:) «Ju bëftë mirë, hani e pini për atë, që keni bërë në ditët e kaluara!» (Hakka, 24.)

“Atë ditë, banorët e Xhenetit do të kenë vendbanim më të mirë dhe vëndpushim më të bukur.” (Furkan, 24.)

“Ata do të qëndrojnë në mes të lotuseve pa gje- mba dhe bananeve të mbushura me fruta, nën hije të gjera, pranë një uji rrjedhës, dhe mes frutave të llojllojshme, të cilat kurrë nuk sosën, as

nuk janë të ndaluara; dhe në shtroje të ngritura.”
(Uakia, 28-34.)

“..Një vend, ku ka lumenj me ujë të pandotur, lumenj qumështi me shije të pandryshuar, lumenj vere me shije të këndshme për ata që e pinë dhe lumenj prej mjalti të kulluar. Ata do të kenë aty lloj-lloj frutash dhe falje prej Zotit të tyre...” (Muhamed, 15.)

Ata janë:

“Njerëzit e së djathtës – sa të nderuar që janë fatlumët!” (Uakia, 27.)

Ata janë:

“Vërtet, ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Zoti i tyre do t’i udhëzojë në rrugë të drejtë, për shkak të besimit të tyre. Pranë tyre do të rrjedhin lumenj në kopshtet e kënaqësisë dhe lutja e tyre aty do të jetë “Qofsh i lavdëruar, o Zot!”. Përsëndetja e tyre do të jetë “Selam” dhe lutja e tyre e fundit “Falënderuar qoftë Allahu, Zoti i botëve!” (Junus, 9-10.)

Në atë botë të përjetësisë:

Kush janë ata që meritojnë paqen e pafundme me lavde dhe falënderime të pafundme, duke arritur selamet, shpërblimet dhe stinët e pafundme të xhenetit?

Ata:

Janë njerëzit, të cilëve gjethet e jetës nuk u janë bërë perde në sytë e tyre.

Njerëzit që i shohin qartë të vërtetat e pafundme para se t’u bien gjethet e fundit.

Njerëzit që jo vetëm i shohin, por këto të vërteta të larta, urdhrat dhe ndalesat hyjnore, i bëjnë parim të jetës së tyre, duke i vënë në jetë ato.

Ata që nuk ndahen nga e drejta pavarësisht çdo gjëje.

Ata që shfaqin gjithmonë moral dhe përpjekje në devotshmërinë ndaj Allahut.

Ata që vendosin kurorën e edukatës.

Ata që u hapin krahët e mëshirës dhe dashurisë të varfërve dhe të vuajturve.

Ata që nuk heshtin para thirrjeve “na mëshironi!”, të cilat shtohen përditë, por u dalin për zot atyre.

Ata që mbajnë premtimet.

Ata që janë të pastër dhe të sinqertë në shpirt.

Ata që janë pajisur me drejtësi.

Ata që nuk mashtrojnë.

Ata që hanë hallall.

Ata që bëhen shkak për udhëzim.

Ata që ndërtojnë vëllazërinë dhe paqen.

Ata që ecin dhe vrapojnë në rrugën e drejtë.

**“O ti shpirt i qetësuar!
Kthehu te Zoti yt,
ti i kënaqur me Atë
dhe Ai i kënaqur me ty!
Bashkohu me robërit
e Mi dhe hyr
në Xhenetin Tim!”**
(Fexhr, 27-30.)

Ata që garojnë në të mira.

Ata që gjallërojnë brezat.

Ata që bëhen shokë dhe bashkudhëtarë me të sinqertit dhe besnikët.

Ata që braktisin të keqen dhe drejtohen nga e mira.

Bamirësit.

Të devotshmit.

Ata që japin jetë.

Ata që janë besnikë ndaj Allahut.

Ata që ngrihen në miraxh me burakun e modestisë dhe përlësisë.

Ata që bëhen drita e dijes hyjnore, duke e kuptuar diturinë e tyre të pakët.

Ata që e dëgjojnë në mënyrën më të bukur Allahun dhe Profetin e Tij (a.s.).

Ata që shfaqin harmoninë e të jetuarit dhe të besuarit sipas caktimit të Zotit e jo sipas dëshirave të egove të tyre.

Ata që përgatiten për llogarinë e madhe me frikën ndaj Allahut.

Ata që përhapin mëshirë dhe shërim për shpirtat dhe zemrat e njerëzve.

Ata që janë të qëndrueshëm në fe.

Ata, këmbët e të cilëve nuk rrëshqasin nga rruga e drejtë.

Ata që shfaqin pendesë në çdo frymë.

Ata që e japin frymën e tyre të fundit duke thënë: "Allah!"

Ja pra:

Këta janë ata fatlumë që arrijnë lumturinë e pafundme kur bie edhe gjethja e fundit e jetës së tyre!

Për ata:

Stina e ardhshme, është vetëm stina e mirësisë, bujarisë, mëshirës dhe falënderimit.

Sepse:

"Ata janë ata që i përmbahen besëlidhjes me Allahun dhe nuk e prishin premtimin; dhe ata që mbajnë lidhjet (familjare) që ka urdhëruar Allahu të mbahen, që kanë frikë Zotin e tyre e i frikësohen llogarisë së rëndë; dhe ata që durojnë për të fituar dashurinë e Zotit të tyre, që falin namazin, që ndajnë fshehurazi dhe haptazi nga ajo që ua kemi dhënë Ne dhe, që të keqen, e kthejnë me të mirë. Këtyre u takon shpërblimi në Shtëpinë e fundit: Xheneti i Adnit, në të cilin do të hyjnë ata dhe besimtarët e ndershëm prej prindërve të tyre, grave dhe pasardhësve të tyre. Dhe engjëjt do të hyjnë tek ata nga çdo derë (e Xhenetit) (e do t'u thonë): "Shpëtimi qoftë mbi ju, për durimin që

keni treguar (në jetën e kësaj bote)! Sa vendbanim i bukur që është ky!" (Ra'd, 20-24.)

Lum ata që kur u bie edhe gjethja e fundit e jetës, arrijnë këto shpërblime dhe mirësi të pafundme hyjnore!

I nderuari Eshrefoglu Rumi, thotë:

"I shtrenjti im!

Ti silli para syve ata sulltanë, të cilët erdhën në këtë botë, por nuk i dhanë rëndësi fare. Ata nuk rëndën pas kësaj bote dhe nuk u përpoqën të mbledhin prej pasurisë së saj. Ata u morën me punët e botës tjetër. Ata e kuptuan se kjo botë, është vetëm një stacion mbi rrugën e botës tjetër. Ata u pajisën me gjërat e nevojshme për udhëtim dhe nuk u ndanë nga karvani. Ata nuk u mashtruan duke ia dhënë zemrën kësaj bote.

Vëllai im i shtrenjtë!

Shiko jetët e çmuara të robërve të pastër! Ata nuk ia dhanë vetes, por e shpërndanë për të varfrit. Ata ngopën të uriturit dhe veshën të zhveshurit. Ata kërkuan dhe gjetën nevojtarët. Ndërsa ata që u erdhën tek dera, nuk i lanë pa gjë. Ata rehatuan shpirtat e atyre që ishin në vështirësi dhe plotësuan nevojat e tyre."

Nuk duhet harruar se, kur të bjerë gjethja e fundit:

"Të vdekurin, e ndjekin tri gjëra deri tek varri: Familja, pasuria dhe vepra. Dy prej këtyre kthehen pas, ndërsa njëra qëndron me të. Familja dhe pasuria kthehen, ndërsa vepra e tij qëndron me të." (Buhari, Rikak, 42; Muslim, Zuhd, 5; Tirmidhi, Zuhd, 46.)

Sapo të bjerë gjethja e fundit:

"Nuk ka asnjë që vdes dhe nuk bëhet pishman. Padyshim se të gjithë do të ndihen pishman: Ai që është në rrugë të drejtë, do të bëhet pishman se, pse nuk i shtoi edhe më shumë veprat. Ndërsa ai që është në rrugë të keqe, do të bëhet pishman se, pse nuk e largoi veten nga të këqijat." (Tirmidhi, Zuhd, 59. [2405])

Kur të bjerë gjethja e fundit:

"...Të gjithë njerëzve u ndërpriten veprat, përveç tre personave: Ai që lë pas sadaka-i xharije, ai që lë dije të dobishme dhe ai që lë pas fëmijë të mirë që do të luten për të..." (Muslim, Uasijje, 14.)

"Sigurisht që janë të humbur ata që mohojnë takimin me Allahun! Kur Ora (e Kiametit) t'u vijë papritur, ata do të thërrasin: "Të mjerët ne, sa shumë që e kemi neglizhuar (Kiametin) në jetën e Tokës!" dhe do të bartin gjynahet e veta mbi shpinat e tyre. Eh, sa e shëmtuar është ajo barrë!" (En'am, 31.)

Komentuesi i Kuranit, es-Suddi, në shpjegimin e këtij ajeti, thotë:

“Tek çdo njeri i padrejtë që hyn në varr, vjen një burrë me fytyrë të nxirë, erë të keqe dhe rroba të pista. Njeriu i padrejtë frikësohet shumë kur e sheh atë person të frikshëm në një vend të vetmuar si varri dhe thotë:

- Sa fytyrë të shëmtuar që ke!
- Kaq të shëmtuara ishin edhe veprat e tua.- ia kthen ai.
- O sa erë të keqe ke!
- Edhe punët e tua kështu binin erë.
- Rrobat e tua qenka shumë të pista.
- Edhe punët e tua kaq të pista ishin.
- Kush je ti?
- Unë jam vepra që ke bërë!

Ky person i shëmtuar, qëndron në varr me të zotin e tij deri në ditën e kijametit. Në ditën kur njeriu ringjallet, ai do t'i hipë në shpinë dhe do të thotë:

- Në jetën e mëparshme unë të mbaja në shpinë. Tani në këtë botë, është radha jote të më mbash mua.

Më pas, ai e tërheq zvarrë dhe e fut në zjarr. Ja pra, kjo është edhe barra e keqe që përmendet në ajet!” (Ibn-i Kethir, Tefsir, 2/130.)

I nderuari Mevlana thotë:

“Kush e pa vdekjen të bukur si Jusufi, ai e sakrifikoji jetën. Mirëpo, kush e pa vdekjen të keqe si ujku, ai devijoi dhe doli nga rruga e drejtë.

Biri im! Vdekja e të gjithëve është sipas ngjyrës që kanë.

Atyre që e urrejnë vdekjen pa menduar se ajo i çon tek Allahu dhe që janë armiq të vdekjes, edhe vdekja u duket e frikshme dhe armiqësore. Ndërsa përballë atyre që janë miq me vdekjen, ajo shfaqet si mik.

O ti shpirt që frikësohesh dhe ikën prej vdekjes! Nëse do të dish të vërtetën dhe të drejtën, ti nuk ke frikë prej vdekjes, por prej vetes, sepse fytyra që sheh në pasqyrën e vdekjes dhe prej së cilës frikësohesh, nuk është fytyra e vdekjes, por fytyra jote e shëmtuar.

Mos harro!

Shpirti yt i ngjan një peme. Ndërsa vdekja është gjethja e saj. Dhe çdo gjethë është sipas llojit të pemës. Edhe nëse është e mirë, edhe nëse është e keqe, ajo gjethë ka çelur, ka dalë prej teje. Ashtu si çdo dëshirë apo çdo mendim që vjen prej zemrës tënde, qofshin të mira, apo të këqija, ato kanë ardhur prej ekzistencës tënde.

Nëse të ka shpuar një gjemb, nëse je plagosur nga një gjemb, atë gjemb ti e ke mbjellë. Por nëse ke veshur rroba të mëndafshhta, atë copë mëndafshi prapë ti e ke bërë.”

Pas vdekjes së Shah Nakshibendit, një pre atyre që e donte shumë, e sheh në ëndërr dhe e pyet:

“Çfarë vepre të mirë të bëjmë që të shpëtojmë?”

Ai tha:

“Me çfarë duhet të merreni në frymë e fundit, me atë merruni edhe gjatë gjithë jetës!”

Sepse kur të bjerë gjethja e fundit:

“.. disa prej atyre (që kanë trashëguar librin) që përparojnë në punë të mira... do të hyjnë në kopshtet e Adnit të stolitur me byzylykë ari e margaritarë dhe veshja e tyre do të jetë prej mëndafshi. Pastaj do të thonë: “Lavdi Allahut, i Cili e ka larguar hidhërimin nga ne. Vërtet, Zoti ynë është Falës dhe Falënderues.” (Fatir, 32-34.)

Për të arritur këto mirësi, Abdulkadir Gejlani, ka dhënë këto këshilla:

“Bëje këtë botë fitim për kapitalin tënd në botën tjetër! Kohën tënde, më parë shpenzoje për të fituar botën tjetër. Ndërsa pjesën tjetër të kohës, shpenzoje për të siguruar jetesën. Bëj kujdes, mos e bëj këtë botë kapital, ndërsa botën tjetër përfitim të saj. Nëse vepron kështu, kohën që do të teprojë prej punëve të kësaj bote, do ta shpenzosh për botën tjetër. Gjatë kësaj kohe do të mundohesh të falësh namazet. Mirëpo, me qëllim që t'i falësh shpejt, nuk do të respektosh kushtet e tij. Më pas do të lodhesh prej punëve të kësaj bote dhe do biesh i këputur. Për rrjedhojë, nuk do të kesh mundësi të falësh namaz nate. Prej lodhjes së madhe do të shtrihesh si i vdekur. Në këtë mënyrë nuk do të jesh i dobishëm as ditën. Do të ndjekësh dëshirat e egos, madje edhe të shejtanit. Kështu që, do të shesësh botën tjetër për këtë botë, do të bëhesh skllavi i egos tënde, e cila të hipën në shpinë.

Mirëpo, ti je urdhëruar për të nënshtruar egon tënde, për ta kundërshtuar atë dhe për ta futur në rrugën e shpëtimit. Kjo është rruga e botës tjetër, rruga e bindjes ndaj Zotit. Nëse i pranon dëshirat e egos, ti i bën padrejtësi vetes dhe frerët ia lë asaj në dorë. Nëse ti ndjek atë në dëshirat dhe shijet e tua, në fund do të humbasësh të mirat e kësaj bote dhe të botës tjetër. Pra, e dëmtove këtë botë dhe botën tjetër. Nëse ndodh kështu, në ditën e kijametit, në aspektin e fesë dhe kësaj bote, do të jesh njeriu më i falimentuar dhe më i dëmtuar. Me ndjekjen e egos, nuk arrite ndonjë gjë më tepër prej kësaj bote. Por nëse do ta kishe tërhequr egon tënde në rrugën e botës tjetër, nëse do ta kishe pranuar botën tjetër si kapitalin kryesor, do të kishe fituar edhe këtë botë, edhe botën tjetër. Do të mbrohesh prej të këqijave të egos dhe do të bëhesh prej të mirëve. Nëse qëndron larg të këqijave dhe i bindesh Allahut të madhëruar, duke mos i dhënë rëndësi kësaj bote, do të bëhesh prej robërve të mirë të Allahut.”

Prandaj:

Është kusht që të hiqen perdet/gjethet në të dy sytë, sepse ata që i kanë sytë me perde, edhe mendjet, edhe kuptimet, edhe zemrat e tyre i kanë me perde. Po ashtu, pas perdeve, ai shpik një botë tjetër prej pandehmave të veta. Dhe, nëse nuk zgjohet pa rënë ende gjethja e fundit, ai do të shkatërrohet. Nga kjo pikëpamje, indiferentët që i bëjnë perde gjethet/fletët e jetës së tyre, duhet të dinë që tani si të bëjnë hi prej zjarrit të të vërtetave. Atëherë, njeriu mund të shpëtojë prej mashtrimit. Përndryshe, do të dështojë duke u bërë kurbani i njëmijë e një mashtrimeve. Mbi të gjitha, ai vepron kështu për të mos u mashtruar.

Besimi i dyshuesve është se ndjenjat na mashtrojnë. Për këtë arsye, “është e pamundur të kuptosh drejt të vërtetën e materies”-thonë ata. Prandaj, ata nuk e pranojnë të vërtetën e materies, e refuzojnë realitetin e saj dhe dyshimet e tyre ia përshtatin çdo gjëje. Ata edhe janë në dyshim, edhe prej dyshimit.

Sido që të ketë ndodhur, Sinan pasha u përfshi prej kësaj filozofie në kohën e rinisë. Ndërsa babai i tij Hëzër beu, i cili ishte dhe Gjykatësi kryesor i Stambollit, kur i erdhi rasti, nuk ia vonoi djalit të tij të padëgjueshëm, një mësim të mirë.

Kur ishin duke ngrënë bukë së bashku, babai i tij Hëzër beu, tha:

“Biri im Sinan! Ke devijuar aq shumë prej asaj filozofie të prishur, sa që edhe sahanin prej bakri që ndodhet në tavolinë dyshon se është apo jo prej bakri!”

Përgjigja e tij nuk vonoi:

“Ashtu është! Ne s’mund të themi se është bakër vetëm sepse e shohim se është bakër. Është e mundur, por mund të jetë edhe diçka tjetër.”

Atë moment, Hëzër beu e kapi sahanin dhe siç ishte, ia ngjeshi Sinanit në kokë dhe i tha:

“Pa më thuaj tani, është bakër apo diçka tjetër?”

I nderuari Mevlana thotë:

“Dyshuesi e sheh mrekullinë dhe në fillim e pranon se është e vërtetë. Por më vonë, thotë:

«Ajo që pashë ishte imagjinatë. Nëse ajo gjë e habitshme do të ishte e vërtetë, shfaqja e saj, do të ndodhte natën, edhe ditën në çdo kohë, e nuk do të zhdukej.»

Ai nuk e di se:

Mrekullia mbetet në sytë e atyre që janë të pastër shpirtërisht dhe pa asnjë ndotje. Ç’punë ka ajo në sytë e kafshës?”

Shkurtimisht:

Sytë indiferentë, përpara gjethes së fundit janë të

nënshtruar prej perdeve të ndryshme dhe shfaqjeve të indiferencës.

Mirëpo një ditë:

Padyshim se gjethja e fundit do të bjerë për të gjithë. Mirëpo, bashkë me atë gjethe, do të bjerë çdo gjë tjetër. Gënjeshtrat, iluzionet, pandehmat, dyshimet, pretendimet, filozofitë dhe çdo gjë tjetër.

Më pas:

Fillon sundimi pa mëdyshje i së vërtetës. Për rrjedhojë, çështja më e rëndësishme është:

Përballë sundimit të pamëdyshjes, të kapesht pas të vërtetave, tani kur jeton në këtë botë, pa rënë ende gjethja e fundit, e jo kur të ketë mbaruar çdo gjë.

Të mund të kuptosh tani.

Të mund të shohësh tani.

Ta drejtosh tani mendjen dhe zemrën.

Të lodhesh tani me adhurime dhe devotshmëri.

Të lutesh tani me pasion.

T’i bësh tani me sinqeritet ato që thotë Allahu dhe i Dërguari i Tij (a.s.).

Ta lexosh tani këtë ajet:

“Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë.” (Zelzele, 7-8.)

Tani duhet ta shohë.

Duhet ta kuptojë pa rënë ende gjethja e fundit se:

“Kush dëshiron lavdi e pushtet, ta dijë se e gjithë lavdia e pushteti i takojnë Allahut. Tek Ai ngjiten fjalët e bukura, ndërsa veprën e mirë Ai e ngre Vetë. Sa i përket atyre që kurdisin të këqija, ata do të kenë dënim të rëndë dhe dredhitë e tyre do të dështojnë.” (Fatir, 10.)

Tani:

Është koha për fjalët e bukura që do të ngrihen tek Allahu.

Është koha për vepra të mira dhe sjellje të bukura që do t’i çojnë ato fjalë tek Allahu.

Tani:

Është koha për të qëndruar larg të këqijave dhe kurtheve.

Atëherë:

Stina tjetër, do të jetë një pranverë e pafundme.

Lum ata që jetojnë me këtë botëkuptim pa u rënë ende gjethja e fundit!

Lum ata që kur u bie gjethja e fundit e jetës, e marrin librin e punëve nga e djathta dhe ngrihen në kënaqësinë hyjnore!



Kur e do diçka me gjithë zemër, AJO BËHET REALITET

— Rukije Gonyly —

Fatma sapo erdhi nga shkolla shkoi në kuzhinë, pranë nënës së saj. Ajo ishte duke ngrënë kur dëgjoji nënën t'i thoshte:

“- Bija ime, ulu dhe ha ashtu siç duhet! Nuk bën që të hash në këmbë. Pejgamberi ynë i nderuar na ka këshilluar që të ulemi kur jemi duke ngrënë.”

Fatma iu përgjigj:

“- Ah moj nënë, ti m'i përmend synetet gjatë gjithë ditës. Ne nuk jemi si ti, nuk kemi të njëjtën dashuri dhe bindje që ke ti... Resulullahu nuk na

vjen në ëndrra! Nuk ka të mirë prej nesh... Ti mendo për veten tënde, mos u shqetëso për ne!..”

Këtë herë nëna e pyeti:

“- Pas pak javësh do të mbaroj shkolla dhe ti do e mbarosh shkollën nëntë-vjeçare. Unë kam dëshirë që të dërgoj në medrese. Si thua?”

Fatma iu përgjigj:

“- Nënë e dashur, unë nuk mund të bëhem dot vajza që ke dëshirë ti. Nuk kam dëshirë që të falem dhe as të mbulohem. Do të kisha shumë dëshirë që

të ndjeja besimin që ndjen ti por nuk mundem... Kjo nuk është diçka që bëhet me zor. Unë do të isha më e lumtur sikur të shkoja në një shkollë të mesme të përgjithshme.”

“- E dashur bija ime, ti je një vajzë e mirë. Nuk na mërzit asnjëherë. Ti ke dëshirë që të bëhesh një besimtare e mirë por nuk të lejon egoja jote. Ti ke dëshirë që ta shijosh jetën ashtu siç bëjnë bashkëmoshatarët e tu. Veç mos harro asnjëherë se unë jam përgjegjëse për ty, ashtu siç je edhe ti për veten. Kushërira jote, Aishja, verën e kaluar ka shkuar në një kurs Kurani dhe i qartësoi idetë e saj tani bën përpjekje për ta jetuar Islamin sipas rregullave të tij. A dëshiron të shkosh edhe ti në kurs Kurani gjatë verës, ta shikosh atë ambient... Kur të kthehesh nga kursi do të vendosim se çfarë do të bësh për shkollë...”

“- Mirë nënë e dashur, do të shkoj në kurs vetëm për hatër tëndin.”

* * *

Zonja Hatixhe i mbaroi punët në kuzhinë dhe u ul pranë dritares e filloi që të bënte tesbih.

Kur erdhi darka, e gjithë familja u ul për të ngrënë një ushqim të mirë. Pas ngrënies secili u drejtua për në dhomën e vet. Fatma me Jasminën u futën në internet menjëherë.

Babai mori telekomandën në dorë dhe u habit pas lajmeve. Zonja Hatixhe fali namazin dhe filloi të bënte dua që fëmijët e saj ta jetonin Islamin ashtu siç duhet.

Po paloste sexhaden kur ikën dritat. E gjithë familja u detyrua që të kalonte në sallon për të qëndruar nën dritën e qiriut. Zonja Hatixhe i tha Fatmës:

“- Bija ime, shko të marrësh kalendarin dhe ta lexojmë se ka kohë që nuk kam gjetur mundësi për ta lexuar.”

Fatma e mori qiriun në dorë dhe shkoi të merrte kalendarin. Filloi të lexonte:

“Një ditë Omer kishte shkuar tek Pejgamberi ynë i nderuar. Ai i hodhi një sy dhomës. Ajo ishte bosh. Në shtëpi ndodhej vetëm një mbulesë e bërë nga thurra e gjetheve të hurmës. I Dërguari i Allahut ishte mbështetur mbi të. Mbulesa kishte lënë gjurmë në lëkurën e tij të bekuar. Në një qoshe kishte shumë pak elb. Pranë saj, e varur në një gozhdë qëndronte një torbë e vjetër uji. Vetëm këto gjëra ndodheshin në shtëpinë e Resulallahut!.. Vetëm kaq gjëra zotëronte Resulullahu, arsyeja e krijimit të Gjithësisë. Omer psherëtiu. Nuk e mbajti dot veten dhe filloi të qante nga mërzia. Pejgamber (a.s.)e pyeti:

“- Pse po qan Omer?”

Ai iu përgjigj:


“- Pse të mos qaj o Resulullah! Ndërkohë që e gjithë bota noton në mes të gjithë të mirave, Resulullahu jeton mbi një qilim të thurur...”

Pejgamber (a.s.)e mori me të mirë Omerin duke i thënë:

“- Mos qaj o Omer! A nuk ke dëshirë ti që të gjitha bukuritë e kësaj bote të jenë të tyre kurse ahireti me bukuritë e tija të jetë i joni?!”

Në një ngjarje të ngjashme Resulullahu ka thënë:

“Çfarë më duhet kjo botë mua! Lidhja ime me këtë botë është si lidhja e një njeriu që udhëton në një ditë vere, me një pemë në të cilën pushon pak për të vazhduar udhëtimin pas pak.”



Pejgamberi (a.s.) ishte shumë i shqetësuar për ditën kur do të dilte para dhënies së llogarisë dhe bënte dua gjatë gjithë kohës:

“ O Zoti im! Bëj që unë të jetoj si një njeri i varfër; bëj që të vdes si një njeri i varfër; më ringjall mua bashkë me njerëzit e varfër!” (Tirmidhiu, Zuhd, 37/2352; Ibni Maxhe, Zuhd, 7)

Kur Fatma përfundoi leximin, të gjithë shikuan njëri-tjetrin. Kishin mbetur pa fjalë. Këtë herë vajza tjetër Jasmina, filloi të lexonte. Edhe hadithi i dytë kishte lidhje me Omerin:

Më këtë ngjarje të transmetuar nga Abdullah bin Hisham, ne kuptojmë gradën që duhet të ketë dashuria jonë për Resulullahun:

“ Një ditë po qëndronim së bashku me Resulullahun sallallahu alejhi ve selem. Pejgamberi kishte marrë në mes të duarve dorën e Omerit. Në ato çaste Omeri (r.a) e shprehu dashurinë për Pejgamberin tonë të nderuar me fjalët:

“- O Resulullah, ti për mua je më i shtrenjtë se çdo gjë, përveç jetës sime!”

Resulullahu iu përgjigj:

“ Unë betohem në Allahun, në dorën e të Cilit është shpirti im se ti nuk quhesh besimtar i drejtë derisa të më duash mua më shumë se veten!”

Omer i tha menjëherë:

“ Atëherë, ti më je më i dashur se vetë jeta o Resulullah!”. Pas këtyre fjalëve Pejgamberi i tha:

“- Tani je në rregull Omer!”

Këto dy hadithe të lexuara njëri pas tjetrit i kishin gozhduar të gjithë. Nuk kishin fuqi të flisnin, lë më të lëviznin. Zonja Hatixhe filloi që të qante. Babai kishte rënë në mendime të thella. Fatma dhe Jasmina ishin ndikuar shumë nga kjo gjendje. Për disa çaste nuk morën dot guximin që të lexonin diçka të re...

Pastaj filluan që të lexonin edhe disa fletë të tjera nga kalendari; ato 15 minuta ishin shumë të veçanta. Zonja Hatixhe e prishi qetësinë me një ilahi që filloi ta këndonte me zë të ëmbël:

Ditët ishin ditë, kohët ishin kohë

Akoma pa lindur, kishte njerëz që të besonin

Ishe gonxhja e Hatixhes, trëndafili i Aishes

Drita e ymetit, Resuli i qiejve...

Tani të kujtojmë me mall,

Ti ishe bashkëvuajtës me të vuajturit.

Ku je o Resul? Ku je o Nebi?

Flatra e të rrëzuarve, shoku i të pashpresëve .

Zonja Hatixhe sikur po e thërriste Pejgamberin tonë të nderuar me anë të ilahisë së saj. Edhe vajzat ishin ndikuar shumë. Fatma e ndjeu zemrën tek po i dridhej. Zotëri Kerimi tha:

“- Ne mund të jetojmë edhe pa internet dhe televizion; kështu jeta qenka më e bukur! Po përjetojmë momente shumë të veçanta sot!..” E gjithë familja buzëqeshi pas këtyre fjalëve.

Fatma, atë verë shkoi në kursin e Kuranit. Ajo ishte ndikuar shumë nga mësueset dhe nga mjedisi i kursit. Mësimi i historisë Islame e bënte që të fluturonte drejt

klimës në të cilën ka jetuar Resulullahu. Në kurs, për herë të parë mësoi për edukatën dhe moralin e lartë të Pejgamberit tonë të nderuar. Fatma kishte lexuar edhe më përpara libra që flisnin për pejgamberët por nuk ishte ndikuar prej tyre. Tashmë zemra e saj sikur ishte zbutur. Një ditë në mësim pyeti mësuesen e vet:

“- Çfarë duhet të bëjmë për ta ndjerë më afër Resulullahun?”

Mësuesja i dha këtë përgjigje:

“- Bija ime, si fillim duhet t’i japësh rëndësi mësimin të historisë Islame dhe të hadithit. Duhet të marrësh një abdest të rregullt dhe të përgatitesh për takimin me Resulallahun duke thënë salavate. Përgatitu sikur je duke shkuar në Ravza, sikur do të takohesh realisht me të... Këtë ndjenjë dhe psikologji, duhet ta kemi edhe kur lexojmë librat që kanë të bëjnë me Resulullahun. Vetëm në qoftë se i bëjmë të gjitha këto, dashuria për Resulullahun do të na pushtojë zemrën tonë. Kjo dashuri do të na ndihmojë që të ndjekim me përpikëri synetin e Pejgamberit tonë të dashur. Gjithashtu duhet të bëjmë kujdes që të mbajmë lidhje me Resulullahun gjatë gjithë kohës. Për shembull kur bëjmë një veprim duhet të pyesim vetën: “ Si do të sillsha unë po të kisha Resulullahun pranë në këto momente?” ose: “ Si do të ishte veshja ime po të dilja para Resulullahut?”, “ Si do të ishte namazi im sikur të jetoja në kohën e Resulullahut?” Gjatë gjithë kohës duhet t’i bëjmë vetes këto pyetje në mënyrë që të motivohemi më shumë.”

Fatma i kishte dëgjuar fjalët e mësueses me shumë vëmendje dhe emocion. Pas asaj dite, nuk harronte asnjëherë që t’i dërgonte salavate Resulullahut. Tashmë edhe në gjumë e përhëndeste Resulullahun me salavate. Këtë gjë e dallonte kur i dilte gjumi.

Atë verë e kaloi me përpjekjen për ta njohur Resulullahun sa më mirë. Nuk i lëshonte nga dora librat që flisnin për jetën e Resulullahut. Një ditë lexoi këtë fjali: “ Resulullahu i kishte edukuar aq mirë sahabët e vet sa që dëgjonin adhurimin (dhikrin) e kafshatave që kalonin nga fyti.” Këto fjalë ia shpuan zemrën Fatmas e cila duke qarë mendoi:

“- Ahh... Sikur ta shikoja edhe unë Resulullahun dhe zemra ime të edukohej nga ai...”

Atë natë mësueset e ngritën për të falur namazin e natës. E fali namazin dhe filloi të lexonte disa faqe nga libri që kishte lënë përgjysmë. Ra me mall në sexhde dhe filloi të bënte dua dhe të

dërgonte salavate... Dërgonte përhëndetje për më të dashurin...

Dy net pas kësaj ngjarjeje, ajo po flinte e përmalluar për Resulullahun kur shikoi t’i hapej një perde misterioze:

Ndodhej në një dhomë krejt të errët. Kishte në duar librin që po e lexonte prej disa ditësh dhe një i tërhoqi vëmendjen një kapitull i librit: “ Edhe vajza e Pejgamberit, Fatma, arrinte që të dëgjonte dhikrin që bënin kafshatat që i kalonin në fytyrë.”

Në ato çaste shikoi një turmë njerëzish. Mes tyre kishte një dritë blu e cila ndriçonte ambientin. Në duart e këtyre njerëzve me erë të mirë, kishte tespih. Të gjithë ato shikonin Pejgamberin.

Fatma qëndronte me kokë ulur dhe e mërziur sepse nuk arrinte as të dëgjonte erën e mirë të Resulullahut...

Teksa po mendonte: “ Si mund të lexoj librin unë në një dhomë kaq të errët”, dalloi një dritë që po i vinte nga prapa. Fatma ktheu kokën pas dhe shikoi që një dritë e vogël tani po zmadhohej dhe po ndriçonte të gjithë dhomën. Në atë momente, brenda dritës shikoi Pejgamberin tonë të nderuar sallallahu alejhi ve selem.

Fatma me lotët që i rridhnin nëpër faqe, filloi ta shikonte Pejgamberin.

“- O Allah, çfarë është kjo mrekulli; kjo bukuri?! Me një veshje ngjyrë kremi dhe me një rrip në brez... Sa qëndrim modest, mjekër e gjatë, flokët pak kaçurrela, sytë ngjyrë bojë kafe të përziera me jeshile... Elegant por edhe imponues në të njëjtën kohë... Shikon me kokën pak të kthyer nga ana e djathtë, edhe shikimi i tij është plot shkëlqim...”

Në ato çaste Fatma filloi të dridhej e tëra; ky ishte një emocion i ëmbël që i kaloi deri tek majat e flokëve!.. Po dëgjohehin disa zëra burrash:

“- Allahu Ekber, Allahu Ekber!..”

Edhe Fatma u bashkua me to:

“- Allahu Ekber!”

Teksa po shqiptonte këto fjalë, u zgjua. Ishte koha e namazit të natës. Po qante sepse ishte zgjuar nga një ëndërr aq e bukur. Po qante nga kënaqësia e asaj që kishte shikuar. Mori abdest dhe u filloi të falte namazin e falënderimit :

“- Zoti im, mos lejo që netëve të mia t’u mungoj namazi i natës... Bëj që salavatet të më kujtojnë gjithmonë Resulullahun. Kjo lumturi mos i mungoftë asnjëherë jetës sime!..”

Pas kësaj duaje e ledhatoi fytyrën me duar.

LËNGU I ARTË

Vaj Ulliri me Limon për Shëndet të Plotë

Prej shumë vitesh njerëzit e kanë përdorur kurën natyrale me vaj ulliri dhe limon në të mirë të shëndetit dhe trupit.

Kjo kurë që konsumohet esëll në mëngjes është një alternativë shumë e mirë për të pasur një shëndet optimal.

Mjafton të shtrydhni një limon dhe ta përzieni me një lugë gjelle me vaj ulliri e ta pini rregullisht.

PËRFITIMET E KURËS ME VAJ ULLIRI DHE LIMON PËR SHËNDETIN

Detoksifikimi i trupit

Përzierja mes vajit të ullirit dhe limonit është ideale për të pastruar të gjithë trupin.

Ky lëng duhet konsumuar përpara ngrënies mëngjesit që të funksionojë në mënyrë perfekte.

Mbrojtje për zemrën

Vaji i ullirit është i pasur me acide yndyrore që riaktivizojnë qarkullimin e brendshëm, duke eliminuar kolesterolin e keq.

Vaji i ullirit largon inflamacionin dhe e pajis trupin me vitamina.

Kundër kolesterolit

Vaji i ullirit me limon është një kurë natyrale për të ulur nivelet e larta të kolesterolit në gjak.

Problemet me reumatizëm

Sekreti i suksesit të kësaj kure kundër reumatizmit qëndron tek vlerat kundër inflamacionit.

Nëse e pini këtë kurë rregullisht me stomak bosh do të përjetoni më pak dhimbje të kyçeve.

Jo më kot kjo kurë njihet si lëngu i artë.

Kundër konstipacionit

Vaji i ullirit ka efekt laskativ sidomos kur konsumohet me stomak bosh.

Kjo kurë natyrale zgjidh problemin e konstipacionit.

Për shëndetin e mëlçisë

Kur organizmi mbushet me toksina falë ushqyerjes së keqe, në ndihmë vjen vaji i ullirit me lëngun e limonit.

Intoksikimi i organizmit ndikon ndjeshëm në shëndetin dhe funksionin e mëlçisë.

Duke e konsumuar lëngun e limonit dhe vajin e ullirit në mënyrë të rregullt do të përmirësoni shëndetin e mëlçisë.

Problemet me tretjen

Lëngu i limonit me vaj ulliri rekomandohet për problemet me tretjen, aciditetin në stomak e të tjerë.

Ky lëng ka efekt qetësues për problemet me stomak sidomos kur konsumohet esëll.

Lëkura, flokët dhe thonjtë

Vaji i ullirit me lëngun e limonit është një kurë ideale për njerëzit që kanë thonj të brishtë, akne dhe çrregullime të pehashit të lëkurës.

Ky lëng është i pasur me antioksidantë që luftojnë shenjat e moshës, rrudhat dhe njollat në lëkurë.

Vaji i ullirit dhe lëngu i limonit gjithashtu rekomandohen për të trajtuar zbokthin në flokë, duke e masazhuar përpara larjes.



KOMBINIMI MAGJIK VAJ ULLIRI, MJALTË DHE LIMON

Mund të keni dëgjuar shpesh për përfitimet që vijnë nga kombinimi i vajit ekstra të virgjër të ullirit, mjaltit dhe limonit.

Këto produkte të konsumuara gjërisht në traditën shqiptare janë mjaft të dobishme në përkujdesjen natyrale ndaj shëndetit.

Vaji ekstra i virgjër i ullirit përmban sasi domethënëse të yndyrnave të quajtura 'të mira' dhe acidit oleik, duke ndihmuar në pakësimin e shfaqjes së sëmundjeve koronare.

Ai përmban antioksidantë dhe ushqyes që luftojnë inflamacionin dhe ndihmojnë në uljen e niveleve të kolesterolit të keq, ngadalësimin e plakjes dhe largimin e radikaleve të lira.

Mjalti është një ushqim natyralisht i ëmbël që i jep shëndetit tonë shumë përfitime. Përmbajtja e lartë e sheqerit është një burim i shkëlqyer i energjisë së shëndetshme.

Mjalti lufton bakteret dhe inflamacionin, por edhe shërben si antibiotik dhe antiseptik. Për më tepër ai luan edhe një rol qetësues.

Lëngu i limonit përmban vitaminë C, acid citrik, kalcium, magnez, bioflavonoidë, pektinë dhe limonenë të cilët së bashku forcojnë sistemin imunitar dhe e mbrojnë atë nga infeksionet.

Lëngu i limonit është ideal për detoksifikimin dhe

pastrimin e organizmit. Ai hollon gjakun dhe është efikas kundër viruseve dhe baktereve.

Ekspertët shprehen se kombinimi i vajit ekstra të virgjër, mjaltit dhe limonit është përdorur edhe në kultura të lashta, për shkak të vlerave të shëndetshme dhe gjallëruese.

Ky kombinim forcon sistemin imunitar, rregullon atë tretës, pastron enët e gjakut, përmirëson funksionin e mëlçisë, lëkurën dhe pakëson rrudhat.

Një lugë gjelle në ditë e kësaj kure natyrale me stomak bosh, rekomandohet të konsumohet herët në mëngjes përgjatë një muaji.

Kjo dozë mund të përsëritet sërish pas gjashtë muajsh.

PËRBËRËSIT:

- 1 gotë me lëng limoni
- 180 gr mjaltë
- 4 lugë gjelle me vaj ekstra të virgjër

PËRGATITJA:

Shtrydhni 3-4 limonë dhe hidhjeni lëngun në një kavanoz qelqi. Shtoni mjaltin dhe vajin e ullirit dhe përzijini me një lugë druri deri sa të formohet një lëng i njëtrajtshëm. Mbylleni kavanozin dhe futeni në frigorifer.



Ju ofron:
Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe të kontrolluar,
staf të kualifikuar.

Ju mirëpresim!



Logja Perash, Bulevardi Mehmet Pashë Plaku,
Pranë Xhamisë Perash, Shkodër
+355 67 47 39389

1 Staf arsimor cilësor

2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta

3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive

4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar


5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



CIKLI FILLOR

(djem dhe vajza)

NGA KLASA E 1-RË
DERI NË KLASËN E 5-TË



“Urdhëroji njerëzit e tu
të falin namazin
dhe ji i vazhdueshëm
edhe vetë në të.
Ne nuk kërkojmë
furnizim prej teje,
Ne jemi ata
që të furnizojmë ty.”

(TaHa, 132)